



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS
INSTITUTI I ZHVILLIMIT TË ARSIMIT**

UDHËZUES PËR REALIZIMIN E MODULEVE PROFESIONALE NË GJIMNAZ

Tiranë, 2012

Materiali u përgatit nga:

Dr. Tidita Abdurahmani

Fatmira Peshkatari

Alqi Mustafai

Alma Kacaraho

Vojsava Thanasi

Mirela Andoni

si dhe u konsultua nga **Fatmir Vejsiu, Dorina Rapti** dhe shumë drejtues të gjimnazeve, të projekteve që mbështesin arsimin profesional në Shqipëri, të shkollave profesionale, të mësuesve dhe ekspertëve të tregut të punës.

Redaktimi shkencore:

Dr. Mirela Andoni

Redaktore letrare:

Ma. Freskida Miloti

© *Instituti i Zhvillimit të Arsimit*



Instituti i Zhvillimit Arsimor

Rr: "Naim Frashëri" Nr.37, Tiranë - Shqipëri

Tel: +355 4 22 56 440 / 22 56 441.

Fax: +355 4 22 56 441

E-mail: sekretaria@izha.edu.al

<http://www.izha.edu.al>

Përmbajtja

I. Hyrje	5
II. Vështrim i përgjithshëm për modulet profesionale në gjimnaz	6
2.1. Rëndësia dhe funksioni i moduleve profesionale në gjimnaz.....	6
2.2. Përmbajtja dhe struktura e programeve të moduleve profesionale.....	9
2.3. Kushtet për realizimin e moduleve.....	17
2.4. Udhëzime didaktike për realizimin e moduleve.....	19
2.5. Vlerësimi i nxënësit për modulet profesionale.....	24
2.6. Shkolla harton module profesionale bazuar në modelin e 10 programeve dhe materialeve mbështetëse	26
III. Udhëzime të përgjithshme për realizimin e moduleve profesionale	28
3.1. Organizmi i përzgjedhjes së moduleve nga nxënësit.....	28
3.2. Mënyra të organizimit të planit orar të shkollës për realizimin e moduleve.....	30
3.3. Menaxhimi i stafit mësimor për realizimin e moduleve profesionale.....	31

IV. Udhëzime për bashkëpunimin e gjimnazit me biznesin34

- 4.1. Përshkrimi i punës për mësuesin përgjegjës për realizimin e moduleve profesionale jashtë shkollës.....34
- 4.2. Dosja e punëve të nxënësve.....38
- 4.3. Model i një marrëveshje bashkëpunimi mes shkollës dhe biznesit.....39

V. Shtojca40

- 5.1. Aneks 1. Programet e 12 moduleve profesionale të hartuara nga IZHA.....40
- 5.2. Aneks 2. Lista e qendrave të formimit profesional.....127
- 5.3. Aneks 3. Module të tjera të sugjeruara marrë nga kurrikulat e Arsimit profesional.....132

I. Hyrje

Udhëzuesi për realizimin e moduleve profesionale në gjimnaz synon të lehtësojë realizimin e këtij komponenti të kurrikulës në kushtet reale të shkollës.

Ky udhëzues përpiqet të qartësojë kuptimin dhe funksionin e moduleve profesionale në gjimnaz, mënyrën e organizimit të përmbajtjes në programet e moduleve, mënyrën e zbatimit të tyre në kushtet konkrete të shkollës.

Udhëzuesi jep sugjerime për aspekte metodologjike të realizimit të moduleve, si dhe të mënyrave të organizimit të stafit dhe planit orar të gjimnazit.

Udhëzimet për bashkëpunimin e gjimnazit me biznesin synojnë lehtësimin e realizimit të moduleve jo vetëm në shkollë, por edhe në kushte reale pune.

Ky udhëzues pasqyron përvojat pozitive dhe idetë reja të gjimnazeve në lidhje me realizimin e moduleve profesionale.

II. Vështrim i përgjithshëm për modulet profesionale në gjimnaz

2.1. Rëndësia dhe funksioni i moduleve profesionale në gjimnaz

Kurrikula e re e gjimnazit përbëhet nga kurrikula bërthamë, me zgjedhje të detyruar dhe kurrikula me zgjedhje të lirë.

Referuar dokumenteve kryesorë kurrikulare të gjimnazit, mund të nënvizojmë se kurrikula me zgjedhje të lirë synon:

- Plotësimin e nevojave individuale të nxënësve të pa plotësuara me kurrikulën bërthamë dhe atë me zgjedhje të detyruar;
- Rritjen e aftësive psiko-sociale të nxënësve;
- Orientimin e nxënësve për karrierën dhe jetën;
- Përforcimin e njohurive dhe aftësive sipas fushave të kurrikulës bërthamë.

Plani mësimor i gjimnazit detyron shkollën që për gjatë tri viteve të ofrojë për kurrikulën me zgjedhje të lirë një numër të përcaktuar orësh, për shembull, për klasën e 10-të, 2 orë javore, pra, 72 orë në total.

<i>Kurrikula me zgjedhje</i>	<i>Klasa 10</i>	<i>Klasa 11</i>	<i>Klasa 12</i>	<i>Gjithsej për të tri vitet</i>
Kurrikula bërthamë	26	24	23	73
Kurrikula me zgjedhje të detyruar	2	4	4	10
Kurrikula me zgjedhje të lirë	2	2	3	7
Orë javorë gjithsej	30	30	30	90

Ndryshe nga kurrikula me zgjedhje të detyruar, ku përmbajtja ofrohet e gatshme nga MASH, kurrikula me zgjedhje të lirë duhet të planifikohet/ zhvillohet nga shkolla.

MASH ka paracaktuar vetëm fushat e përmbajtjes me qëllim plotësimin e synimeve të caktuara në kornizën kurrikulare.

Fushat në të cilat shkollat do të zgjedhin përmbajtjen janë:

- shërbimet komunitare;
- veprimtaritë me karakter profesional (modulet profesionale);
- fushat e kurrikulës bërthamë;

MASH gjithashtu ka paracaktuar 36 orë, minimumin e detyruar për secilën nga fushat e mësipërme, që nxënësi duhet të realizojë për gjatë të tri viteve të shkollimit në gjimnaz.

Në dokumentin e planit mësimor theksohet se, “Kurrikula me zgjedhje të lirë përmban doemos:

- 36 orë për shërbimet komunitare;
- 36 orë për projektet kurrikulare të fushave të të nxënimit;
- 36 orë për modulet profesionale (minimumi i detyrueshëm për çdo nxënës).

Bazuar në këtë detyrim shkolla duhet të ofrojë lëndë, module, projekte kurrikulare me përmbajtje nga këto tri fusha, duke mbajtur parasysh kapacitetet njerëzore (mësues), mjediset, bazën materiale që disponon, orientimin rajonal, organizatat dhe institucionet e mundshme për të bashkëpunuar etj.

Si pjesë e kurrikulës me zgjedhje të lirë modulet profesionale kanë funksion të shumëfishtë:

- Së pari, ato ndihmojnë nxënësit të vendosin një ***marrëdhënie konkrete dhe të drejtpërdrejtë me veprimtaritë praktike edhe me karakter profesional***, si dhe krijojnë një “ndjesi” për natyrën e profesioneve që “prekin” modulet.
- Së dyti, këto module krijojnë premisa për një ***orientim më të mirë të nxënësve për sipërmarrjet dhe karrierën e tyre të ardhshme***, si për atë që ka të bëjë me shkollimin dhe trajnimin e mëtejshëm, ashtu dhe për punësimin dhe vetëpunësimin.
- Së treti, modulet profesionale lehtësojnë zbatimin e parimit ***të të nxënimit gjatë gjithë jetës***, si rrjedhojë e transferimit të njohurive dhe aftësive të fituara në lëndë të tjera në modulet profesionale, si dhe

ato të fituara në kuadrin e modulit në kontekste të tjera, profesionale dhe joprofesionale.

Modulet nuk kanë si qëllim në vetvete zhvillimin e kompetencave profesionale të nxënësve, por shërben edhe si mjet për zhvillimin e njohurive dhe aftësive kyçe jetësore dhe ndërprofesionale.

Referuar përvojës 3-vjeçare të zbatimit të kurrikulës me zgjedhje të lirë është vërejtur vështirësi për përzgjedhjen dhe hartimin e moduleve profesionale, të cilat lidhin më shumë shkollën me realitetin e jetës dhe punës.

Në tri vitet e para të zbatimit të kurrikulës së re të gjimnazit ka qenë detyrë e shkollave të zhvillojnë dhe përzgjedhin module me karakter profesional referuar nevojës së nxënësve, kushteve të shkollës, veçorive të rajonit ku është vendosur shkolla etj. Instituti i Zhvillimit të Arsimit (IZHA) në kurrikulën e re të gjimnazit ka sugjeruar vetëm disa module profesionale si “Guida turistike”, “Etika e të ushqyerit” (kjo e fundit në 60% të programit e ka të orientuar në shërbimin në bar dhe restorant) etj, të cilat kanë shërbyer si model për shkollat.

Me mbështetjen e projektit të Bankës Botërore “Cilësi dhe Barazi në Arsim”, Instituti i Zhvillimit të Arsimit ka hartuar edhe 10 module të tjera profesionale. Këto module që i ofrohen shkollave, së bashku me modulet e lartpërmendura, si dhe ato që kanë hartuar vetë shkollat, janë një bazë e mirë për plotësimin e preferencave të nxënësve.

Nevoja për hartimin e moduleve profesionale nga IZHA ka rrjedhur nga vështirësitë që janë shfaqur në lidhje me përzgjedhjen dhe realizimin e tematikave të larmishme për këtë pjesë të kurrikulës që lidh më shumë shkollën me realitetin e jetës dhe punës.

Metodologjia dhe gjithë procesi i hartimit të moduleve profesionale nga IZHA, ka respektuar dhe mbajtur në vëmendje, ***qëllimin që ato kanë në raport me kurrikulën në përgjithësi.***

Mënyra se si janë konceptuar është bazuar në planin mësimor, udhëzuesin e zbatimit të kurrikulës së gjimnazit, si dhe në problematikën e vërejtur nga zbatimi i kurrikulës së re të gjimnazit.

2.2. Përmbajtja dhe struktura e programeve të moduleve profesionale

Përcaktimi i fushave të moduleve profesionale dhe tematika e tyre është paraprirë nga analiza e studimeve që institucione të ndryshme kanë kryer për aftësitë e munguara dhe ato të kërkuara në tregun aktual të punës në Shqipëri. Kjo analizë kishte për qëllim jo vetëm përputhjen e nevojave të shkollës, për gjerësi tematikash, për module profesionale, por edhe që këto tematika të krijojnë mundësi që orientimi dhe aftësimi i nxënësit të jetë në përputhje me atë që realisht kërkohet sot në tregun e punës.

Përcaktimi përfundimtar i listës së moduleve ka ardhur si rrjedhojë e takimeve me aktorë nga shkollat, drejtoritë arsimore, nga arsimit dhe trajnimi profesional, si dhe nga sektori i biznesit.

10 modulet profesionale të hartuara së fundmi së bashku me modulet e ofruara më parë, si: “Guida turistike”, “Etika e të ushqyerit” etj bëjnë një bazë të mirë për zgjedhje nga nxënësit referuar prirjeve dhe dëshirave të tyre. Lista e moduleve të hartuara mund të shtohet edhe me të tjera nga vetë shkolla. Modeli i ofruar i programeve dhe materialeve mbështetëse është shembull për shkollat për të zhvilluar module të reja sipas nevojave të nxënësve.

Përmbajtja e moduleve i referohet njohurive që nxënësit kanë fituar në lëndë të tjera, të cilat do të gjejnë zbatim në veprimtaritë praktike të parashikuara në modul.

Nëpërmjet veprimtarive teorike dhe praktike të parashikuara në modul *synohet zhvillimi i aftësive psikomotore të nxënësve për të analizuar objekte dhe pajisje të ndryshme, si dhe skicat e vizatimet e tyre, për të përzgjedhur materiale të ndryshme, për të përdorur vegla dhe pajisje të thjeshta, për të kryer punime të thjeshta të riparimit dhe të mirëmbajtjes shtëpiake, për të zbatuar rregullat e sigurisë dhe të mbrojtjes së mjedisit, për të komunikuar dhe bashkëpunuar në grupe të vogla etj.*

Moduli profesional teorik dhe praktik i ndihmon nxënësit që të vendosin një marrëdhënie konkrete dhe të drejtpërdrejtë me veprimtaritë praktike, një pjesë e të cilave janë me karakter profesional, si dhe të krijojnë një “ndjesi” edhe për natyrën e profesioneve, të cilat i “prek” ky modul (elektricitet, elektromekanik, hidraulik, marangoz, murator, sekretar, laborant, kopshtar, estet, arredues, stilist etj).

Hartimi i programit të moduleve, si dhe materialet mbështetëse për secilin prej tyre, janë kryer nga grupe pune (2-4 anëtarë), me përbërje mësues nga arsimit dhe formimi profesional, si dhe specialistë të biznesit. Grupet janë moderuar nga IZHA bazuar në parimet e hartimit të kurrikulës dhe të garantimit të cilësisë.

Struktura e programeve të moduleve profesionale është e njëjtë me strukturën e programeve të moduleve praktike të arsimit dhe trajnimit profesional, duke lejuar shkëmbimin reciprok midis arsimit të përgjithshëm dhe arsimit e formimit profesional, si dhe transferimin dhe njohjen e arritjeve të nxënësve brenda këtij sistemi.

Programet e moduleve kanë strukturë modulare, me fokusim te Rezultatet Mësimore (RM) të cilat priten të përmbushen nga vetë nxënësit në fund të veprimtarive mësimore të orientuara nga praktikimi i tyre për ato aspekte që përmban moduli.

Programet e moduleve janë të përbëra nga disa Rezultate Mësimore (RM), ku RM1 është i detyruar për të gjithë nxënësit që do të zgjedhin modulin dhe ka si qëllim njohjen e fushës ku është fokusuar veprimtaria e modulit. RM-të e tjera mund të zgjidhen sipas dëshirës. Pra nxënësi zgjedh RM1 dhe RM2 dhe merr ½ kredit, por mund të zgjedhe RM1, RM3 apo RM1, RM2 dhe RM3 dhe në këtë rast merr 1 kredit.

Modeli strukturor i programeve krijon elasticitet për përmbajtjen e modulit; shkollat mund të pasurojnë modulin me rezultate të reja mësimore sipas kushteve të shkollës dhe nevojave të nxënësve.

Elementet bazë strukturore të përshkruesit të modulit janë:

- Titulli i modulit, i cili tregon fushën ku janë fokusuar veprimtaritë e nxënësve gjatë trajtimit të modulit.
- Qëllimi i modulit, shpreh kompetencën themelore që do të zhvillohet te nxënësit me përfundimin e suksesshëm të veprimtarive të modulit.
- Kohëzgjatja e modulit tregon se në sa orë mësimore do të trajtohen veprimtaritë mësimore të të gjitha RM-ve të modulit (ku çdo RM ka kohëzgjatjen e tij).
- Niveli i parapëlqyer për pranim, tregon se çfarë kërkesash duhet të plotësojë nxënësi për t'u përfshirë në trajtimin e modulit.
- Rezultati Mësimor (RM) tregon arritjet (teorike dhe praktike) e pritshme të nxënësit në përfundim të veprimtarive mësimore të planifikuara për këtë RM.

- Përmbajtja (e RM-së përkatëse) përshkruan aspektet teorike (njohuritë) dhe praktike (procedurat e punës), të cilat rekomandohet të trajtohen gjatë zbatimit për të mundur arritjen e kësaj RM-je nga nxënësit.
- Instrumenti i vlerësimit, tregon mënyrën se si do të verifikohet shkalla e përmbushjes së RM-së nga nxënësit.
- Kriteret e vlerësimit, shërbejnë si “standarde” që mundësojnë krahasimin e arritjeve reale të nxënësve, me ato që pritet të arrihen.
- Udhëzime për zbatimin e modulit, përmbajnë disa rekomandime të përgjithshme për organizimin dhe zbatimin e modulit, si dhe për vlerësimin e nxënësve.
- Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit, përmbajnë listën e mjediseve, veglave, pajisjeve dhe materialeve, pa të cilat do të ishte e vështirë përmbushja e duhur e RM-ve të modulit.

Nga rubrikat e mësipërme, një pjesë janë detyruese (qëllimi, kohëzgjatja, RM-të dhe kriteret e vlerësimit), ndërsa të tjerat janë rekomanduese dhe mund të përshtaten me kushtet reale të zbatimit të modulit.

Përmbajtja e moduleve i referohet njohurive që nxënësit kanë fituar në lëndë të tjera, të cilat do të gjejnë zbatim në veprimtaritë praktike të parashikuara në modul.

Nëpërmjet veprimtarive teorike dhe praktike të parashikuara në modul *synohet zhvillimi i aftësive psikomotorë të nxënësve për të analizuar objekte dhe pajisje të ndryshme, si dhe skicat e vizatimet e tyre, për të përzgjedhur materiale të ndryshme, për të përdorur vegla dhe pajisje të thjeshta, për të kryer punime të thjeshta të riparimit dhe të mirëmbajtjes shtëpiake, për të zbatuar rregullat e sigurisë dhe të mbrojtjes së mjedisit, për të komunikuar dhe bashkëpunuar në grupe të vogla etj.*

Lista e moduleve dhe përmbajtja e tyre e shprehur me rezultate mësimore (RM) është si më poshtë:

1. Punime të mirëmbajtjes dhe riparimit në banesa

RM1: Nxënësi përshkruan punimet e thjeshta të riparimit dhe të mirëmbajtjes në mjediset, orenditë dhe pajisjet shtëpiake.

RM2: Nxënësi kryen mirëmbajtje dhe riparime të thjeshta elektrike në

rrjetin elektrik të banesës.

RM3: Nxënësi kryen mirëmbajtje dhe riparime të thjeshta elektrike në pajisjet elektro-shtëpiake të banesës.

RM4: Nxënësi kryen mirëmbajtje dhe riparime të thjeshta në rrjetin hidraulik të banesës.

RM5: Nxënësi kryen montime dhe riparime të thjeshta të orendive shtëpiake prej druri.

RM6: Nxënësi kryen riparime të thjeshta të mureve dhe tavaneve të banesave.

Ky modul ka për qëllim të aftësojë nxënësin me aspekte të thjeshta të riparimit në mjedisin shtëpiak. Ai synon gjithashtu të njohë nxënësin me veprimtari pune të sektorit të ndërtimit si një mundësi për t'u orientuar për shkollim, trajnim dhe punësim në fushat profesionale që prekin sektorin e ndërtimit dhe riparimit.

2. Etika e të veshurit dhe arredimit

RM 1: Nxënësi përshkruan aspekte të etikës së të veshurit dhe arredimit.

RM 2: Nxënësi realizon ide të thjeshta për veshje bazuar në aspektet e etikës së të veshurit.

RM 3: Nxënësi realizon skicën e thjeshtë të arredimit të një ambienti.

Ky modul ka për qëllim të njohë dhe aftësojë nxënësin për jetën në lidhje me aspekte të dizenjimit të veshjeve dhe mjedisit të shtëpisë. Përmbajtja e planifikuar synon orientimin e nxënësit në profesione që lidhen me fushën e artit, modës, arredimit të mjediseve etj.

3. Veprimtari në shërbimin e klientit

RM 1: Nxënësi përshkruan shërbimin e klientit.

RM 2: Nxënësi komunikon në mënyrë efektive me klientin.

RM 3: Nxënësi kryen në forma të ndryshme kontaktin në shërbimin ndaj klientit.

RM 4: Nxënësi vendos marrëdhënie me klientin.

Referuar rëndësisë që ka sot sektori i shërbimeve, i cili punëson rreth 48 % të forcës aktive për punë, përmbajtja dhe veprimtaritë e planifikuara në këtë program kanë si qëllim aftësimin e nxënësve me disa prej shprehive

dhe teknikave të nevojshme që krijojnë dhe forcojnë këtë marrëdhënie, duke gjeneruar përfitime të dyfishta si në aspektin personal për vetë nxënësin, por edhe për shoqërinë në përgjithësi. Moduli “Veprimtari në shërbimin e klientit” synojnë orientimin e nxënësve në karriera që lidhen me sektorin e shërbimeve, si një sektor me mundësi të lartë punësimi në ekonominë shqiptare.

3. Estetika dhe trucku

RM 1: Nxënësi përshkruan aplikime të estetikës së trupit.

RM 2: Nxënësi ekzaminon lëkurën dhe kryen trajtime të thjeshta.

RM 3: Nxënësi kryen truckun korrektiv sipas protokollit.

RM 4: Nxënësi kryen makijazhin.

Ky modul ka për qëllim të njohë nxënësin me aspekte të trajtimeve estetike të lëkurës, si dhe i aftëson ata për të kryer ekzaminime dhe trajtime të thjeshta të fytyrës, korrektimin e fytyrës si dhe makijazhin.

Përmes këtij moduli nxënësi merr informacion për profilin profesional të estetistit si një mundësi për orientimin në këtë sektor.

4. Veprimtaritë bujqësore

RM 1: Nxënësi përshkruan kuptimin, rëndësinë dhe rolin e bujqësisë në ekonominë e vendit dhe në mjedis.

RM 2: Nxënësi zbukuron mjedise me lule, pemë dhe shkurre dekorative.

RM 3: Nxënësi realizon shtimin vegjetativ të bimëve.

RM 4: Nxënësi mbjell fidanë frutorë.

Ky modul ka për qëllim të njohë nxënësit me rëndësinë, rolin që ka bujqësia për zhvillimin ekonomik, ndikimin që kanë veprimtaritë bujqësore në mjedis, si dhe i aftëson ata për të përdorur teknika të thjeshta të zbukurimit të mjediseve me bimë dekorative, apo për shartimin e drurëve frutorë. Përmes këtij moduli nxënësi zbulon mundësitë e karrierës në bujqësi si një nga degët kryesore të zhvillimit të ekonomisë Shqiptare.

5. Veprimtari ndihmëse në laborator

RM 1: Nxënësi përgatit laboratorin për punë.

RM 2: Nxënësi prodhon aroma bimore.

RM 3: Nxënësi vlerëson cilësinë e produktit ushqimor (ujit, qumështit, djathit, vajit, pijeve joalkoolike etj) në laborator.

Ky modul ka për qëllim të njohë nxënësit me llojet dhe veçoritë e laboratorëve, si dhe i aftëson ata për të përgatitur laboratorin për punë dhe për të kryer veprimtari të thjeshta profesionale në laborator si prodhim të aromave bimore apo analizën e produkteve ushqimore.

Ky modul ka për qëllim të orientojë nxënësit në fusha profesionale që lidhen me punët në laboratorë të llojeve të ndryshme si mundësi për punësim.

7. Kujdesi për kafshët e shoqërimit

RM 1: Nxënësi përshkruan rëndësinë dhe rolin e kafshëve shtëpiake dhe të shoqërimit.

RM 2: Nxënësi kujdeset për kafshët e vogla të shoqërimit.

RM 3: Nxënësi kujdeset për shpendët dekorativ.

Moduli ka për qëllim të njohë nxënësit për rëndësinë dhe rolin që kanë kafshët shtëpiake në shoqërinë e sotme, si dhe i aftëson ata të kujdesen për kafshët e shoqërimit dhe shpendët dekorativ. Përmes këtij moduli nxënësit njohin mundësitë e karrierës në drejtime profesionale që lidhen me kujdesin ndaj kafshëve.

8. Asistencë zyre

RM 1: Nxënësi shpjegon detyrat dhe procedurat e punës së asistentit të zyrës.

RM 2: Nxënësi përdor pajisjet e zyrës, programet informatike dhe komunikon nëpërmjet tyre.

RM 3: Nxënësi administron korrespondencën, harton dokumente dhe shkëmben informacione.

RM 4: Nxënësi organizon pritje e takime pune.

Moduli ka për qëllim të njohë dhe të aftësojë nxënësit për të kryer procedura të thjeshta të punës së asistentit të zyrës si, për krijimin

dhe arkivimin e dokumentacionit të zyrave, menaxhimin e mbledhjeve e pritjeve etj. Ky modul synon të orientojë nxënësit në profesione që lidhen me fushën e shërbimeve të sekretarisë, menaxhimit të zyrës apo menaxhimit të biznesit.

9. Përpunim i produkteve ushqimore

RM 1: Zbatimi i teknologjisë ushqimore në përpunimin e produkteve ushqimore.

RM 2: Nxënësi prodhon produkte të brumit (bukë, kiflet, pica, biskota).

RM 3: Nxënësi kryen procese të përpunimit të frutave e perimeve.

RM 4: Nxënësi kryen procese të përpunimit të qumështit.

Ky modul i njeh nxënësit me aspekte të përpunimit të produkteve ushqimore, si dhe i aftëson ata të përgatisin prodhime të thjeshta ushqimore sipas proceseve teknologjike. Moduli krijon mundësi që nxënësit të njohin lloje të profesioneve dhe profile profesionale që lidhen me industrinë e përpunimit të produkteve ushqimore si mundësi potenciale për punësim.

10. Punime të riparimit dhe mirëmbajtjes mekanike

RM 1: Nxënësi përshkruan punimet e thjeshta të riparimit dhe mirëmbajtjes mekanike.

RM 2: Nxënësi kryen mirëmbajtje dhe riparime të biçikletës.

RM 3: Nxënësi kryen zëvendësime të pjesëve të bravave të dyerve.

RM 4: Nxënësi kryen mirëmbajtje të thjeshta të automjetet e lehta.


RM 5: Nxënësi kryen punime të thjeshta të riparimit dhe zëvendësimit në pajisje të ndryshme mekanike me përdorim shtëpiak.

Moduli ka për qëllim të njohë dhe të aftësojë nxënësit për të kryer punime të thjeshta të riparimit dhe të mirëmbajtjes mekanike në makina dhe pajisje të ndryshme mekanike, për përdorim shtëpiak. Ky modul synon njohjen e profesioneve që lidhen me aspekte të shërbimit dhe riparimit të makinave, por edhe të shërbimeve mekanike në kushtet e shtëpisë.

Nga përshkrimi i qëllimit të moduleve mund të vihet re se një nga funksionet kryesore që kanë modulet profesionale është orientimi për punë

në fushën që prek moduli. Kjo specifikë përshkruhet më qartë në materialet mësimore mbështetëse ku edhe jepen skema të rrugëve të karrierës në sektorë të ndryshëm. Më poshtë është shembulli i bujqësisë ku përshkruhet rruga e karrierës për profesione specifike në këtë sektor.

Për zbatimin e moduleve mësuesit duhet të mbajnë parasysht rekomandimet si më poshtë:



- Çdo RM duhet të realizohet për një kohëzgjatje të caktuar, duke mbajtur parasysh që orët e planifikuara të janë shumëfisha të 3 orëve mësimore, kjo me qëllim që llogaritja e krediteve të jetë e lehtë. Mësuesit në varësi të modulit dhe udhëzimeve për çdo modul llogaritin orët e nevojshme për çdo RM. *Në të gjitha modulet RM1 që është njohje me fushën profesionale ku është përzgjedhur moduli, të realizohet në jo më shumë se 9 orë mësimore.*
- Nxënësit duhet të përmbushin jo më pak se dy RM, ku RM1 është rezultat mësimor paraprak (hyrës), me orientim teorik, i detyrueshëm të përmbushet nga të gjithë nxënësit përpara përmbushjes së RM-ve të tjera.
- Rezultatet mësimore nga RM2 deri te RM6 janë me orientim praktik.
- Nxënësit duhet të zgjedhin për të kryer të paktën njërin nga RM-të praktike, kjo sipas interesave dhe dëshirave të tyre, si dhe sipas mundësive të shkollës për t'i ofruar.
- Një nxënës fiton të paktën $\frac{1}{2}$ -1 krediti (kur përmbush RM1 + një nga RM-të praktike, p.sh $9+9 = 18$ orë mësimore). Për çdo RM tjetër praktik që përmbush, nxënësit i shtohen orët mësimore duke shtuar dhe vlerën e kreditit.
- Pas përmbushjes së RM1 teorik, gjatë përmbushjes së RM-ve praktike, në varësi të kushteve dhe mjediseve që ofron shkolla, nxënësit mund të ndahen në dy ose më shumë grupe që angazhohen në përmbushjen e dy ose më shumë RM-ve paralelisht.

Të gjitha rekomandimet më sipër janë sugjeruese jo detyruese për realizimin e moduleve në shkollë.

2.3. Kushtet për realizimin e moduleve

Bazuar në burimet dhe mundësitë shkolla duhet:

- të përcaktojë listën e moduleve që do të ofrojë për nxënësit e shkollës, duke mbajtur parasysh kushtet e shkollës, përzgjedhjet paraprake që kanë bërë nxënësit, marrëveshjet me biznesin etj;
- të përcaktojë mësuesit përgjegjës, vendin e realizimit, kohën e realizimit;

- të grupojë nxënësit sipas zgjedhjes.

Modulet sipas natyrës dhe kushteve që ka shkolla mund të trajtohen plotësisht në shkollë, pjesërisht në shkollë dhe pjesërisht në biznes ose mund të realizohen plotësisht në biznes.

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset dhe materialet e nevojshme sipas kërkesës në çdo modul.

Për të gjithë modulet është hartuar **materiali mësimor mbështetës**, i cili përmban udhëzime të përgjithshme dhe specifike për realizimin e modulit dhe që është një bazë paraprake për realizimin e moduleve. Të gjitha materialet mësimore mbështetëse janë publikuar në faqen e internetit të IZHA-s.

Ky material i hartuar për çdo modul, përbëhet nga udhëzime didaktike për modulën, material teorik, udhëzime praktike për mësuesin dhe nxënësin për zhvillimin e veprimtarive praktike, fletë pune për nxënësin, udhëzues pune, si dhe modele të instrumenteve të vlerësimit për çdo rezultat mësimor. Materiali është një shembull për zhvillimin e mëtejshëm të tij nga mësuesi në shkollë.

10 materialet mësimore janë hartuar nga specialistë të profesionit, si dhe mësues apo instruktorë të arsimit profesional.

Mësuesi duhet të mbajë parasysh që në rubrikën e parë **“Udhëzime të përgjithshme për realizimin e modulit”**, përshkruhet qëllimi i programit të modulit profesional, objektivat e përgjithshme për realizimin e modulit, kushtet e nevojshme për realizimin e modulit, udhëzimet e nevojshme didaktike, si dhe mënyra e vlerësimit të nxënësit në lidhje me modulet profesionale.

Rubrika e dytë e materialeve mësimore mbështetëse **“Udhëzime sipas rezultateve mësimore (RM) të parashikuara në modul”** përmban për çdo RM, material të bollshëm teorik, si dhe udhëzime për mësuesin për zhvillimin e mësimin. Në këtë rubrikë për çdo RM jepen shembuj të detyrave, fletë pune dhe udhëzues pune për realizimin konkret të modulit nga nxënësit.

Krahas materialit teorik këto fletë pune duhet t'i shpërndahen nxënësve.

Materiali mësimor përmban modele të fletëve të vlerësimit të aftësisë “Listë kontrolli”, si dhe sugjerime për vlerësimin e aspekteve teorike.

2.4. Udhëzime didaktike për realizimin e moduleve

Për realizimin e moduleve mësuesit apo personat përgjegjës nga biznesi (nëse arrihet marrëveshje) duhet të përdorin sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete të teknikave dhe procedurave të punës të parashikuara në modul.

Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për kryerjen e veprimtarive të parapërgatitjes dhe të realizimit të detyrave të parashikuara në programin e modulit, fillimisht në mënyrë të mbikëqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur. Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me proceset e punës që kryejnë.

Realizimi i mësimit ka rëndësi parësore për arritjen e rezultateve të parashikuara të nxënësit. Për këtë sugjerohet që mësuesi të planifikojë mësimin, duke mbajtur parasysh rezultatet mësimore të parashikuara në programin e modulit, si dhe të shpjegojë termat dhe konceptet kryesore duke i vënë theksin demonstrimit të procedurave të punës në veprimtarinë e parashikuar në RM-në përkatëse.

Mësuesi duhet të mbikëqyrë nxënësit bazuar në udhëzuesit e përmbushjes së proceduarve të punës si për veprimtaritë individuale ashtu edhe për punët në grup.

Gjatë zhvillimit të mësimit, mësuesi sugjerohet të lidhi tematikën dhe aftësinë që trajtohet me përvoja nga realiteti konkret i veprimtarisë me qëllim që të krijohen kushte për diskutime, debate e argumentime dhe ndihmon nxënësit t'i përshtatin lehtësisht njohuritë në praktikë.

Përshkrimet e thjeshta teorike të termave apo koncepteve që trajtohen, si dhe modele të shumta të veprimtarive praktike në formë loje sugjerohen me qëllim që nxënësit të ndihen entuziastë dhe të motivuar, si dhe ndihmon ata për të kuptuar mesazhin dhe arritjen e objektivit të të mësuarit.

Zbatimi në praktikë i programit duhet të zhvillohet kryesisht bazuar në veprimtaritë apo lojëra praktike, të cilat duhet të demonstrohen dhe administrohen nga mësuesi. Mësuesi/ja mund të nxitë nxënësit duke i simuluar në punë konkrete, por edhe duke analizuar shembuj të nxjerrë nga jeta apo përvojat personale të nxënësve.

Modulet sugjerohet të kenë vetëm 20 % teori dhe 80 % veprimtari praktike.

Mësuesi për realizimin e modulit duhet të pozicionohet më tepër në rolin e moderatorit, se sa të mësuesit klasik.

Për të planifikuar dhe realizuar mësimin mund të mbahen parasysht hapat si më poshtë:

- Nxënësit mund të ndahen në grupe apo të punojnë individualisht.
- Përcaktohet dhe formulohet qartë detyra, problemi ose çështja që ka lidhje me veprimtarinë që do të realizojnë nxënësit.
- Jepen detaje apo shpjegime shtesë nëse është e nevojshme.
- Në rastin e veprimtarive konkrete praktike shpërndahet udhëzuesi me hapat apo procedurat për të realizuar veprimtarinë (mësuesi parapakisht duhet ta ketë demonstruar vetë aftësinë që kërkohet).
- Përcaktohet koha për të realizuar detyrën e dhënë.
- Prezantohet apo demonstronhet puna.
- Në fund mësuesi bën përmbledhjen.

Për të realizuar mësimin bazuar te programi i përzgjedhur i modulit ***mësuesi duhet të hartojë planin e detajuar të modulit*** për realizimin e mësimit. Për të realizuar këtë plan më poshtë po sugjerojmë një format, i cili përkon me karakterin praktik të modulit dhe nxit *planifikimin e mësimit, duke u bazuar te veprimtaritë që do të realizojë mësuesi dhe nxënësi referuar programit përkatës.*

Plani mësimor i propozuar përmban disa rubrika të paraqitura në kolona (shih tabelën e modelit të planit mësimor si më poshtë. Çdo rubrikë duhet të plotësohet nga mësuesi përgjegjës referuar shpjegimeve si më poshtë:

1. Në kolonën e parë paraqitet numri rendor i RM-së sipas programit të modulit.
2. **Rezultatet mësimore/Koha** - Në këtë kolonë shënohet emërtimi i RM-së sipas programit dhe shënohet koha që parashikon mësuesi për të realizuar këtë RM. Programet kanë sugjeruar kohën për të gjithë modulën, në ndonjë rast në materialet mësimore mbështetëse është dhënë ndonjë sugjerim për kohën (orët) e nevojshme për të realizuar RM-të, por është mësuesi që do të zhvillojë modulën, që do të përcaktojë sa kohë i duhet për të zhvilluar mësimin, duke mbajtur parasysht:
 - veçoritë e RM-së, teorike, teoriko –praktike apo praktike;
 - numrin e nxënësve;

- bazën materiale dhe kushtet për të realizuar RM-në;
 - vendin ku do të realizohet mësimi, në klasë, biznes apo pjesërisht në klasë dhe pjesërisht në biznes;
 - kohën që duhet për të shpjeguar, demonstruar aftësinë;
 - kohën që duhet për detyrat e pavarura të nxënësve;
 - kohën që duhet për të bërë vlerësimin e nxënësve.
3. **Veprimtaritë mësimore** - Në këtë kolonë listohen veprimtaritë që do të realizojë mësuesi dhe nxënësi referuar përmbajtjes së RM-së. Për të plotësuar këtë rubrikë mbahen parasysh njohuritë e reja teorike dhe veprimtaritë që do të realizojë mësuesi janë shpjegimi, prezantimi, dhënia e shembujve etj. Gjithashtu nxënësi mund të prezantojë projekte, zhvillojë diskutime për çështjen që trajton RM-ja etj. Në rastin kur RM-ja është praktike, veprimtaritë duhet të fokusohen te demonstrimi nga mësuesi apo specialisti i tregut, praktikimi nga nxënësi i aftësisë së parashikuar, te vlerësimi i nxënësit etj (shih shembujt e shprehjes së aftësisë në tabelën e mëposhtme).
4. **Koha** - Në këtë kolonë parashikohet koha për çdo veprimtari të shënuar. Koha e planifikuar për çdo RM vendosur në kolonën e parë ndahet më tej sipas veprimtarive të planifikuara në kolonën e tretë.
5. **Instrumentet e vlerësimit** - Këtu duhet të shënohet si do të vlerësohet nxënësi, pra, duhet të mbahet parasysh që aspektet teorike vlerësohen me pyetje-përgjigje me gojë dhe test me shkrim, ndërsa aftësia praktike, duke e mbikëqyrur nxënësin me listë kontrolli. Sugjerohet që pas çdo RM-je nxënësi të vlerësohet me notë.
6. **Vendi** – Këtu përcaktohet konkretisht ku do të zhvillohet mësimi për RM-në, në klasë apo në biznes, apo pjesërisht në klasë dhe pjesërisht në biznes etj.

Për të plotësuar rubrikat e shabllonit mësuesi përgjegjës duhet të

Modeli Plani Mësimor

Mësuësi:.....

Plani i mësimor për modulën profesionale: “.....Emri i modulit.....”

Klasa 10 – 36 orë mësimore

Nr	Rezultatet mësimore/Koha	Veprimtaritë mësimore	Koha	Instrumentet e vlerësimit	Vendi	Kërkesa për realizimin
1	Nxënësi përshkruan.... (4 orë)	-Shpjegim dhe argumentim me shembuj për	1 orë	-Test me shkrim	Në klasë ose në biznes	-Instrumente -Instrumente shënimi (pikues, shënues, shkumës).
		-Demonstrim i	1 orë	-Listë kontrolli		
		-Praktikim i nxënësve për				
		-Demonstrim i				
		-Praktikim i nxënësve për				
-Praktikim i nxënësve për	1 orë	-Demonstrim i matjes				
-Praktikim i nxënësve për	1 orë	-Praktikim i nxënësve për				
-Demonstrim i	1 orë	-Praktikim i nxënësve për				
-Praktikim i nxënësve për	1 orë	-Praktikim i nxënësve për				
2	Nxënësi kryen (6 orë)	-Rikujtim i rregullave.	1 orë	-Listë kontrolli	Në klasë ose në biznes	-Skica
		-Shpërndarja e skicave	1 orë			
		-Demonstrim i	2 orë			
		-Praktikim i nxënësve për				
		-Demonstrim i				
-Praktikim i nxënësve për	2 orë					
-Praktikim i nxënësve për	2 orë					
-Vlerësim i nxënësve për	2 orë					

ndjekë hapat e mëposhtëm:

A. **Studimi i modulit përkatës:**

- 1) orët totale të planifikuara;
- 2) qëllimi i përgjithshëm i modulit;
- 3) RM të planifikuara;
- 4) përmbajtjet e planifikuara për çdo RM;
- 5) kriteret e vlerësimit.

B. **Studimi i RM-së së parë, të dytë etj...**

- 1) analiza e RM-së;
- 2) përcaktimi i teorisë dhe aftësive që do të zhvillojë mësuesi për RM-në e parë;
- 3) studimi i literaturës, përvojave etj;
- 4) planifikimi i tematikave të hollësishme që duhet të zhvillojë mësuesi për RM-në e parë;
- 5) përcaktimi i afateve kohore për secilën çështje që do të trajtohet;
- 6) planifikimi i objektivave për secilën tematikë specifike;
- 7) përcaktimi i metodave që duhet të përdorë për të arritur objektivat e përcaktuara (planifikimi i projekteve, detyrave, veprimtarive praktike që do të zhvillojë), bazuar në kushtet dhe njohuritë e mësuesit;
- 8) planifikimi i kushteve mësimore (mediave pedagogjike) për realizimin e mësimit;
- 9) përcaktimi i mënyrës dhe instrumentit të vlerësimit.

C. **Zhvillimi i planit të detajuar të programit të modulit bazuar në formatin e dhënë:**

- 1) renditja e RM-ve dhe orëve përkatëse sipas modulit;
- 2) renditja e veprimtarive që do të zhvillojë mësuesi për secilën RM;
- 3) vendosja e kohës për secilën çështje apo veprimtari;
- 4) zhvillimi i objektivave mësimore specifike për secilën çështje apo veprimtari;
- 5) renditja e metodave mësimore të nevojshme për realizimin e objektivave të planifikuara;
- 6) shkrimi i instrumenteve të vlerësimit që do të përdoren nga

- mësuesi për vlerësimin e nxënësit në lidhje me objektivat e përcaktuara;
- 7) shkrimi i bazës materiale të nevojshme për realizimin e objektivave të përcaktuara.

2.5. Vlerësimi i nxënësit për modulet profesionale

Vlerësimi i nxënësit për modulet profesionale duhet të udhëhiqet nga funksioni dhe vendi që ato kanë në kurrikulën e gjimnazit. Duke iu referuar karakterit praktik të tyre, gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike.

Nxënësi mund të vlerësohet për aktivizimin gjatë orës së mësimi, aktivizimin në punën në grup, në simulimin e roleve, në demonstrimin e aftësisë etj.

Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit, të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

Vlerësimi për njohuritë teorike të kryhet përmes pyetjeve dhe përgjigjeve me gojë, testit me shkrim, si dhe detyrave apo projekteve të pavarura.

Vlerësimi i aftësive praktike të kryhet përmes vëzhgimit të demonstrimit praktik me listë kontrolli.

Për të realizuar **vlerësimin e nxënësit duhet të hartohen instrumentet e vlerësimit të modulit**, të cilat duhet të mundësojnë mësuesin që të vërtetojë nëse nxënësi ka fituar kompetencën ose rezultatin e të mësuarit, apo jo.

Për këtë, nxënësi duhet të demonstrojë konkretisht nëse është i aftë ta ushtrojë atë kompetencë. Shembuj të instrumenteve të vlerësimit (kontrollit) janë:

- pyetje-përgjigje me gojë;
- pyetje-përgjigje me shkrim;
- pyetje me zgjedhje të shumëfishtë;
- vëzhgim praktik me listë kontrolli;
- projekt-detyrë etj.

Nëpërmjet instrumenteve të vlerësimit, mësuesi merr informacion të mjaftueshëm në lidhje me realizimin e proceseve të demonstruara nga nxënësit. Instrumentet e vlerësimit japin informacion mbi njohuritë, aftësitë

dhe qëndrimet e nxënësit.

Duke mbajtur parasysh orientimin nga veprimtaritë praktike të moduleve profesionale, krahas vlerësimit tradicional mund të sugjerohet vlerësimi i nxënësit bazuar në *portofolin e vlerësimit*.

Çfarë është portofoli i vlerësimit?

Portofoli është koleksionimi/grumbullimi i një serie punësh/kontributesh të mbledhura nga nxënësit, bazuar në një qëllim të përcaktuar qartë, për të nxjerrë në pah përpjekjet, progresin dhe arritjet e tyre në shumë aspekte. Koleksionimi mund të përmbledhë pjesëmarrjen/aktivizimin e nxënësit (Paulson, Paulson, Meyer 1991). Në këtë mënyrë një portofol është një koleksion i punës së një nxënësi. Qëllimi i përgjithshëm i portofolit është që të mundësojë jo vetëm njohjen nga nxënësi, i progresit të tij, por edhe të tregojë për të tjerët arritjet dhe ecurinë në vazhdimësi. Vlera më e madhe e portofolit është se, nxënësit bëhen pjesëmarrës aktivë në procesin e të mësuarit dhe vlerësimit. Një portofol është një koleksion sistematik i punës së nxënësit për të pasqyruar progresin në një ose më shumë fusha të përmbajtjes. Një portofol është një përmbledhje e punës së kryer me kalimin e kohës, që pasqyron proceset, produktet, arritjet e progresin dhe kjo është e vlefshme për mësuesin dhe nxënësin.

Model vlerësimi për veprimtarinë praktike:

Shembull: Model listë kontrolli

RM 2: “Zbukurimi i mjediseve të jashtme bimë dekorative”

Në kolonat “**PO**” dhe “**JO**” të listës së kontrollit të dhënë më lart.

<i>Nr</i>	<i>Hapat e realizimit</i>	<i>PO</i>	<i>JO</i>
1	A përcaktoi nxënësi vendin për zbukurim?		
2	A analizoi nxënësi sipërfaqen e vendit të caktuar?		
3	A identifikoi nxënësi bimët dekorative ekzistuese?		
4	A përcaktoi nxënësi bimët e reja dekorative që dëshiron të mbjellë?		
5	A skicoi nxënësi modelin kompozues të mjedisit në letër?		

6	A përdori nxënësi kompjuterin për të kompozuar bimët dekorative për vendin e caktuar?		
7	A paraqiti nxënësi modelin e kompozuar të mjedisit të dekoruar?		
8	A përzgjedhi nxënësi modelin më optimal për zbukurimin e mjedisit?		
9	A përgatiti nxënësi një plan të mbjelljes së bimëve dekorative?		
10	A përgatiti nxënësi vendin për mbjelljen e bimëve dekorative?		
11	A mbolli nxënësi bimë dekorative?		
12	A u shërbeu nxënësi bimëve dekorative pas mbjelljes?		
13	A krasiti nxënësi bimët dekorative?		
14	A u kujdes vazhdimisht nxënësi për mjedisin e zbukuruar me bimë dekorative?		
15	A zbatoi nxënësi rregullat e sigurimit teknik e të mbrojtjes së mjedisit?		

Shënohet respektivisht “+” dhe “-” për çdo kryerje apo mos kryerje të hapave të punës.

Si pjesë e kurrikulës me zgjedhje të lirë, referuar dhe udhëzimeve të MASH-it, nxënësi, pas realizimit të moduleve profesionale, vlerësohet me notë dhe merr kreditet përkatëse.

2.6. Shkolla harton module profesionale bazuar në modelin e 10 programeve dhe materialeve mbështetëse

Modulet e hartuar nga IZHA, janë një model që çdo shkollë të mund të zhvillojë më tej këto RM të reja ose të hartojë module të tjera sipas mundësive dhe kushteve të shkollës. Që të realizojë këtë, shkolla duhet të ndjekë hapat si më poshtë:

- të përcaktojë personat përgjegjës për zhvillimin/përshtatjen e moduleve me zgjedhje të lirë;
- të analizojë kapacitetet njerëzore, mjediset, bazën materiale në

dispozicion;

- të analizojë orientimin dhe prirjet e rajonit ku ndodhet shkolla;
- të përcaktojë volumin kohor për përmbajtjet që do të ofrojë, pra sa orë, javë nxënësit do të zhvillojnë këtë përmbajtje;
- të përcaktojë nëse kjo përmbajtje do të realizohet e shpërndarë përgjatë gjithë vitit apo do të ofrohet e grupuar, pra në fund të semestrit apo viti shkollor;
- të njohë dhe organizojë përmbajtjen e përzgjedhur sipas formatit modular (Aneks 3, “Modele të tjera të moduleve).

III. Udhëzime praktike për realizimin e moduleve profesionale në gjimnaz

3.1. Organizimi i përzgjedhjes së moduleve nga nxënësit.

Kurrikula me zgjedhje në gjimnaz, detyron shkollën të hartojë një listë të posaçme sipas kushteve të saj. Bazuar në listën e përpiluar paraprakisht shkolla menaxhon procesin e përzgjedhjes si më poshtë:

- Në lidhje me periudhën kur duhet të realizohet zgjedhja:
 - për nxënësit e klasës 10-të dhe 11-të për në klasën e 11-të dhe 12-të, zgjedhja mund të organizohet nga shkolla në periudhën maj-qershor;
 - për nxënësit e klasës së 9-të mund të realizohet gjatë muajve prill-maj.
- Nxënësit duhet të sqarohen dhe orientohen përpara se të bëjnë zgjedhjet bazuar në formularin që shpërndan shkolla për përzgjedhjen e moduleve profesionale.
- Çdo nxënës dhe prind ka të drejtë të jetë plotësisht i informuar për modulet profesionale që u ofrohet për zgjedhje. Nxënësit dhe prindërit e tyre duhet të njihen jo thjesht me titullin e modulit, por edhe me një përshkrim përmbledhës të secilit modul profesional që ofron shkolla, si dhe kushtet e realizimit të tij.
- Për klasën e 9-të, mund që shkolla e mesme të aktivizojë grupe pune me pjesëmarrës nxënës të klasave më të larta, si dhe mësues, të cilët do të bëjnë përshkrimin e moduleve tek nxënësit e shkollave 9- vjeçare, kjo në bazë të ndarjes zonale të shkollave.

(Do të ishte mirë që këto të realizoheshin në orët e orientimit të karrierës, të cilat bëhen në semestrin e parë sipas udhëzimit të MASH, por mund të sugjerohet që të vazhdohet të zhvillohen edhe në semestrin e dytë për aspekte të zgjedhjes.)

Shkollat e mesme në periudhën kur nxënësit e klasës së 9-të do të bëjnë zgjedhjet e tyre, pra në periudhën prill – maj të organizojnë “Ditë të Hapura” në shkollat e tyre për të pritur nxënësit e klasës së 9-të të shkollave 9-vjeçare, të cilët mund të jenë të shoqëruar dhe me prindër, në mënyrë që të njihen më mirë me ofertat e moduleve profesionale që ofron shkolla.

Nxënësi _____ (emër, mbiemër, nënshkrimi)

Unë prindi _____ miratoj, zgjedhjen e
mësipërme të fëmijës tim.

Prindi _____ (emër, mbiemër, nënshkrimi)

Mësuesi kujdestar _____ (emër, mbiemër, nënshkrimi)

Tiranë, më _____

3.2. Organizimi i planit orar të shkollës për realizimin e moduleve.

Një aspekt i rëndësishëm për realizimin me sukses të moduleve profesionale në gjimnaz është organizimi i orarit të shkollës. Paraprakisht duhet që:

- shkolla duhet të përzgjedhë numrin e moduleve që ka mundësi të realizojë referuar përvojës së deritanishme dhe përvojave të shkollave të tjera;
- shkolla të analizojë kushtet dhe mundësitë për realizimin e moduleve (mësues, bashkëpunim me biznesin);
- shkolla të analizojë preferencat e nxënësve dhe të organizojë grupet e nxënësve sipas preferencave;
- shkolla duhet të analizojë mundësitë e bashkëpunimit me tregun rajonal të punës, me komunitetin dhe biznesin, shkollat dhe qendrat e formimit profesionale;
- shkolla duhet të lidhë kontrata bashkëpunimi me partnerët socialë nëse modulet do të realizohen pjesërisht apo plotësisht në biznes.

Modulet mund të realizohen plotësisht në shkollë, plotësisht apo pjesërisht jashtë saj (në biznes, në fermë, në shtëpi, në shkolla dhe qendrat e formimit profesional etj).

Për realizimin e moduleve profesionale, referuar kushteve specifike, shkolla organizon orarin në mënyra të ndryshme, si:

- realizimi i modulit gjatë vitit me ***2 -3 orë mësimore në një ditë të javës;***

- realizimi i modulit në *një ditë të javës*;
- realizimi i modulit në *një javë mësimore në vit*.

Vërejtje: Është e detyrueshme që modulet profesionale të mos planifikohen me 1 orë në javë.

Orari i shkollës në lidhje me realizimin e moduleve duhet të jetë fleksibël, që do të thotë që mund të ndryshohet edhe gjatë vitit shkollor.

- Kur shkolla ka zgjedhur module që realizohen në shkollë, është mirë që për vetë natyrën që kanë këto module, të zhvillohen 2 orë -3 orë në javë të grupuara në një ditë të javës.
- Në rastet kur bashkëpunohet me bizneset është mirë që orët e zhvillimit të moduleve të planifikohen në orët e fundit të mësimit apo shkolla mund të grupojë orët e parashikuara në një apo më shumë javë.
- Për realizimin e moduleve mund të shfrytëzohen dhe orë mësimi pasdite, por kjo me miratim të prindërve dhe nxënësve.
- Kur moduli zhvillohet pjesërisht apo plotësisht në biznes, orët për realizimin e moduleve mund të zhvillohen në të njëjtën periudhë të vitit apo në periudha të ndryshme të vitit për klasa të ndryshme. Kjo mënyrë lehtëson realizimin e qëllimit të këtyre veprimtarive, të cilat kërkojnë një vazhdimësi për t'u realizuar.

3.3. Menaxhimi i stafit mësimor për realizimin e moduleve profesionale.

Realizimi i modulit duhet të kryhet nga mësues të shkollës dhe në pamundësi të realizimit për shkak të specifikës që kanë këto module mund të bashkëpunojë me partnerë nga biznesi.

Për realizimin e modulit mund të angazhohen edhe mësues të arsimit dhe formimit profesional.

Realizimi i moduleve profesionale kërkon koordinimin e tri elementeve që ndikojnë drejtpërdrejtë në garantimin e cilësisë së tyre.

1. Burimet njerëzore, pra mësuesit e shkollës.

2. Procesi mësimdhënies dhe përfshirja e ideve apo metodave novatore të mësimdhënies në realizimin e programeve të moduleve profesionale.
3. Kushtet dhe baza e nevojshme për realizimin e moduleve profesionale.

Përpara përgatitjes së listës së moduleve që do t'u ofrohet nxënësve, drejtoria e shkollës duhet të bëjë përzgjedhjen e mësuesve që do të japin modulet.

Drejtoria e shkollës duhet të mbajë parasysh përgjegjshmërinë, pasionin, përgatitjen e motivimin e mësuesit që do të realizojë modulën përkatës.

Drejtoria e shkollës duhet të marrë parasysh edhe dëshirën që mund të kenë anëtarët e stafit për të zhvilluar module.

Udhëzimet si më poshtë duhet të mbahen parasysh **nga drejtuesit e shkollave** për zbatimin e programeve të moduleve profesionale:

- **Zgjidhni personat e duhur** për modulën profesional përkatës. Rruga për të motivuar mësuesit fillon me aktivizimin e personave të duhur për punën e duhur. Ndodh shpesh që drejtuesit ua japin këtë detyrë mësuesve pa analizuar historikun e kurrikulumit të tyre, pra duhet të aktivizohen ata mësues që kuptojnë misionin e moduleve profesionale, përshtatin mësimdhënien për realizimin sa më të mirë të tyre, si dhe krijojnë mundësi për bashkëpunimin me partnerët socialë. Mësuesi i përzgjedhur mund të zhvillojë si pjesën teorike edhe atë praktike të modulit në mjedisin e shkollës, por mund të zhvillojë vetëm pjesën teorike pasi aspektet praktike zhvillohen në biznese, shkolla/qendra profesionale.

Kur moduli realizohet pjesërisht apo plotësisht jashtë mjediseve të shkollës, mësuesi përgjegjës duhet të jetë prezent për të drejtuar, mbikëqyrur dhe vlerësuar nxënësin.

- **Jepni udhëzime të qarta** në lidhje me orarin, rregulloret e realizimit dhe vlerësimin të moduleve, në lidhje me prioritetet dhe afatet.
- **Menaxhoni cilësinë e realizimit të moduleve.** Drejtuesi duhet të vëzhgojë stafin, si duke komunikuar personalisht me ta, ashtu edhe duke i mbikëqyrur në vendet e tyre të punës. Duke mbajtur parasysh karakterin e moduleve profesionale ndodh që të abuzohet me realizimin e tyre si për shembull, karakteri praktik i tyre të kthehet në teori në klasë

(duhet të mbahet parasysh se vetëm 20% e përmbajtjes së moduleve është teori).

- **Jini transparentë** për menaxhimin e financave të shkollës (nëse ka). Modulet profesionale janë një dritare për të shtuar financat e shkollës. Bashkëpunimet e frytshme me partnerë të ndryshëm socialë mund të sjellin mundësi për sponsorizime të aktiviteteve të shkollës. Të gjithë këto hapa duhet të jenë sa më transparentë.
- **Jini sa më realistë me pritshmëritë** për realizimin e moduleve profesionale. Iniciativat janë të rëndësishme, por mund të jenë edhe të rrezikshme nëse nuk janë realiste. Mësuesve mund t'u ulet motivimi nëse përcaktohen objektiva të paarritshme. Mësuesit duhet të jenë pjesë e hartimit të planit vjetor të shkollës.
- **Motivoni stafin** duke iu kushtuar vëmendje dëshirave të tyre personale, si dhe duke respektuar idetë dhe sugjerimet.

IV. Udhëzime për bashkëpunimin e gjimnazit me biznesin

4.1 Mënyrat e bashkëpunimit të gjimnazeve me bizneset

Bashkëpunimi i shkollës me botën e punës për orientimin e nxënësve për karrierën dhe veçanërisht për realizimin e moduleve profesionale në gjimnaz, mund të shihet në dy nivele: në *nivel qendror* (politik) dhe në *nivel shkollor* (institucional).

Me nivel qendror bashkëpunimi konsiderohen marrëveshjet mes ministrive, drejtorive arsimore apo zyrave arsimore me bizneset rajonale.

Porshkollapërmes rrugëve të ndryshme mund të krijohë ura bashkëpunimi për realizimin e moduleve profesionale si në biznese ashtu dhe në mjediset e praktikës së shkollave dhe qendrave të formimit profesional.

Pavarësisht nga mënyra se si mund të realizohet ky bashkëpunim, në themel të tij qëndron interesi reciprok. Në këtë kontekst, fushat e bashkëpunimit janë të shumta dhe më poshtë, po rendisim ato më kryesoret.

a) Trajnimi dhe marrja e përvojave e personelit mësimdhënës në biznese

Mësuesit të cilët zhvillojnë module profesionale pavarësisht nga përgatitja fillestare duhet të kenë kontakte të vazhdueshme me zhvillimet në fushën profesionale që prek moduli. Veç literaturës, materialit mësimor mbështetës informacioni që merret drejtpërdrejt nga ndërmarrjet (vizita, mbikëqyrje e nxënësve në punë konkrete) ndihmon dukshëm në nivelin profesional të personelit mësimdhënës.

b) Në realizimin e aspekteve praktike të modulit

Shfrytëzimi i mjediseve të punës në ndërmarrje për kryerjen e RM-ve praktike është ndoshta mekanizmi më efektiv për praktikimin e aftësive të punës të parashikuara në modulet. Kjo përfaqëson dhe fushën më të gjerë (por edhe më problematike) të bashkëpunimit midis shkollës dhe biznesit. Në ndërmarrje nxënësit gjejnë mjedisin profesional më ideal ku kryhen proceset reale të punës, ku vepron teknika konkrete dhe ku ata hyjnë në marrëdhënie, jo vetëm me teknologjinë, por edhe me njeri-tjetrin apo punëtorët e tjerë.

c) Në vlerësimin e nxënësve

Në rastet kur RM-të trajtohen pjesërisht apo plotësisht në biznes, referimi ndaj asaj që nxënësi do të përmbushë në një ndërmarrje, është primar.

d) Në përdorimin e personelit të përbashkët

Është e pranuar që nuk mund t'u mësosh të tjerëve diçka që nuk e zotëron, për këtë arsye angazhimi i specialistëve të biznesit në procesin mësimor bën që nxënësit të marrin ato aftësi të planifikuara në modul dhe që realizohen në ndërmarrje.

e) Në kryerjen e veprimtarive të përbashkëta

Një shprehje mjaft e fuqishme e partneritetit shkollë-ndërmarrje është kryerja e veprimtarive të përbashkëta, si analiza të produkteve në treg, analiza e nevojave për produkte apo shërbime të ndryshme.

Po kështu, shkolla të veçanta mund të venë në dispozicion të ndërmarrjes mjediset e tyre, si dhe personelin e specializuar, për kryerjen e kërkimeve apo dhe eksperimenteve në drejtim të teknologjive të reja.

Model**MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI
NDËRMJET****SHKOLLËS** _____**DHE****INSTITUCIONIT / NDËRMARRJES** _____

Për formalizimin e kontakteve ndërmjet të dy palëve lidhur me këmbimin e përvojave më të mira dhe cilësore ndërmjet shkollës dhe biznesit, për zhvillimin e moduleve profesionale dhe vizitave të ndërsjella me interes reciprok.

Shkollaka si pjesë të programeve mësimore zhvillimin e moduleve profesionale duke bashkëpunuar me biznesin lokal. Praktika përbën një komponent të rëndësishëm në programin mësimor. Ajo ka për qëllim: aftësimin e nxënësve në punën konkrete në firma dhe institucione, njohjen e shërbimeve dhe kërkesave në praktikën e punës së përditshme.

Në këtë kuadër, duke vlerësuar mbështetjen e deritanishme nga ana e institucionit / firmës suaj.

Shkolla merr përsipër:

- angazhimin dhe vënien në dispozicion të nxënësve për kryerjen e moduleve profesionale sipas nevojave, kërkesave dhe periudhës kohore të realizimit të tyre;
- të shoqërojë me mësues gjatë kohës së praktikës nxënësit e saj për të bërë kontrollin e frekuentimit të nxënësve dhe kontaktojë me personat përgjegjës në mbarëvajtjen e punës për pajisjen e nxënësve me aftësi profesionale;
- përmirësimin e planeve dhe programeve mësimore sipas nevojave të tregut të biznesit.

Institucioni / Biznesi merr përsipër:

- të mundësojë në kohë dhe sektorë të konsideruar të përshtatshëm për realizimin e moduleve nga nxënësit në formën e moduleve profesionale.

Nxënësi duhet:

- të respektojë rregulloren e institucionit/firmës;
- të shprehë gatishmërinë për të marrë përsipër detyra të praktikës së punës në institucion/firmë;
- të marrë pjesë dhe të kontribuojë në aktivitetet që organizon institucioni/firma.

Drejtoreshë e shkollës

Drejtori i biznesit

4.2. Përshkrimi i punës për mësuesin përgjegjës për realizimin e moduleve profesionale jashtë shkollës

Mësuesi që do të këqyrë nxënësit në biznes mund të quhet:

Koordinator i Marrëdhënieve me Partnerët për realizimin e moduleve profesionale.

Qëllimi i punës së tij është sigurimi dhe forcimi i bashkëpunimit të shkollës me bizneset, partnerët socialë e potencialë të rajonit për të realizuar modulet profesionale pranë tyre.

Për këtë detyrë mund të zgjidhet një anëtar i stafit mësimdhënës të shkollës, i propozuar nga drejtorja e shkollës.

Ky mësues në bashkëpunim me drejtorinë e shkollës vendos për lidhje me partnerët socialë të identifikuar, ai përgjigjet përpara drejtorisë së shkollës ku punon për realizimin e këtyre detyrave si më poshtë:

Detyrat	Veprimtaritë
1. Mbikëqyr realizimin e moduleve profesionale që realizohen jashtë shkollës.	<ul style="list-style-type: none"> - Mban të dhëna mbi aktivitetin e moduleve profesionale. - Mban një grafik të dhënash për marrëveshjet e bizneseve për vendet e caktuara të praktikave dhe ua bën ato të njohura drejtorisë dhe mësueseve të tjerë. - Harton një plan vjetor të punës.
2. Identifikon dhe mban lidhje me partnerëve socialë në lidhje me fushat e realizimit të moduleve profesionale.	<ul style="list-style-type: none"> - Zhvillon dhe azhurnon vazhdimisht një listë (emri, adresa, tel, e-mail, fusha e veprimtarisë, interesi i bashkëpunimit etj.) të partnerëve socialë potencialë në rajon. - Mban lidhje të vazhdueshme me partnerët ekzistues nëpërmjet takimeve apo kontakteve elektronike, telefonike të paktën një herë në javë. - Kontakton vazhdimisht biznese të reja dhe iu prezanton shkollën dhe qëllimin e bashkëpunimit me të.

<p>3. Koordinon bashkëpunimin me arsimin dhe formimin profesional.</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Organizon takime me shkolla të arsimit dhe formimit profesional. - Organizon aktivitete të përbashkëta me partnerët socialë/aktorët e AFP. - Është përgjegjës kryesor për informimin dhe garantimin e pjesëmarrjes së bizneseve dhe partnerëve të tjerë socialë në ditën e dyerve të hapura të shkollës.
<p>4. Detyra të tjera</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Organizon dhe shoqëron nxënësit në vizita në biznese të ndryshme të rajonit. - Promovon dhe reklamon ofertën mësimore të shkollës në komunitetin rajonal të nxënësve, bizneseve etj. - Organizon dhe bën të mundur që pjesë të veçanta të mësimdhënies (tema të veçanta) të realizohen nga ekspertë të biznesit. - Siguron pjesëmarrjen e specialistëve të bizneseve lokalë në vlerësimin e moduleve profesionale. - Mban lidhje të vazhdueshme me shkolla të tjera të rajonit apo vendit.
<p>5. Dokumentimi i punës së bërë dhe raportimi në drejtorinë e shkollës.</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Dokumenton punën e kryer për modulet profesionale. - Përgatit procesverbalet e diskutimeve me partnerët socialë të kontaktuar. - Dërgon raporte të shkruara në drejtorinë e shkollës mbi ecurinë e punës.

3.3. Dosja e punëve të nxënësve dhe vlerësimi

Gjatë praktikës në biznese nxënësit plotësojnë një dosje ku përshkruajnë çfarë ata realizojnë. Nxënësit shënojnë aktivitetet e rëndësishme të çdo dite. Një herë në javë ata përshkruajnë në detaje detyrat. Nxënësit mund të bëjnë listën e punimeve të kryera.

V. Shtojca

ANEKS 1.

PROGRAMET E 12 MODULEVE PROFESIONALE

*INSTITUTI I ZHVILLIMIT TË ARSIMIT
PROGRAMET E KURRIKULËS ME ZGJEDHJE TË GJIMNAZIT*

MODULI: ESTETIKA DHE TRUKU

*PROGRAMI I MODULIT ME ZGJEDHJE
PËR TË GJITHA KLASAT*

TIRANË, NËNTOR 2011

PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli	ESTETIKA DHE TRUKU
Qëllimi	Një modul që njeh nxënësit me estetikën dhe profilin profesional të estetistit, me aspekte të trajtimeve estetike të lëkurës si dhe i aftëson ata për të kryer ekzaminime dhe trajtime të thjeshta të fytyrës, korrektimin e fytyrës si dhe makijazhin.
Kohëzgjatja e modulit	Minimumi i detyruar 36 orë mësimore.

Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	RM 1	<p>Nxënësi përshkruan aspekte të trajtimeve të estetikës së trupit.</p> <p><i>Përmbajtja:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - Historia e estetikës dhe estetika e trupit. - Profili profesional i estetistit. - Procedurat e punës në profesionin e estetistit. - Higjiena e mjeteve dhe pajisjeve të punës në kabinetin estetik. - Komunikimi, pritja dhe shkëmbimi i informacionit me klientin. - Parapërgatitja dhe pozicionimi i klientit për trajtimin e fytyrës. <p><i>Instrumentet e vlerësimit:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Pyetje – përgjigje me gojë.</i> - <i>Vëzhgim me listë kontrolli.</i> <p>Kriteret e vlerësimit:</p> <p>Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të shpjegojë kronologjinë e zhvillimit të estetikës në përgjithësi dhe asaj të trupit në veçanti; - të përshkruajë aspekte të profilit profesional të estetistit; - të listojë procedurat e punës në profesionin e estetistit; - të shpjegojë rregullat dhe procedurat e higjienës së mjeteve dhe pajisjeve të punës në kabinetin estetik; - të përshkruajë rregullat e komunikimit, pritjes dhe shkëmbimit të informacionit me klientin; - të kryejë procedurat e punës për parapërgatitjen dhe pozicionimin e klientit për trajtimin e fytyrës.
	RM 2	<p>Nxënësi kryen ekzaminimin dhe trajtimet e thjeshta të fytyrës</p> <p><i>Përmbajtja:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - Lëkura dhe shtresat e saj. - Tipologjia e lëkurës. - Format kozmetike të produkteve. - Procedura e ekzaminimit të gjendjes së lëkurës së fytyrës.

	<ul style="list-style-type: none"> - Teknika e pastrimit të fytyrës. - Shpëlarja e fytyrës së klientit. - Teknika e vendosjes së kremi esfoliant. - Trajtimi i fytyrës me solucion tonik. - Vendosja e maskës në fytyrë, sy, buzë, qafë dhe dekolte. - Shpëlarja e fytyrës, për të hequr maskën. - Teknika e masazhit të fytyrës, syve, buzëve, qafës dhe dekoltesë, me vaj masazhi. - Vendosja në fytyrë e kremi përfundimtar. <p>Instrumentet e vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Pyetje – përgjigje me gojë.</i> - <i>Test me shkrim.</i> <p>Kriteret e vlerësimit:</p> <p>Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të shpjegojë ndërtimin, veçoritë dhe karakteristikat e saj; - të dallojë shtresat e lëkurës; - të përshkruajë tipologjinë e lëkurës sipas karakteristikave të ndryshme; - të dallojë produktet për kozmetike; - të renditë sipas procedurës hapat për ekzaminimin e lëkurës së fytyrës; - të kryejë pastrimin të fytyrës me teknikën dhe produktet përkatëse; - të kryejë shpëlarjen e fytyrës së klientit me teknikën dhe produktet përkatëse; - të kryejë vendosjen e kremi esfoliant me teknikën e duhur; - të kryejë trajtimin e fytyrës me teknikën dhe produktet e duhura; - të kryejë vendosjen e maskës në fytyrë, sy, buzë, qafë dhe dekolte; - të kryejë heqjen e maskës me teknikën dhe produktet përkatëse; - të kryejë masazhin e fytyrës, syve, buzëve, qafës dhe dekoltesë me teknikën dhe produktet përkatëse; - të vendosë kremi përfundimtar me teknikën dhe produktet përkatëse.
--	---

	<p>RM 3 Nxënësi kryen korrektimin e fytyrës.</p> <p><i>Përmbajtja:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - Korrigjimet e defekteve të fytyrës. - Pastrimi i lëkurës së fytyrës së klientit. - Procedura e vendosjes së korrektorit në vendet e duhura të fytyrës. - Procedura e vendosjes së kremit pudër në fytyrën e klientit. - Procedura e vendosjes së ngjyrave në mollëza, me anë të furçës. - Procedura e konturimit të syve të klientit, me laps. - Procedura e ngjyrosjes së kapakëve të syve të klientit. - Teknika e vendosjes së rimelit në qerpikë. - Procedura e konturimit të syve me penel. - Procedura e konturimit të buzëve me laps. - Procedura e ngjyrosjes së buzëve me penel. - Procedura e fiksimit të trukut të fytyrës, me spray. <p><i>Instrumentet e vlerësimit:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Pyetje – përgjigje me gojë.</i> - <i>Test me shkrim.</i> <p>Kriteret e vlerësimit:</p> <p>Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të shpjegojë llojet e defekteve të fytyrës dhe mënyrat e korrigjimit me anë të trukut; - të pastrojë lëkurën e fytyrës së klientit me teknikën dhe produktin e duhur; - të vendosë korrektorin në vendet e duhura të fytyrës me teknikën e duhur; - të vendosë kremin pudër në fytyrën e klientit me teknikën e duhur; - të vendosë ngjyra në mollëza, me anë të furçës me teknikën e duhur; - të bëjë konturimin e syve të klientit me laps, me teknikën e duhur; - të bëjë ngjyrosjen e kapakëve të syve të klientit me teknikën e duhur;
--	--

		<ul style="list-style-type: none"> - të vendosë rimelin në qerpikë me teknikën e duhur; - të bëjë konturimin e syve, me anë të penelit me teknikën e duhur; - të konturojë buzët me teknikën e duhur; - të bëjë ngjyrosjen e buzëve me teknikën e duhur; - të bëjë fiksimin e trukut të fytyrës, me teknikën e duhur; - të respektojë rregullat e higjienës dhe sigurisë në punë gjatë korrektimit të fytyrës.
	<p>RM 4</p>	<p>Nxënësi kryen makijazhin e fytyrës <i>Përmbajtja:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - Llojet e makijazhit sipas rasteve. - Kryerja e makijazhit transparent. - Kryerja e makijazhit për pjesën e parë të ditës. - Kryerja e makijazhit për pasdite. - Kryerja e makijazhit për mbrëmje. - Kryerja e makijazhit skenik. <p><i>Instrumentet e vlerësimit:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Pyetje – përgjigje me gojë.</i> - <i>Vëzhgim me listë kontrolli.</i> <p>Kriteret e vlerësimit Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të shpjegojë llojet e makijazhit sipas rasteve; - të dallojë produktet kryesore që përdoren për kryerjen e makijazhit; - të kryejë makijazhin transparent me produktet dhe teknikën e duhur; - të kryejë makijazhin për paradite me produktet dhe teknikën e duhur; - të kryejë makijazhin për pasdite me produktet dhe teknikën e duhur; - të kryejë makijazhin për mbrëmje me produktet dhe teknikën e duhur; - të kryejë makijazhin skenik me produktet dhe teknikën e duhur.

<p>Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e nxënësve</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Ky modul duhet të trajtohet në klasë të përshtatshme për të realizuar përmbajtjet e modulit, apo në klasat e parukeri-estetikës, në qendrat e trajnimit profesional për këtë profesion. Rekomandohen edhe vizita në sallone/ reparte të tjera ku kryhen procedura të estetikës, trukut dhe makijazhit. - Mësuesi/ja duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete të procedurave dhe teknikave të parapërgatitjes dhe të kryerjes së trajtimeve të parashikuara në modul dhe të përdorimit të mjeteve dhe materialeve të nevojshme. - Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për realizimin e procedurave të parashikuara në modul fillimisht në mënyrë të mbikëqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur. - Rekomandohet metoda e “lojës me role”, ku nxënësit kryejnë jo vetëm funksionin e parukieres-estetistes, por edhe si klientë. - Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e procedurave. - Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.
<p>Baza materiale e domosdoshme</p>	<p>Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> - klasë apo laborator i parukeri-estetikës me poste pune për realizimin e modulit; - kompleti i veglave, pajisjeve dhe materialeve të nevojshme për të bërë trajtimin e klientëve; - media didaktike (CD) për konkretizimin e njohurive; - katalogë, manuale, udhëzues, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.

*INSTITUTI I ZHVILLIMIT TË ARSIMIT
PROGRAMET E KURRIKULËS ME ZGJEDHJE TË GJIMNAZIT*

MODULI: ASISTENCË ZYRE

*PROGRAMI I MODULIT ME ZGJEDHJE
PËR TË GJITHA KLASAT*

TIRANË, QERSHOR 2012

PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli	VEPRIMTARI PËR ASISTENCË ZYRE
Qëllimi	Një modul që njeh dhe aftëson nxënësit për të mbikëqyrur dhe menaxhuar procedurat e thjeshta të punës së asistentit të zyrës si, në kryerjen e detyrave për krijimin dhe arkivimin e dokumentacionit të zyrave, si dhe menaxhimin e mbledhjeve e pritjeve.
Kohëzgjatja e modulit	Minimumi i detyruar 36 orë mësimore.
Niveli i parapëlqyer për pranim	Duhet të jenë nxënës të gjimnazit.

<p>Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit</p>	<p>RM 1</p>	<p>Nxënësi shpjegon detyrat dhe procedurat e punës si asistent zyre</p> <p><i>Përmbajtja:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - Kuptimi dhe rëndësia e profesionit të asistentit të zyrës. - Detyrat e asistentit të zyrës. - Përgjegjësitë e asistentit të zyrës. - Rregullat e komunikimit efektiv. - Elementët e komunikimit. - Njohuritë për parimet kryesore të organizimit të punës. - Njohuritë për planifikimin e punës. - Njohuritë për menaxhimin e arshivës. - Njohuri për administrimin e zyrës. <p><i>Kriteret e vlerësimit:</i></p> <p>Nxënësi duhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të shpjegojë kuptimin e asistentit të zyrës; - të dallojë asistentin e zyrës nga operatori i thjeshtë i zyrës; - të shpjegojë detyrat e asistentit të zyrës; - të shpjegojë përgjegjësitë e asistentit të zyrës; - të shpjegojë rëndësinë e komunikimit; - të shpjegojë elementët e komunikimit; - të shpjegojë rregullat bazë të komunikimit; - të shpjegojë dhe të përdorë rregullat e një komunikimi efektiv; - të dallojë elementet bazë të aftësive të komunikimit; - të shpjegojë rëndësinë e organizimit të punës; - të dallojë elementët bazë të organizimit të punës; - të shpjegojë elementët bazë të planifikimit; - të shpjegojë rëndësinë e arkivimit të dokumentacionit; - të shpjegojë rregullat bazë të arkivimit të dokumentacionit; - të dallojë veçoritë e arkivimit të dokumentacionit me dosje dhe në mënyrë elektronike.
---	--------------------	---

	<p>RM 2</p>	<p>Nxënësi përdor pajisjet e zyrës, programet informatike dhe komunikon nëpërmjet tyre</p> <p><i>Përmbajtja:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - Organizon vendin e punës. - Përdor telefonin dhe faksin. - Përdor Windows-in në punët e zyrës. - Përdor Ms-Word në punën e zyrës. - Përdor Ms-Exel për punët e zyrës. - Përdor Internetin për punët e zyrës. - Përdor printerin për punët e zyrës. - Përdor skanerin për punët e zyrës. - Përdor fotokopjen për punët e zyrës. <p><i>Instrumentet e vlerësimit:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - Vëzhgim me listë kontrolli. <p><i>Kriteret e vlerësimit:</i></p> <p>Nxënësi duhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të shpjegojë rregulla të thjeshta të organizimit të vendit të punës; - të shpjegojë rregullat e komunikimit me telefon; - të përdorë telefonin për komunikim; - të përdorë faksin për dërgesa të dokumenteve; - të përdorë Ms-Word për formulimin e dokumenteve; - të përdorë Ms-Exel për formulimin e tabelave të ndryshme; - të përdorë Power-point për prezantimin e dokumentacionit të zyrës; - të përdorë internetin për marrjen e dokumentacionit në mënyrë elektronike; - të përdorë internetin për dërgimin e dokumenteve në mënyrë elektronike; - të përdorë internetin për marrje e informacionit të nevojshëm; - të përdorë faksin për printimin e dokumenteve të ndryshëm; - të përdorë skanerin për punë të ndryshme; - të përdorë fotokopjen në formate të ndryshme.
--	--------------------	--

	<p>RM 3</p>	<p>Nxënësi administron korrespondencën, harton dokumente dhe shkëmben informacione.</p> <p><i>Përmbajtja:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - Hap, ndan dhe shpërndan korrespondencën (përfshirë këtu fakset dhe e-mail-in). - Merr, nënshkruan dhe shpërndan Postën, DHL apo dërgesa të ngjashme. - Kryen procedurat në nisje të postës apo dërgesave të ngjashme. - Krijon dhe modifikon dokumente të faturave. - Krijon dhe modifikon raporte të ndryshme. - Përgatit përgjigje të shkresave të ardhura si dhe letrat përcjellëse. - Përgatit vërtetime, autorizime, informacione e njoftime zyrtare. - Përgatit kërkesa dhe oferta të ndryshme. <p><i>Instrumentet e vlerësimit:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Vëzhgim me listë kontrolli.</i> <p><i>Kriteret e vlerësimit:</i></p> <p>Nxënësi duhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të shpjegojë rregullat e marrjes, ndarjes dhe shpërndarjes së korrespondencës me poste; - të shpjegojë rregullat e marrjes, ndarjes dhe shpërndarjes së korrespondencës me fakse; - të shpjegojë rregullat e marrjes, ndarjes dhe shpërndarjes së korrespondencës elektronike; - të shpjegojë rregullat e marrjes dhe dërgimit të pakove me postë të thjeshtë dhe të shpejtë; - të krijojë dhe modifikojë dokumente të faturave; - të krijojë raporte për punë të ndryshme; - të përgatisë shkresa përcjellëse dhe përgjigje të shkresave në mbërritje; - të përgatisë dokumente autorizuese, vërtetime, informuese; - të përgatisë dokumente ofertë dhe kërkesë; - të përgatisë statistika të thjeshta.
--	--------------------	---

	RM 4	<p>Nxënësi organizon pritje e takime pune.</p> <p>Përmbajtja:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Organizon dhe koordinon punën për mbledhje pune. - Organizon dhe koordinon punën për pritje të ndryshme. <p>Instrumentet e vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Vëzhgim me listë kontrolli.</i> <p>Kriteret e vlerësimit:</p> <p>Nxënësi duhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të shpjegojë elementët për të organizuar mbledhje apo takime pune; - të shpjegojë elementët për të patur një mbarëvajtje të mirë të mbledhjeve; - të organizojë një mbledhje apo takim pune duke zbatuar elementët e organizimit; - të drejtojë një mbledhje duke zbatuar rregullat e mbarëvajtjes së mbledhjeve.
<p>Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e nxënësve</p>		<ul style="list-style-type: none"> - Ky modul duhet të trajtohet në shkollë. - Mësuesi duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur shembuj dhe demonstrime konkrete të dokumenteve që përdoren në zyra. - Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete fillimisht në mënyrë të mbikëqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur. Ata duhet të nxiten të marrin pjesë në aktivitetet që organizon shkolla e tyre. - Rekomandohet metoda e “lojës me role”, ku nxënësit kryejnë jo vetëm funksionin e asistentit të zyrës, por edhe te partnerit në biznes. - Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për asistentin e zyrës. - Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.
<p>Kushtet e e domosdoshme për realizimin e modulit</p>		<p>Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset dhe materialet e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Klasë e përshtatshme për zhvillimin e modulit. - Katalogë, manuale, udhëzues, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.

*INSTITUTI I ZHVILLIMIT TË ARSIMIT
PROGRAMET E KURRIKULËS ME ZGJEDHJE TË GJIMNAZIT*

MODULI: PËRPUNIM I PRODUKTEVE USHQIMORE

*PROGRAMI I MODULIT ME ZGJEDHJE
PËR TË GJITHA KLASAT*

TIRANË, QERSHOR 2011

PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli	PËRPUNIM I PRODUKTEVE USHQIMORE
Qëllimi	Një modul praktik që i njeh nxënësit me përpunimin e produkteve ushqimore dhe i aftëson ata të përpunojnë lëndë të para bimore apo shtazore për të përgatitur prodhime të thjeshta ushqimore sipas proceseve teknologjike.
Kohëzgjatja e modulit	Minimumi i detyruar 36 orë mësimore.
Niveli i parapëlqyer për pranim	Duhet të jenë nxënës të gjimnazit.

<p>Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit</p>	<p>RM 1</p>	<p>Nxënësi shpjegon aspekte të përpunimit të produkteve ushqimore në industrinë ushqimore. <i>Përmbajtja:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - Fushat e zbatimit të teknologjisë ushqimore. - Evolucionin dhe zhvillimet në teknologjinë ushqimore. - Sistemi teknologjik ushqimor. - Ruajtja e produkteve ushqimore, siguria ushqimore ambalazhimi, etiketimi. - Metodatat e konservimit të produkteve ushqimore. <p><i>Instrumentet e vlerësimit:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Vëzhgim me listë kontrolli.</i> <p><i>Kriteret e vlerësimit:</i> Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të dallojë fushat e zbatimit të teknologjisë ushqimore; - të përshkruajë evolucionin dhe zhvillimet në teknologjinë ushqimore; - të analizojë sistemin teknologjik ushqimor sipas elementeve specifike të tij; - të shpjegojë rolin dhe mënyrat e ruajtjes së produkteve ushqimore si faktor kryesor për krijimin e produkteve të reja, cilësinë dhe sigurinë ushqimore; - të identifikojë elementët e sigurisë ushqimore, të ambalazhimit, etiketimit; - të dallojë metodatat e konservimit të produkteve ushqimore sipas parimeve bazë të konservimit.
	<p>RM 2</p>	<p>Nxënësi prodhon produkte të brumit (bukë, kifle, pica, biskota) Përmbajtja:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Përgatitja e vendit dhe mjeteve të punës. - Përzgjedhja e recetës sipas llojit të produktit që do të prodhohet. - Përzgjedhja e lëndëve të para, sipas recetës/recepturës. <p><u>- Procedura e prodhimit të bukës.</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Përgatitja e miellit, ujit, lëndëve ndihmëse

		<p>dhe shtesave përmirësuese sipas recepturës.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Hedhja e miellit, ujit, lëndëve ndihmëse, shtesave përmirësuese në brumëgatuese. - Gatimi i brumit në brumëgatuese. - Përcaktimi i gatishmërisë së brumit. - Vendosja e brumit në vendin/enën për fermentimin e parë. - Copëtimi i brumit në mënyrë manuale ose me makineri copëtuese/dozuese. - Dhënia e formës së dëshiruar në mënyrë manuale/makineri formuese. - Dekorimi i brumit (para ose pas pjekjes). - Vendosja e brumit në tavë/formë për fermentimin e dytë. - Vlerësimi organo-shqisor i përfundimit të fermentimit të dytë të brumit. - Pjekja e bukës. - Sistemimi i bukës për ftohje/kullim pas pjekjes. <p>- Procedura e prodhimit të kifleve.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Përgatitja e lëndëve të para dhe ndihmëse (sipas recepturës/recetës). - Parapërgatitja e shtesave për prodhimin e kifleve. - Përgatitja e mbushësve (marmelatë, çokokrem, krem pastiçerie). - Gatimi i brumit me maja industriale. - Përgatitja e brumit për mbushje. - Mbushja e brumit me shtesat e përgatitura (para ose pas pjekjes). - Dekorimi i kifleve para/pas pjekjes. - Pjekja e kifleve, sipas llojit. <p>- Procedura e prodhimit të picës.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Përgatitja e miellit, ujit, lëndëve ndihmëse dhe shtesave sipas recetës/recepturës. - Parapërgatitja e përbërësve për shtrimin/dekorimin e picës. - Hedhja e miellit, ujit, lëndëve ndihmëse, shtesave përmirësuese në brumëgatuese. - Përgatitja e brumit të picës në brumëgatuese. - Përcaktimi i gatishmërisë së brumit.
--	--	---

		<ul style="list-style-type: none"> - Vendosja e brumit në vendin/enën për fermentimin e parë. - Copëtimi/formimi i brumit në mënyrë manuale/makineri. - Vendosja e brumit në tavë/formë për fermentimin e dytë. - Vendosja e përbërësve të picës mbi brumë-picën e përgatitur. - Pjekja e picës. - Procedura e prodhimit të biskotave. - Përgatitja e miellit, lëndëve ndihmëse dhe shtesave për prodhimin e biskotave sipas recetës/recepturës. - Hedhja e miellit, ujit, lëndëve ndihmëse dhe shtesave përmirësuese në brumëgatuese sipas radhës dhe veçorive të recetës. - Përgatitja e brumit në mënyrë manuale/brumëgatuese. - Copëtimi i brumit të biskotave në mënyrë manuale/makineri. - Formimi i brumit të biskotave në mënyrë manuale/ makineri. - Vendosja e brumit të formuar në tava/forma. - Dekorimi i biskotave para/pas pjekjes. - Pjekja e biskotave. - Mirëmbajtja e mjeteve, pajisjeve dhe makinerive. - Pastrimi i vendit të punës duke respektuar rregullat higjieno-sanitare. - Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit në linjën e prodhimit të brumërave. - Instrumentet e vlerësimit: - Vëzhgim me listë kontrolli. - Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: <ul style="list-style-type: none"> - të përgatisë vendin dhe mjetet e punës sipas rregullores së brendshme të repartit të prodhimit të brumërave; - të përzgjedhë recetën sipas llojit të produktit që do të prodhohet;
--	--	---

		<ul style="list-style-type: none"> - të përzgjedhë lëndët e para, sipas recetës/recepturës dhe sipas llojit të produktit që do të prodhohet; - të kryejë procedurën për prodhimin e bukës: <ul style="list-style-type: none"> - të përgatisë miellin, ujin, lëndët ndihmëse dhe shtesat përmirësuese sipas recetës/recepturës; - të hedhë miellin, ujin, lëndët ndihmëse dhe shtesat përmirësuese në brumëgatuese sipas recepturës dhe procedurave standarde; - të gatujë brumin në brumëgatuese sipas procedurave standarde dhe kartës teknologjike; - të përcaktojë gatishmërinë e brumit sipas treguesve cilësorë; - të vendosë brumin në vendin/enën për fermentimin e parë sipas kartës teknologjike; - të copëtojë brumin në mënyrë manuale ose me makineri copëtuese/dozuese sipas recetës; - të kryejë dhënie e formës së dëshiruar në mënyrë manuale/makineri formuese; - të dekorojë brumin (para ose pas pjekjes) sipas recetës; - të vendosë brumin në tavë/formë për fermentimin e dytë sipas kartës teknologjike; - të kryejë vlerësimin organo-shqisor të përfundimit të fermentimit të dytë të brumit sipas kërkesave për brumin e fermentuar; - të pjekë bukën sipas parametrave standarde dhe kartës teknologjike; - të sistemojë bukën për ftohje/kullim pas pjekjes sipas rregullave standarde për kullimin/ftohjen e bukës; - të kryejë procedurën për prodhimin e kifleve: <ul style="list-style-type: none"> - të përgatisë lëndët e para e ndihmëse sipas recepturës/recetës; - të parapërgatitë shtesat e nevojshme për prodhimin e kifleve sipas recetës/recepturave; - të përgatisë mbushësit e nevojshëm për prodhimin e kifleve (marmelatë, çokokrem, krem pastiçerie) sipas recetës;
--	--	--

		<ul style="list-style-type: none"> - të gatujë brumin me maja industriale sipas kartës teknologjike; - të përgatisë brumin për mbushje sipas recetës; - të kryejë mbushjen e brumit (para ose pas pjekjes) sipas recetës; - të dekorojë kiflet para/pas pjekjes sipas recetës; - të pjekë kiflet, sipas parametrave standarde/llojit dhe kartës teknologjike; - të kryejë procedurën për prodhimin e picës: <ul style="list-style-type: none"> - të përgatisë miellin, ujin, lëndët ndihmëse dhe shtesat sipas recetës/recepturës; - të parapërgatitë përbërësit për shtrimin/dekorimin e picës sipas recetës; - të hedhë miellin, ujin, lëndët ndihmëse, shtesat përmirësuese në brumëgatuese sipas radhës/recepturës; - të përgatisë brumin e picës në brumëgatuese sipas kartës teknologjike; - të përcaktojë gatishmërinë e brumit të picës sipas treguesve cilësorë; - të vendosë brumin në vendin/enën për fermentimin e parë sipas kartës teknologjike; - të copëtojë/formojë brumin në mënyrë manuale/makineri sipas recetës; - të vendosë brumin në tavë/formë për fermentimin e dytë sipas kartës teknologjike; - të vendosë përbërësit e picës mbi brumëpicën e përgatitur sipas recetës/llojit të picës; - të kryejë pjekjen e picës sipas parametrave standarde dhe kartës teknologjike; - të kryejë procedurën për prodhimin e biskotave: <ul style="list-style-type: none"> - të përgatisë miellin, lëndët ndihmëse dhe shtesat për prodhimin e biskotave sipas recetës/recepturës; - të hedhë miellin, ujin, lëndët ndihmëse dhe shtesat përmirësuese në brumëgatuese sipas radhës dhe veçorive të recetës;
--	--	--

		<ul style="list-style-type: none"> - të përgatisë brumin në mënyrë manuale/brumëgatuese; - të copëtojë brumin e biskotave në mënyrë manuale/makineri copëtuese; - të formojë brumin e biskotave në mënyrë manuale/ makineri formuese sipas kartës teknologjike; - të vendosë brumin e formuar në tavë/formë sipas veçorive të recetës; - të dekorojë biskotat para/pas pjekjes; - të pjekë biskotat sipas parametrave standarde/llojit dhe kartës teknologjike; - të mirëmbajë mjetet, pajisjet dhe makineritë sipas udhëzuesit përkatës dhe rregullave të sigurimit teknik; - të pastrojë vendin e punës duke respektuar rregullat higjieno-sanitare; - të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit në linjën e prodhimit të brumërave.
	<p>RM 3</p>	<p>Nxënësi kryen procese të përpunimit të frutave e perimeve <i>Përmbajtja:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - Përgatitja e vendit dhe mjeteve të punës. - Përzgjedhja e recetës sipas llojit të produktit që do të prodhohet. - Përzgjedhja/seleksionimi i frutave e perimeve sipas standardit dhe llojit të produktit që do të përftohet. - <i>Procedura e prodhimit të lëngjeve të frutave e perimeve.</i> <ul style="list-style-type: none"> - Larja e frutave dhe perimeve në mënyrë manuale/makineri (larëse universale). - Copëtimi i frutave dhe perimeve në makineri copëtuese (me cilindra, me disk, me shnek). - Ngrohja e frutave dhe perimeve të copëtuara në dublikator me këmishë (në 65 °C). - Nxjerrja e lëngut të frutave e perimeve me anë të presimit, centrifugimit etj sipas llojit të lëngut.

		<ul style="list-style-type: none"> - Kthjellimi i lëngut të frutave e perimeve (për lëngjet që do prodhohen të kthjellëta). - Konservimi (pasterizim/sterilizim/trajtim me mikrovalë/trajtim me acid benzoik/SO₂/CO₂ etj) në varësi të llojit të lëngut që do të prodhohet. - Ambalazhimi/ruajtja e lëngut të prodhuar nën 15 °C. - Procedura e prodhimit të kompostos. <ul style="list-style-type: none"> - Larja e frutave në mënyrë manuale/makineri larëse universale. - Përmasimi i frutave për prodhimin e kompostos. - Pastrimi/prerja ose jo e frutave sipas llojit. - Përvëlimi i frutave (blansherimi). - Përgatitja e shurupit të sheqerit. - Mbushja e ambalazhit me fruta (në gjendje të ngrohtë). - Dozimi i shurupit të sheqerit në ambalazh sipas raportit masë e ngurtë-lëng. - Mbyllja hermetike e ambalazhit. - Sterilizimi i ambalazhit me komposton e përgatitur (në 105 °C). - Procedura e prodhimit të reçelit dhe konfiturës. <ul style="list-style-type: none"> - Larja e frutave në mënyrë manuale/makineri larëse universale. - Përmasimi i frutave për prodhimin e reçelit dhe konfiturës. - Heqja e cipave, farave/bërthamave, bishtave. - Përvëlimi i frutave sipas llojit/konsistencës së tyre. - Përgatitja e shurupit të sheqerit (i trashë, viskoz dhe i xheluar vetëm për konfiturën). - Zierja disa herë e frutave në shurup sheqeri në aparate të hapura/me zbrazëti (bashkë me pektinën në rastin e prodhimit të konfiturës). - Shtimi i acidit tartrik ose citrik 2-3 minuta para përfundimit të zierjes. - Ftohja 8-12 orë pas çdo zierje. - Ambalazhimi (në të nxehtë) në mënyrë hermetike.
--	--	---

		<ul style="list-style-type: none"> - Pasterizimi (për produktin e përftuar me rreth 65 % lëndë të thatë sipas llojit). - Ftohja e masës së reçelit/konfiturës së prodhuar. - Staxhionimi i reçelit/konfiturës që nuk i janë nënshtruar pasterizimit (deri në 15 ditë në vende të freskëta). - Procedura e prodhimit të marmelatës. <ul style="list-style-type: none"> - Larja e frutave në mënyrë manuale/makineri (larëse universale). - Copëtimi i frutave në makineri copëtuese (me cilindra, me disk, me shnek). - Ngrohja e frutave të copëtuara në dublikator me këmishë (në 65 °C). - Pasurimi i puresë së frutave në pasirka. - Përqendrimi i puresë së frutave (54-60 % sheqer, 1 % acid, 0.5-1.5 % pektinë) sipas llojit në aparatën me zbrazëti. - Dozimi i marmelatës së nxehtë në ambalazh/ ftohja (ose jo për marmelatën që do të sterilizohet). - Procedura e prodhimit të marinadave. - Larja e perimeve në mënyrë manuale/ makineri larëse universale. - Përmasimi i perimeve për prodhimin e marinadave. <ul style="list-style-type: none"> - Pastrimi dhe prerja e perimeve. - Përvëlimi i perimeve të prera e të pastruara (uji me fortësi 10-12 0GJ). - Mbushja e ambalazheve (perime dhe erëza sipas llojit). - Dozimi i tretësirës së acidit acetik/kripës sipas llojit të marinadës që do të prodhohet. - Mbyllja hermetike e ambalazhit. - Sterilizimi i marinadës së prodhuar (në 105 °C). - Procedura e prodhimit të turshive. <ul style="list-style-type: none"> - Larja e perimeve në mënyrë manuale/ makineri larëse universale. - Heqja e pjesëve të padobishme sipas llojit të perimeve.
--	--	---

		<ul style="list-style-type: none"> - Përmasimi i perimeve sipas varietetit/madhësisë/pjekurisë. - Përvëlimi (blansherimi) i perimeve në blansherues. - Ftohja e menjëhershme e perimeve. - Shtrimi i perimeve dhe erëzave sipas llojit të turshive) në kade ose enë të ndryshme. - Përgatitja e lëngut konservues (solucionit të kripës /acidit organik dhe kulturave të pastra ose jo sipas llojit të turshive që do të prodhohen). - Mbulimi i perimeve me lëngun konservues. - Mbikëqyrja e konservimit (me anë të fermentimit) të turshive. - Mirëmbajtja e mjeteve, pajisjeve dhe makinerive në linjat e përpunimit të frutave e perimeve. - Pastrimi i vendit të punës duke respektuar rregullat higjieno-sanitare. - Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit në linjën e prodhimit të bukës. <p>Instrumentet e vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Vëzhgim me listë kontrolli. <p>Kriteret e vlerësimit:</p> <p>Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të përgatisë vendin dhe mjetet e punës në repartin e përpunimit të frutave e perimeve; - të përzgjedhë recetën sipas llojit të produktit që do të prodhohet; - të përzgjedhë/seleksionojë frutat e perimet sipas standardit dhe llojit të produktit që do të përftohet; - të kryejë procedurën e prodhimit të lëngjeve të frutave e perimeve: <ul style="list-style-type: none"> - të kryejë larjen e frutave dhe perimeve në mënyrë manuale/makineri (larëse universale) sipas kartës teknologjike; - të copëtojë frutat e perimet në makineri copëtuese (me cilindra, me disk, me shnek) sipas kartës teknologjike;
--	--	--

		<ul style="list-style-type: none"> - të kryejë ngrohjen e frutave dhe perimeve të copëtuara në dublikator me këmishë (në 65 0C) sipas llojit të frutave dhe perimeve dhe kartës teknologjike; - të kryejë nxjerrjen e lëngut të frutave e perimeve me anë të presimit, centrifugimit etj sipas llojit; - të kthjellojë lëngun e frutave e perimeve për lëngjet që do prodhohen të kthjellëta sipas metodave mekanike(filtrim, dekantim, centrifugim, përzierje)/termike(ngrohje, ftohje, ngrirje)/kimike/(trajtim me xhelatinë, tanine etj)/biologjike(trajtim me biopreparate); - të kryejë konservimin e lëngut (pasterizim/sterilizim/trajtim me mikrovalë/trajtim me acid benzoik/SO2/CO2 etj) në varësi të llojit të lëngut që do të prodhohet sipas kartës teknologjike; - të ambalazhojë/ruajë lëngun e frutave e perimeve të prodhuar (nën 15 0C) sipas rregullave të ambalazhimit dhe ruajtjes; - të kryejë procedurën e prodhimit të kompostos: <ul style="list-style-type: none"> - të kryejë larjen e frutave në mënyrë manuale/makineri larëse universale sipas kartës teknologjike; - të përmasojë frutat për prodhimin e kompostos sipas llojit dhe kartës teknologjike; - të pastrojë/presë ose jo frutat sipas llojit të kompostos dhe kartës teknologjike; - të përvëlojë (blansherojë) frutat sipas llojit dhe kartës teknologjike; - të përgatisë shurupin e sheqerit sipas recetës/recepturës dhe kartës teknologjike; - të mbushë ambalazhin me fruta (në gjendje të ngrohtë) sipas rregullave të standardit për dozimin e masës së ngurtë; - të dozojë shurupin e sheqerit në ambalazh me anë të dozatorit sipas raportit masë e ngurtë-lëng;
--	--	---

		<ul style="list-style-type: none"> - të kryejë mbylljen hermetike të ambalazhit me komposton e prodhuar duke përdorur makinerinë mbyllëse automatike; - të sterilizojë ambalazhin me komposton e përgatitur (në 105 0C) në autoklavë sipas formulës së sterilizimit; - të kryejë procedurën e prodhimit të reçelit dhe konfiturës: <ul style="list-style-type: none"> - të kryejë larjen e frutave në mënyrë manuale/ makineri larëse universale sipas kartës teknologjike; - të përmasojë frutat për prodhimin e reçelit dhe konfiturës sipas kartës teknologjike; - të kryejë heqjen e cipave, farave/bërthamave, bishtave të frutave sipas kartës teknologjike; - të përvëlojë (blasherojë) frutat sipas llojit/konsistencës së tyre dhe kartës teknologjike; - të përgatisë shurupin e sheqerit (shurup i trashë, viskoz dhe jo i xheluar për reçelin/i xheluar për konfiturën) sipas recetës dhe kartës teknologjike; - të kryejë zierjen shumëherëshe të frutave në shurup sheqeri në aparate të hapura/me zbrazëti (bashkë me pektinën në rastin e prodhimit të konfiturës); - të shtojë acidin tartrik ose citrik 2-3 minuta para përfundimit të zierjes sipas kartës teknologjike; - të ftohë produktin 8-12 orë pas çdo zierje sipas parametrave dhe kartës teknologjike; - të ambalazhojë (në të nxehtë vetëm produktin që nuk do t'i nënshtrohet pasterizimit) reçelin dhe konfiturën e prodhuar; - të pasterizojë reçelin dhe konfiturën (për produktin e përfutuar me rreth 65 % lëndë të thatë sipas llojit) sipas parametrave të pasterizimit; - të kryejë ftohjen e masës së reçelit/konfiturës së prodhuar sipas parametrave të ruajtjes; - të staxhionojë reçelin/konfiturën që nuk i janë nënshtruar pasterizimit (deri në 15 ditë në vende të freskëta);
--	--	--

		<ul style="list-style-type: none"> - <i>të kryejë procedurën e prodhimit të marmelatës:</i> <ul style="list-style-type: none"> - të kryejë larjen e frutave në mënyrë manuale/ makineri larëse universale sipas kartës teknologjike; - të copëtojë frutat në makineri copëtuese (me cilindra, me disk, me shnek) sipas kartës teknologjike; - të kryejë ngrohjen e frutave të copëtuara në dublikator me këmishë (në 65 0C) sipas llojit të frutave dhe kartës teknologjike; - të kryejë pasirimin e puresë së frutave në pasirka; - të kryejë përqendrimin e puresë së frutave (54-60 % sheqer, 1 % acid, 0.5-1.5 % pektinë) në aparatën me zbrazëti sipas kartës teknologjike; - të dozojë marmelatën e nxehtë në ambalazh (kavanoz, kuti kartoni të parafinuara ose kuti plastike) /ftohë(ose jo për marmelatën që do të sterilizohet) sipas recepturës; - <i>të kryejë procedurën e prodhimit të marinadave:</i> <ul style="list-style-type: none"> - të kryejë larjen e perimeve në mënyrë manuale/makineri larëse universale sipas kartës teknologjike; - të përmasojë perimet për prodhimin e marinadës sipas kartës teknologjike; - të pastrojë/presë ose jo perimet sipas llojit të marinadës dhe kartës teknologjike; - të përvëlojë perimet e prera e të pastruara (uji me fortësi 10-12 0Gj) sipas kartës teknologjike; - të mbushë ambalazhin me (perime dhe erëza sipas llojit) sipas rregullave të standardit për dozimin masës së ngurtë; - të dozojë tretësirën e acidit acetik/kripës sipas llojit të marinadës që do të prodhohet dhe recepturës; - të mbyllë në mënyrë hermetike ambalazhin me anë të makinerisë mbyllëse automatike;
--	--	---

		<ul style="list-style-type: none"> - të sterilizojë ambalazhin me marinadën e përgatitur (në 105 0C) në autoklavë sipas formulës së sterilizimit; - të kryejë procedurën e prodhimit të turshive: <ul style="list-style-type: none"> - të kryejë larjen e perimeve në mënyrë manuale/makineri larëse universale sipas kartës teknologjike; - të largojë pjesët e padobishme të perimeve sipas llojit të perimeve; - të përmasojë perimet për prodhimin e turshive sipas varietetit/madhësisë/pjekurisë dhe kartës teknologjike; - të përvëlojë perimet e prera e të pastruara në blansherues sipas kartës teknologjike; - të kryejë ftohjen e menjëhershme të perimeve sipas kartës teknologjike; - të shtrojë perimet dhe erëzat sipas llojit të turshive) në kade ose enë të ndryshme; - të përgatisë lëngun konservues (solucionin e kripës/acidit organik (kryesisht acid laktik ose me kultura të pastra industriale) sipas llojit të turshive që do të prodhohet; - të kryejë mbulimin e perimeve me lëngun konservues (duke shmangur kontaktin me ajrin) sipas procesit teknologjik të prodhimit të turshive; - të mbikëqyrë konservimin e turshive (me anë të fermentimit) sipas parametrave (pH, temperaturë etj) dhe kartës teknologjike; - të mirëmbajë mjetet, pajisjet dhe makineritë sipas udhëzuesit përkatës dhe rregullave të sigurimit teknik; - të pastrojë vendin e punës duke respektuar rregullat higjieno-sanitare; - të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit në linjën e përpunimit të frutave e perimeve.
--	--	--

	<p>RM 4</p>	<p>Nxënësi kryen procese të përpunimit të qumështit.</p> <p><i>Përmbajtja:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - Përgatitja e vendit dhe mjeteve të punës. - Përzgjedhja e recetës sipas llojit të produktit që do të prodhohet. - Pranimi/vlerësimi i cilësisë së qumështit (vlerësim organo-shqisor, densiteti, aciditeti) sipas kërkesave standarde për cilësinë. - <i>Procedura e prodhimit të qumështit për konsum.</i> <ul style="list-style-type: none"> - Ngrohja në 35-40 °C (në seksionin e rigjenerimit të pasterizatorit me pllaka. - Skremimi i pjesshëm i qumështit/filtrimi në seperator. - Pasterizimi (i ulët, i lartë, HTSHT) i qumështit për konsum në pasterizator me pllaka. - Grumbullimi i qumështit në rezervuarin ftohës në temperaturën +4 °C. - Standardizimi i yndyrës sipas kërkesave të standardit për qumështin për konsum. - Sterilizimi (klasik, UHT direkt dhe indirekt) i qumështit për fëmijë. - Ambalazhimi (para ose pas sterilizimit/ pasterizimit sipas llojit të ambalazhit) në mënyrë hermetike i qumështit. - <i>Procedura e prodhimit të gjalpit.</i> <ul style="list-style-type: none"> - Pastrimi i qumështit për prodhimin e gjalpit. - Ndarja e lyrës nga qumështi në formë kremi me anë të seperatorit. - Standardizimi i yndyrës (30-35 % yndyrë). - Ajrimi i kemit (në aparat me zbrazëti, dezodorator, trajtimi i kemit të ngrohtë me ajër). - Pasterizimi i kemit në temperaturën 83°C. - Ftohja e kemit në temperaturën 13 °C/ staxhionimi fizik. - Staxhionimi biokimik (fermentim në prani të bakteve laktike dhe aromëpërfutuese) i kemit.
--	--------------------	--

		<ul style="list-style-type: none"> - Rrahja e kremit në makineri tundëse për prodhimin e gjalpfit (në tri faza). - Larja e gjalpfit (në dy faza). - Shtrydhja e gjalpfit në tundës-shtrydhës. - Kripja ose jo sipas llojit të gjalpfit që do të prodhohet. - Ambalazhimi/ruajtja e gjalpfit. - Procedura e prodhimit të djathit. - Pastrimi i qumështit për prodhimin e djathit. - Standardizimi i yndyrës së qumështit për prodhimin e djathit. - Pasterizimi i qumështit në pasterizator sipas llojit të djathit. - Ftohja deri në 30 °C. - Mpiksja e qumështit për djathë me kultura të pastra industriale starter. - Kthimi i sipërfaqes/prerje/përzierje për djathërat e butë. - Kthimi i sipërfaqes/prerje/copëtim/ngrohje e dytë/pjekje për djathërat e fortë. - Parapresim/formim/presim përfundimtar sipas llojit. - Staxhionimi/kriposja e djathit sipas llojit. - Mirëmbajtja e mjeteve, pajisjeve dhe makinerive. - Pastrimi i vendit të punës duke respektuar rregullat higjieno-sanitare. - Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit në linjën e përpunimit të qumështit. <p>Instrumentet e vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Vëzhgim me listë kontrolli. <p>Kriteret e vlerësimit:</p> <p>Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të përgatisë vendin dhe mjetet e punës në repartin e përpunimit të qumështit; - të përzgjedhë recetën sipas llojit të produktit që do të prodhohet; - të vlerësojë cilësinë e qumështit sipas kërkesave standarde për cilësinë;
--	--	---

		<ul style="list-style-type: none"> - <i>të kryejë procedurën e prodhimit të qumështit për konsum:</i> <ul style="list-style-type: none"> - të ngrohë qumështin në 35-40 °C (në seksionin e rigjenerimit të pasterizatorit me pllaka; - të skremojë (pjesërisht qumështin) filtrojë në seperator; - të pasterizojë (pasterizim i ulët, i lartë, HTSHT) i qumështit për konsum në pasterizator me pllaka; - të grumbullojë qumështin në rezervuarin ftohës në temperaturën +4 ° C; - të standardizojë yndyrën sipas kërkesave të standardit për qumështin për konsum; - të sterilizojë (sterilizim klasik, UHT direkt dhe indirekt) qumështin për prodhimin e konsumin për fëmijë; - të ambalazhojë (para ose pas pasterizimit/sterilizimit/ sipas llojit të ambalazhit) në mënyrë hermetike qumështin; - <i>të kryejë procedurën e prodhimit të gjalpit:</i> <ul style="list-style-type: none"> - të pastrojë dhe të vlerësojë cilësinë e qumështit (vlerësim organo-shqisor, densiteti) për prodhimin e gjalpit; - të kryejë ndarjen e lyrës nga qumështi në formë kremi me anë të seperatorit; - të standardizojë yndyrën (30-35 % yndyrë). - të ajrisë kremin (në aparat me zbrazëti, dezodorator, trajtimi i kremit të ngrohtë me ajër); - të pasterizojë kremin në temperaturën 830C. - të ftohë kremin në temperaturën 13 0C/të kryejë staxhionimi fizik; - të kryejë staxhionimin biokimik (fermentim në prani të baktereve laktike dhe aromëpërfuese) të kremit; - të rrahë kremin në makineri tundëse për prodhimin e gjalpit (në tre faza); - të lajë gjalpin (në dy faza); - të kryejë shtrydhjen e gjalpit në tundës-shtrydhës.
--	--	--

		<ul style="list-style-type: none"> - të kripë ose jo gjalpin sipas llojit të gjalpit që do të prodhohet; - të ambalazhojë/ruajë gjalpin në vende të freskëta; - të kryejë procedurën e prodhimit të djathit: <ul style="list-style-type: none"> - të pastrojë qumështin për prodhimin e djathit; - të standardizojë yndyrën e qumështit për prodhimin e djathit sipas kartës teknologjike; - të pasterizojë qumështin në pasterizator sipas llojit të djathit dhe kartës teknologjike; - të ftohë qumështin deri në 30 0C, temperaturë në të cilën realizohet mpiksja e djathit; - të kryejë mpiksjen e qumështit për djathë me anë të shtimit të kulturave të pastra industriale (starter); - të kryejë kthimin e sipërfaqes/prerje/përzierje të masës së mpiksur për djathërat e butë; - të kryejë kthimin e sipërfaqes/prerje/copëtim/ngrohje e dytë/pjekje të masës së mpiksur për djathërat e fortë; - të kryejë parapresimin/formimin/presimin përfundimtar sipas llojit; - të staxhionojë/kripë djathin e prodhuar sipas llojit; - të mirëmbajë mjetet, pajisjet dhe makineritë sipas udhëzuesit përkatës dhe rregullave të sigurimit teknik; - të pastrojë vendin e punës duke respektuar rregullat higjieno-sanitare; - të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit në linjën e përpunimit të qumështit.
--	--	--

<p>Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e nxënësve</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Ky modul duhet të trajtohet në mjedise të përshtatura për trajtimin teoriko-praktik të modulit apo në punishte dhe ndërmarje të përpunimit që realizojnë praktikën e parashikuara në modul. - Mësuesi/Specialisti duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete të teknikave dhe procedurave të përgatitjes së lëndëve të para e ndihmëse, proceseve kryesore të përpunimit të produkteve ushqimore. - Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për kryerjen e punimeve të parapërgatitjes dhe të realizimit të prodhimit të nënprodukteve të qumështit, prodhimeve të brumit, konservave të ndryshme të frutave e perimeve, fillimisht në mënyrë të mbikëqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur. Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me proceset teknologjike që ata kryejnë. - Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e përpunimeve të thjeshta teknologjike për prodhimin e nënprodukteve të qumështit, prodhimeve të brumit, konservave të ndryshme, të frutave e perimeve. - Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e kriterëve të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit. - Mësuesi sipas përzgjedhjes së nxënësve dhe kushteve të shkollës realizon RM1 (e detyruar) dhe zgjedh RM e tjera apo pjesë të RM.
<p>Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit</p>	<p>Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Mjedise të përshtatshme për përpunime të thjeshta për prodhimin e produkteve ushqimore (prodhime brumi, conserva fruta-perime, nënprodukte të qumështit). - Kompleti i veglave, pajisjeve dhe instrumenteve të nevojshme për prodhimin e thjeshta të produkteve ushqimore.

*INSTITUTI I ZHVILLIMIT TË ARSIMIT
PROGRAMET E KURRIKULËS ME ZGJEDHJE TË GJIMNAZIT*

MODULI: VEPRIMTARI BUJQËSORE
(Zbukurimi i mjediseve të jashtme me bimë dekorative)

*PROGRAMI I MODULIT ME ZGJEDHJE
PËR TË GJITHA KLASAT*

TIRANË, QERSHOR 2011

PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli	VEPRIMTARI BUJQËSORE
Qëllimi	Një modul që i njeh nxënësit me rëndësinë, rolin që ka bujqësia për zhvillimin ekonomik, ndikimin që kanë veprimtaritë bujqësore në mjedis, si dhe i aftëson ata: të përdorin teknika të thjeshta të zbukurimit të mjediseve me bimë dekorative, me qëllim zbulimin e mundësive të karrierës në një nga degët kryesore të zhvillimit të ekonomisë Shqiptare.
Kohëzgjatja e modulit	Minimumi i detyruar 36 orë mësimore.
Niveli i parapëlqyer për pranim	Duhet të jenë nxënës të gjimnazit.

<p>Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit</p>	<p>RM 1</p>	<p>Nxënësi përshkruan kuptimin rëndësinë dhe rolin e bujqësisë në ekonominë e vendit dhe në mjedis.</p> <p><i>Përmbajtja:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - Kuptimi dhe rëndësia e bujqësisë. - Bujqësia organike dhe prodhimet BIO. - Bujqësia, mjedisi dhe agroekosistemi. - Teknologjia bujqësore dhe ndikimi i saj në mjedis. - Profesionet dhe mundësitë e karrierës në bujqësi. <p><i>Instrumentet e vlerësimit:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Pyetje-përgjigje me gojë</i> - <i>Test me shkrim.</i> <p><i>Kriteret e vlerësimit:</i></p> <p>Nxënësi duhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të përshkruajë kuptimin dhe rëndësinë e bujqësisë në ditët e sotme; - të përshkruajë bujqësinë organike, llojet e produkteve bujqësore; - të përshkruajë lidhjen reciproke midis bujqësisë dhe mjedisit dhe agroekosistemit; - të përshkruajë kuptimin e agroekosistemit dhe rolin e njeriut në ruajtjen ose prishjen e ekuilibrit të ekosistemit natyral; - të përshkruajë kuptimin, fushat dhe ndikimet e teknologjisë në bujqësi; - të përshkruajë profesionet e fushës së bujqësisë, si dhe mundësitë e karrierës në bujqësi.
	<p>RM 2</p>	<p>Nxënësi zbukuron mjedise me bimë dekorative.</p> <p><i>Përmbajtja:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - Përcaktimi i vendit për zbukurim. - Analizimi i kushteve të sipërfaqes së caktuar. - Identifikimi i bimëve dekorative ekzistuese. - Përcaktimi i bimëve të reja dekorative për t'u mbjellë. - Skicimi i modelit/ve kompozues të mjedisit në letër.

	<ul style="list-style-type: none"> - Përdorimi i kompjuterit për kompozimin e bimëve dekorative. - Paraqitja e modelit/ve të kompozuar të mjedisit të dekoruar. - Përzgjedhja e modelit më optimal për zbukurimin e mjedisit. - Përgatitja e planit konkret të mbjelljes së bimëve dekorative. - Përgatitja e vendit për mbjelljen e bimëve dekorative. - Mbjellja e bimëve dekorative. - Përkujdesja pas mbjelljes së bimëve dekorative. - Krasitja formuese e kurorës dhe ato të gjelbra të bimëve dekorative. - Kujdesi i vazhdueshëm për mjedisin e zbukuruar me bimë dekorative. - Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik e të mbrojtjes së mjedisit. <p><i>Instrumentet e vlerësimit:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - Vëzhgim me listë kontrolli. <p><i>Kriteret e vlerësimit:</i></p> <p>Nxënësi duhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të përcaktojë mjedisin (vendin/zonën) për zbukurim me bimë dekorative, sipas kriterëve të duhura; - të analizojë kushtet klimatiko-tokësore të sipërfaqes së caktuar; - të identifikojë bimët dekorative ekzistuese, në vendin e caktuar për zbukurim; - të përcaktojë bimët e reja dekorative që dëshirohet të mbillen, sipas llojeve dhe sasisë së duhur; - të skicojë në letër një plan kompozues të bimëve të reja dekorative, në përputhje me veçoritë e mjedisit të caktuar; - të përdorë kompjuterin për të kompozuar bimët dekorative, duke mbajtur parasysh veçoritë e mjedisit; - të paraqesë modelin e kompozimit të bimëve dekorative, duke dhënë edhe argumentet e duhura për zgjedhjet e bëra në mënyrë
--	--

		<p>individuale ose në grup;</p> <ul style="list-style-type: none"> - të përzgjedhë modelin më optimal kompozues bazuar në kriteret e përcaktuara më parë; - të përgatisë planin mbjelljes së bimëve dekorative, në përputhje me modelin e pranuar; - të përgatisë vendin/zonën e caktuar për mbjelljen e bimëve dekorative duke zbatuar teknikat e thjeshta të përgatitjes; - të mbjellë bimët dekorative duke zbatuar teknikat e mbjelljes dhe planin përkatës; - të kryejë shërbime pas mbjelljes së bimëve dekorative, të tilla, si: ujitja, vendosja e shkopinjve mbështetës, plehërimi, prashitja e luleve, punimi i tokës rreth kurorës së pemës apo shkurreve, shkulja e barishteve të këqija etj, sipas nevojave të bimëve; - të kryejë krasitjen formuese të pemëve dhe të shkurreve zbukuruese, sipas modelit të përcaktuar; - të kujdeset vazhdimisht për vendin (mjedisin/zonën) e zbukuruar me lule, pemë e shkurre të gjelbra; - të zbatojnë rregullat e sigurisë në punë dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë punës për zbukurimin e mjediseve me lule, pemë e shkurre.
	<p>RM 3</p>	<p><i>Nxënësi mbjell fidanë frutorë.</i> <i>Përmbajtja:</i></p> <p>1. Hapja e gropës për mbjelljen e fidanit.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Përcaktimi i vendit për mbjelljen e fidanit frutor. - Piketimi i sipërfaqes për mbjellje. - Hapja e gropës për mbjelljen e fidanit. <p>2. Përgatitja e fidanit për mbjellje.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Përcaktimi i llojit të fidanit për mbjellje. - Sigurimi i fidanëve. - Kontrolli i përgjithshëm i fidanit. - Zhytja e fidanit në ujë. - Rifreskimi i rrënjëve të fidanit. - Zhytja e rrënjëve në përzierjen bajgë-deltinë dhe ujë.

- Transportimi i fidanëve frutorë në vendin e mbjelljes.

3. Mbjellja e fidanit frutor.

- Shpërndarja e plehut organik-mineral pranë gropave të hapura.
- Përzierja e dheut të sipërfaqes me plehun organik-mineral.
- Mbushja e gropës me dheun e sipërfaqes së përgatitur.
- Përcaktimi i qendrës së gropës ku do të vendoset fidani.
- Ngulja e hurit mbështetës në gropë.
- Vendosja e fidanit në qendër të gropës.
- Mbushja e gropës me pjesën tjetër të dheut.
- Lidhja e fidanit me shkopin mbështetës.
- Ujitja e fidanit pas mbjelljes.
- Kujdesi i vazhdueshëm për rritjen e fidanit.
- Zbatimi i rregullave të sigurisë në punë dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë punës për mbjelljen e fidanëve frutorë.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

1. Hapja e gropës për mbjelljen e fidanit.

Nxënësi duhet:

- të përcaktojë vendin e përshtatshëm për mbjelljen e fidanit frutor;
- të piketojë sipërfaqen për mbjelljen e fidanëve sipas distancave të mbjelljes, sipas llojit ose kultivarit (largësia midis rreshtave dhe bimëve brenda në rresht);
- të hapë gropën me vegla dore duke hedhur dheun në të dy krahët e gropës sipas teknikës së duhur, si dhe duke respektuar thellësinë e hapjes;

2. Përgatitja e fidanit për mbjellje.

Nxënësi duhet:

- të përcaktojë llojin e fidanit frutor për mbjellje sipas kushteve klimatike-tokësore;
- të sigurojë fidanët për mbjellje nga burime të ndryshme (me blerje, me dhurim etj);

- të kontrollojë fidanët në përgjithësi dhe të pastrojë sistemin rrënjor në veçanti;
- të zhytë fidanët në ujë për 1-2 ditë para mbjelljes;
- të rifreskojë sistemin rrënjor duke shkurtuar rrënjët e dëmtuara;
- të zhytë sistemin rrënjor në përzierjen bajgë-deltinë dhe ujë sipas raporteve të përcaktuara;
- të transportojë fidanët me kujdes në vendin e mbjelljes.

3. Mbajllja e fidanit frutor.

Nxënësi duhet:

- të shpërndajë plehun organik-mineral pranë gropave të hapura sipas sasisë së nevojshme;
- të përziejë në mënyrë të njëtrajtshme dheun e sipërfaqes me plehurat organo-minerale;
- të kryejë mbushjen e gropës me dheun e sipërfaqes së përgatitur në 2/3 e thellësisë së saj;
- të përcaktojë qendrën e gropës ku do të mbillet fidani me përdorimin e dërrasës mbjellëse;
- të ngulë hurin mbështetës në thellësi të gropës;
- të vendosë fidanin duke respektuar teknikën e mbjelljes së fidanëve frutorë;
- të mbushë gropë me pjesën tjetër të dheut, duke lënë pikën e shartimit të fidanit 7-8 cm mbi rrafshin e tokës;
- të lidhë fidanin me hurin në formë tete pak të lirë;
- të ujitë fidanin pas mbjelljes;
- të kujdeset në mënyrë të vazhdueshme për rritjen e fidanit duke kryer shërbimet e duhura të tilla, si: plehërime plotësuese, punimin e tokës rreth e rrotull fidanit, krasitje të lehta etj;
- të zbatojnë rregullat e sigurisë në punë dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë punës për mbjelljen e fidanëve frutorë.

<p>Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e nxënësve</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Ky modul duhet të trajtohet në shkollë si dhe në mjedise të jashtme që kanë nevojë të zbukurohen me bimë dekorative. - Mësuesi duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur shembuj dhe demonstrime konkrete të zbukurimit të mjediseve të jashtme me bimë dekorative. - Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete fillimisht në mënyrë të mbikëqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur. Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me çështje të bujqësisë, mjedisit, produkteve bujqësore dhe zbukurimit të mjediseve me bimë dekorative. - Rekomandohet metoda e “punës me projekte” dhe “punës në grupe të vogla” ku nxënësit kryejnë veprimtari praktike duke nxitur bashkëpunimin, të nxënë aktiv, krijues e kritik. - Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike dhe krijimtarisë për zbukurimin e mjediseve të jashtme me bimë dekorative. - Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.
<p>Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit</p>	<p>Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjedise dhe materialet e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Klasë e përshtatshme për zhvillimin e modulit. - Katalogë, manuale, udhëzues, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.

*INSTITUTI I ZHVILLIMIT TË ARSIMIT
PROGRAMET E KURRIKULËS ME ZGJEDHJE TË GJIMNAZIT*

MODULI: SHËRBIMI I KLIENTIT

*PROGRAMI I MODULIT ME ZGJEDHJE
PËR TË GJITHA KLASAT*

TIRANË, QERSHOR 2012

PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli	KUPTIMI MBI SHËRBIMIN E KLIENTIT
Qëllimi i modulit	Një modul që aftëson nxënësit nëpërmjet praktikave, qëndrimeve, zhvillimit të tyre për të shërbyer me cilësi të lartë ndaj klientëve dhe gjithashtu për të qenë klientë të mirë.
Kohëzgjatja e modulit	Minimumi i detyruar 36 orë mësimore.
Niveli i parapëlqyer për pranim	Duhet të jenë nxënës të gjimnazit.

Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	RM 1	<p>Nxënësi përshkruan shërbimin e klientit.</p> <p><i>Përmbajtja:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - Kuptimi për shërbimin e klientit. - Llojet e ndryshme të klientëve. - Dëshirat e klientit. - Parimet bazë për sigurimin e një shërbimi të mirë: <ul style="list-style-type: none"> - përshtypja e parë; - përdorimi i mirësjelljes; - qëndrimi ndaj klientit; - etika ndaj klientit. - Aftësitë e nevojshme për të shërbyer. - Shkrimi i një letre si klient. - Përshkrimi i përvojave pozitive dhe negative si klient. <p><i>Instrumentet e vlerësimit:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - Pyetje-përgjigje me gojë - Vëzhgim me listë kontrolli. <p><i>Kriteret e vlerësimit:</i></p> <p>Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të dallojë kuptimin për shërbimin e klientit; - të përshkruajë lloje të ndryshme të klientëve; - të përshkruajë dëshirat e klientit; - të interpretojë parimet bazë për sigurimin e një shërbimi të mirë; <ul style="list-style-type: none"> - të interpretojë krijimin e përshtypjes së parë; - të përdorë mirësjelljen; - të kuptojë qëndrimin që duhet mbajtur ndaj klientit; - të përdorë etikën e duhur me klientin; - të përshkruajë aftësitë e nevojshme për të shërbyer; - të shkruajë një letër si klient; - të përshkruajë përvojat pozitive dhe negative si klient.
	RM 2	<p>Nxënësi komunikon në mënyrë efektive me klientin</p> <p><i>Përmbajtja:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - Përdorimi i aftësitë verbale (gjuha e thjeshtë, gramatika e saktë, fjalët e duhura).

	<ul style="list-style-type: none"> - Përdorimi i aftësive vokale (toni i zërit, lakimi, ritmi dhe volumi). - Aftësitë jo-verbale për shërbim të suksesshëm: <ul style="list-style-type: none"> - shprehja e fytyrës dhe buzëqeshja e duhur; - përshëndetja e klientit; - përdorimi i gjuhës së trupit (shenja jo-verbale stop); - kontakti me sy; - falënderimi i klientit. - Të pyeturit dhe dhënia e përgjigjeve klientit. - Dëgjimi aktiv. - Dhënia e shpjegimeve, rastet pro/kundër dhe ofrimi i alternativave klientit. - Përmbledhja e bashkëbisedimit me klientin. - Referimi te supervizori apo eksperti. - Privatësia e klientit. <p>Instrumentet e vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Vëzhgim me listë kontrolli. <p>Kriteret e vlerësimit:</p> <p>Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të përdorë saktë aftësitë verbale në shërbimin ndaj klientit; - të përdorë saktë aftësitë vokale në komunikimin me klientin; - të përdorë llojet e ndryshme të komunikimit jo-verbale: <ul style="list-style-type: none"> - të praktikojë shprehjen e fytyrës dhe buzëqeshjen e duhur me klientin; - të përshëndesë klientin sipas rregullave; - të përdorë saktë gjuhën e trupit; - të vendosë kontaktin me sy; - të falënderojë klientin; - të drejtojë pyetjet e duhura dhe të japë përgjigje të sakta; - të praktikojë dëgjimin aktiv; - të japë shpjegimet e duhura, rastet pro/kundër dhe të ofrojë alternativa për klientin; - të praktikojë përmbledhjen e një bashkëbisedimi me klientin; - të praktikojë si të referojë te supervizori apo eksperti; - të interpretojë ruajtjen e privatësisë së klientit.
--	--

	<p>RM 3</p>	<p>Nxënësi realizon forma të ndryshme të kontaktit me klientin në shërbim.</p> <p><i>Përmbajtja:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - Procedurat për realizimin e kontaktit të drejtpërdrejtë. - Kontakti i drejtpërdrejtë me klientin. - Ndhima direkt ndaj klientit. - Përfundimi pozitiv i shërbimit ndaj klientit. - Procedurat për kontaktimin me telefon me klientin. - Përshëndetja e klientit në telefon sipas rregullave. - Dëgjimi i vëmendshëm në telefon. - Ndhimesa ndaj klientit në telefon. - Përfundimi pozitiv i shërbimit në telefon. - Procedurat për kontaktimin virtual me klientin. - Kontaktet elektronike me klientin. - Vetëshërbimi i klientëve. <p><i>Instrumentet e vlerësimit:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - Vëzhgim me listë kontrolli. <p><i>Kriteret e vlerësimit:</i></p> <p>Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të interpretojë procedurat për realizimin e kontakteve të drejtpërdrejta me klientin; - të praktikojë vendosjen e kontakteve të drejtpërdrejtë me klientin; - të ndihmojë drejtpërdrejt klientin; - të realizojë përfundimin e shërbimit ndaj klientit; - të interpretojë rregullat për kontaktimin e klientit me telefon; - të praktikojë përshëndetjen e klientit në telefon, sipas rregullave; - të praktikojë dëgjimin e vëmendshëm në telefon; - të ndihmojë klientin në telefon; - të përfundojë pozitivisht shërbimin në telefon; - të interpretojë procedurat për kontaktimin virtual me klientin; - të praktikojë vendosjen e kontakteve elektronike me klientin; - të zbatojë rregullat në vetëshërbimin e klientëve.
--	--------------------	---

	<p>RM 4</p>	<p>Nxënësi vendos marrëdhënie me klientin</p> <p><i>Përmbajtja:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - Procedurat për të vendosur marrëdhënie me klientin. - Ndërveprimi pozitiv me klientin. - Identifikimi i nevojave të klientit. - Mënyrat për të bërë klientin të ndihet i vlerësuar. - Promovimi i produktit tek klienti. - Ide krijuese për ti shërbyer klientit. - Rëndësia e mbajtjes së marrëdhënieve të vazhdueshme me klientin. - Trajtimi i llojeve e ndryshme të klientëve. - Mënyrat si mund të refuzohet kërkesa e klientit. - Specifikimi i nevojave për klientin e vështirë. - Zgjidhja e situatës me klientin e vështirë. <p><i>Instrumentet e vlerësimit:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - Vëzhgim me listë kontrolli. <p><i>Kriteret e vlerësimit:</i></p> <p>Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të interpretojë procedurat për të vendosur marrëdhënie me klientin; - të ndërveprojë pozitivisht me klientin; - të identifikojë nevojat e klientit; - të shpjegojë mënyrat që klienti të ndihet i vlerësuar; - të praktikojë mënyrat e promovimit të produktit te klienti; - të zbatojë mënyra krijuese për të përshtatur shërbimin e duhur ndaj klientit; - të shpjegojë rëndësinë e mbajtjes së marrëdhënieve të vazhdueshme me klientin; - të përshkruajë trajtimin e llojeve të ndryshme të klientëve; - të praktikojë mënyrat e refuzimit të kërkesës së klientit; - të dallojë nevojat e klientit të vështirë; - të realizojë zgjidhjen e situatës me klientin e vështirë.
--	--------------------	---

	<p>RM 5</p>	<p>Nxënësi përdor teknika për të rritur shitjet dhe kënaqur klientin.</p> <p><i>Përmbajtja:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - Përdorimi i teknikave të thjeshta në shitje. - Identifikimi i nevojave shtesë të klientit. - Kuptimi për tiparet dhe përftimet nga një produkt. - Kuptimi për produkte të ndryshme që kanë lidhje të përbashkëta. - Teknika për shitje shtesë me produkte zëvendësuese. Teknika për rritjen e shitjeve duke ulur çmimin. - Teknika për rritjen e shitjeve me produkte shoqëruese. <p><i>Instrumentet e vlerësimit:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - Vëzhgim me listë kontrolli. <p><i>Kriteret e vlerësimit:</i></p> <p>Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të përdorë teknika të thjeshta shitjeje; - të zbulojë sipas procedurës nevojat shtesë të klientit; - të shpjegojë sipas llojit të produktit tiparet dhe epërsitë e produktit; - të dallojë lidhjet e përbashkëta të produkteve të ndryshme; - të përdorë teknika për shitje shtesë me produkte zëvendësuese; - të përdorë teknika për rritjen e shitjeve duke ulur çmimin; - të përdorë teknika për rritjen e shitjeve me produkte shoqëruese.
<p>Udhëzime për zbatimin e modulit</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Ky modul mund të trajtohet në klasë, e sistemuar sipas rasteve në përshtatje me simulimin e situatave praktike. Rekomandohet që nxënësit të kryejnë edhe vizita në supermarkete ose kompani shërbimesh ku shërbimi dhe kujdesi për klientin janë elementë të rëndësishëm dhe trajtohen me vëmendje të veçantë nga kompanitë. - Minimumi i orëve të trajtimit të modulit është 36 orë. Moduli përmban përshkrime teorike dhe praktike të temave. Rekomandohet që mësimi të zhvillohet edhe me 	

	<p>lojëra praktike, të cilat demonstrohen dhe administrohen lehtësisht nga mësuesi. Nxënësit mund të vihen si në rolin e klientit ashtu edhe të ofruesit të shërbimit, ku nxënësit të ndihen entuziastë dhe të motivuar për të luajtur si përfaqësues i shitjes, telemarketing, mbështetjes teknike, specialist në terren, arkëtar, staf në hoteleri apo turizëm etj.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Mësuesi të pozicionohet më tepër në rolin e moderatorit, se sa të mësuesit. Nxënësit mund të ndahen në grupe, përcaktohet një situatë, formulohet një problem ose çështje që ka lidhje me klientin, jepen detaje shtesë, përcaktohet koha, grupet prezantojnë punën, debatohet dhe përcaktohet zgjidhja më e mirë. Në fund mësuesi bën përmbledhjen. Në këtë mënyrë inkurajoni kreativitetin, nxisni diskutimin, nxisni konkurrencën, vlerësimin, duartrokitjet etj. - Kur është e mundur mësuesi sjell përvoja nga jeta reale, për t'i ndihmuar nxënësit t'i përshtatin njohuritë lehtësisht në praktikë dhe pastaj nëpërmjet pyetjeve të hapura t'u jepet mundësia për diskutim në lidhje me teknikat, procedurat dhe mjetet që përdoren sipas rastit. - Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e një shërbimi të kulturuar. - Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kritereve të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.
<p>Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit</p>	<p>Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen disa mjete dhe materiale të mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Katalogë, manuale, udhëzues, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.

*INSTITUTI I ZHVILLIMIT TË ARSIMIT
PROGRAMET E KURRIKULËS ME ZGJEDHJE TË GJIMNAZIT*

MODULI: ETIKA E TË VESHURIT DHE ARREDIMIT

*PROGRAMI I MODULIT ME ZGJEDHJE
PËR TË GJITHA KLASAT*

TIRANË, QERSHOR 2011

PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli	ETIKA E TË VESHURIT DHE ARREDIMIT
Qëllimi i modulit	Një modul që aftëson nxënësit të zbatojnë në jetën e përditshme aspekte të etikës së të veshurit dhe arredimit.
Kohëzgjatja e modulit	Minimumi i detyruar 36 orë mësimore.

<p>Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit</p>	<p>RM 1</p>	<p>Nxënësi përshkruan aspekte të etikës së të veshurit dhe arredimit.</p> <p><i>Përmbajtja:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - Kuptimi dhe rëndësia e etikës së të veshurit dhe arredimit. - Rregullat bazë të etikës së të veshurit. - Rregullat bazë të etikës së arredimit. - Kufizimet etike në të veshur. - Kufizimet etike në të arredim. - Rëndësia e proporcionit në aspektet e etikës së veshjes dhe arredimit. - Rëndësia e hapësirës në aspektet e etikës së veshjes dhe arredimit. - Rëndësia e volumit në aspektet e etikës së veshjes dhe arredimit. - Rëndësia e formave dhe përmasave në aspektet e etikës së veshjes dhe arredimit. - Rëndësia e ngjyrave në aspektet e etikës së veshjes dhe arredimit. - Ngjyrat bazë dhe derivatet e tyre. - Ngjyrat e ftohta, të ngrohta, tonalitetet e tyre. - Ndikimi i natyrës në krijimin e ngjyrave. - Ndikimi i ngjyrave në emocionet e njeriut. - Ndikimi i stinëve dhe ngjyrave në veshje dhe arredim. <p><i>Instrumentet e vlerësimit:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - Pyetje-përgjigje me gojë. - Vëzhgim me listë kontrolli. <p><i>Kriteret e vlerësimit:</i></p> <p>Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të shpjegojë kuptimin dhe rëndësinë e etikës së të veshurit dhe arredimit; - të evidentojë rregullat bazë të etikës së të veshurit dhe të japë shembuj të zbatimit të tyre në jetën e përditshme; - të evidentojë rregullat bazë të etikës së arredimit dhe të japë shembuj të zbatimit të tyre në jetën e përditshme; - të evidentojë kufizimet etike në të veshurin dhe të japë shembuj të zbatimit të tyre në jetën e përditshme;
---	--------------------	--

		<ul style="list-style-type: none"> - të evidentojë kufizimet etike në të arredim dhe të japë shembuj të zbatimit të tyre në jetën e përditshme; - të shpjegojë rëndësinë e proporcionit në aspektet e etikës së veshjes dhe arredimit; - të evidentojë dhe prezantojë shembuj të respektimit të proporcioneve në të veshur dhe arredim; - të shpjegojë rëndësinë e hapësirës në aspektet e etikës së veshjes dhe arredimit; - të evidentojë dhe prezantojë shembuj të respektimit të hapësirës në të veshur dhe arredim; - të shpjegojë rëndësinë e volumit në aspektet e etikës së veshjes dhe arredimit; - të evidentojë dhe prezantojë shembuj të respektimit të volumit në të veshur dhe arredim; - të shpjegojë rëndësinë e formave dhe përmasave në aspektet e etikës së veshjes dhe arredimit; - të evidentojë dhe prezantojë shembuj të respektimit të formave dhe përmasave në të veshur dhe arredim; - të shpjegojë rëndësinë e ngjyrave në aspektet e etikës së veshjes dhe arredimit; - të dallojë dhe japë shembuj mbi ngjyrat bazë dhe derivatet e tyre; - të dallojë dhe japë shembuj mbi ngjyrat e ftohta, të ngrohta, tonalitetet e tyre; - të shpjegojë dhe japë shembuj mbi ndikimin e natyrës në krijimin e ngjyrave; - të shpjegojë dhe japë shembuj mbi ndikimin e ngjyrave në emocionet e njeriut; - të shpjegojë dhe japë shembuj mbi ndikimin e ngjyrave të stinës në veshje dhe arredim.
	<p>RM 2</p>	<p>Nxënësi realizon ide të thjeshta për veshje bazuar në aspektet e etikës së të veshurit. <i>Përmbajtja:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - Rëndësia dhe funksioni i veshjeve në jetën e përditshme. - Rëndësia dhe funksioni i veshjeve në raste të veçanta.

		<ul style="list-style-type: none"> - Funkzioni estetik dhe praktik i veshjeve dhe raportet mes tyre. - Ndikimi dhe rëndësia e modës në etikën e veshjes dhe raportet mes tyre. - Ngjyrat, tonaliteti i dritës dhe errësirës në veshje dhe ndikimi i tyre në imazhin e individit. - Aksesorët e veshjeve, llojet dhe rëndësia e tyre. - Përzgjedhja e veshjes në varësi të natyrës dhe karakterit të individit, kontekstit të përdorimit të veshjes. - Përshtatja e veshjes me petinaturën, grimin dhe këpucët. - Dizenjimi dhe prezantimi i veshjeve të përditshme në varësi të stinës, funksionit, imazhit, praktikitetit, modës etj. - Dizenjimi dhe prezantimi i veshjeve për raste të veçanta në varësi të stinës, funksionit, imazhit, praktikitetit, modës etj. <p>Instrumentet e vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Vëzhgim me listë kontrolli. <p>Kriteret e realizimit:</p> <p>Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të shpjegojë rëndësinë dhe funksionin e veshjeve në jetën e përditshme; - të shpjegojë rëndësinë dhe funksionin e veshjeve në raste të veçanta; - të shpjegojë funksionin estetik dhe praktik të veshjeve dhe raportet mes tyre; - të shpjegojë ndikimin dhe rëndësinë e modës në etikën e veshjes dhe raportet mes tyre; - të dallojë ngjyrat, tonaliteti i dritës dhe errësirës në veshje dhe ndikimi i tyre në imazhin e individit; - të evidentojë aksesorët e veshjeve, llojet dhe rëndësia e tyre; - të përzgjedhë veshjet në varësi të natyrës dhe karakterit të individit, kontekstit të përdorimit të veshjes; - të përshtatë veshjen me petinaturën, grimin dhe këpucët; - të dizenjojë dhe prezantojë veshje të përditshme
--	--	--

	<p>RM 3</p>	<p>në varësi të stinës, funksionit, imazhit, praktikitetit, modës etj;</p> <ul style="list-style-type: none"> - të dizenjojë dhe prezantojë veshjet për raste të veçanta në varësi të stinës, funksionit, imazhit, praktikitetit, modës etj. <p>Nxënësi realizon skicën e thjeshtë të arredimit të një ambienti.</p> <p><i>Përmbajtja:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - Mënyrat e arredimit të ambientit. - Cilësitë e një arredimi harmonik. - Elementet bazë për projektin e arredimit të një ambienti të dhënë. - Bazat e vizatimit të skicës së ambientit sipas proporcioneve. - Zgjedhja e mënyrës së arredimit në përputhje me faktorë të ndryshëm (numri i anëtarëve të familjes, mosha, mënyra e jetës dhe nevojat e tyre, hapësira fizike në dispozicion, burimet financiare, koha etj). - Arredimi i dyshemesë dhe tapeteve. - Arredimi i mureve dhe tavaneve. - Arredimi i dritareve dhe perdeve. - Përzgjedhja dhe vendosja e pajisjeve/mobilieve (sipas proporcionit, hapësirës, volumnit, ngjyrës). - Përzgjedhja e ndriçimit (ndikimi i ngjyrës te ndriçimi dhe anasjelltas). - Përzgjedhja e veshjes së mobilieve dhe aksesorët. - Organizimi, kursimi i hapësirës dhe shmangia e çorganizimit. - Konceptimi i projekt-idesë dhe prezantimi i arredimit të një ambienti të dhënë, me dorë apo kompjuter. <p><i>Instrumentet e vlerësimit:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - Vëzhgim me listë kontrolli. <p><i>Kriteret e realizimit:</i></p> <p>Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p>
--	--------------------	---

	<ul style="list-style-type: none"> - të shpjegojë mënyrat e arredimit të ambientit; - të identifikojë cilësitë e një arredimi harmonik; - të evidentojë elementet bazë për projektin e arredimit të një ambienti të dhënë; - të demonstrojë bazat e vizatimit të skicës së ambientit sipas proporcioneve; - të përzgjedhë stilin e përshtatshëm të arredimit për familjen e tij; - të realizojë një skicë të thjeshtë arredimi duke respektuar raportet e planimetrisë së dhomës; - të përcaktojë një skemë të thjeshtë ngjyrash për arredimin e dhomës dhe skemën e ndriçimit; - të përcaktojë paraqitjen e dyshemesë, tavanit, mureve, dritareve; - të përzgjedhë modele të përshtatshme mobilësh dhe pajisjesh për dhomën; - të përzgjedhë modele të përshtatshme veshjesh për pajisjet e dhomës dhe aksesorësh; - të zbulojë mënyra për organizimin e pajisjeve të shtëpisë me qëllim kursimin e hapësirës dhe shmangien e çorganizimit; - të konceptojë një projekt ide arredimi të një ambienti të dhënë dhe ta prezantojë me dorë apo kompjuter.
<p>Udhëzime për zbatimin e modulit</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Ky modul duhet të trajtohet në mjedise të shkollës, të përshtatura për veprimtari të etikës së veshjes dhe arredimit, ose në mjedise të tjera ku kryhen veprimtari të tilla. Rekomandohet që të kryejnë edhe vizita në ndërmarrje që kryejnë punime të tilla ose të përafërta me to. - Minimumi i orëve të trajtimit të modulit është 36 orë. Për realizimin e modulit nxënësi është i detyruar të kryejë RM 1. Rezultatet e tjera mësimore zgjidhen sipas preferencës së nxënësit, pra nxënësi veç RM1 mund të zgjedhë minimumi një nga rezultatet e tjera mësimore. - Mësuesi duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete të teknikave dhe procedurave të etikës së veshjes dhe arredimit. - Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për kryerjen e skicave apo veprimtarive të parapërgatitjes

dhe të zbatimit të etikës së veshjes dhe arredimit, fillimisht në mënyrë të mbikëqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur. Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me proceset e punës që kryejnë.

- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike në lidhje me etikën e veshjes dhe arredimit.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet në arritjen e kënaqshme të të gjitha kritereve të specifikuara për çdo rezultat të të mësuarit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:

- Mjedise të përshtatshme për realizimin e modulit.
- Katalogë, manuale, udhëzues, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.

*INSTITUTI I ZHVILLIMIT TË ARSIMIT
PROGRAMET E KURRIKULËS ME ZGJEDHJE TË GJIMNAZIT*

***MODULI: PUNIME TË RIPARIMIT DHE
TË MIRËMBAJTJES NË BANESA***

*PROGRAMI I MODULIT ME ZGJEDHJE
PËR TË GJITHA KLASAT*

TIRANË, NËNTOR 2011

PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli	PUNIME TË RIPARIMIT DHE TË MIRËMBAJTJES NË BANESA
Qëllimi i modulit	Një modul që aftëson nxënësit për të kryer punime të thjeshta të riparimit dhe të mirëmbajtjes në mjediset, orenditë dhe pajisjet e banesave, duke përdorur materiale, vegla dhe pajisje për punime të thjeshta shtëpiake.
Kohëzgjatja e modulit	18-72 orë mësimore.
Niveli i parapëlqyer për pranim	Duhet të jenë nxënës të gjimnazit.

<p>Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit</p>	<p>RM 1</p>	<p>Nxënësi përshkruan punimet e thjeshta të riparimit dhe të mirëmbajtjes në mjediset, orenditë dhe pajisjet shtëpiake.</p> <p><i>Përmbajtja:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - Mjediset e banesave, elementet përbërëse dhe funksionet e tyre. - Orenditë dhe pajisjet kryesore që përdoren në banesat, llojet, ndërtimi dhe funksionet e tyre. - Rrjeti elektrik i një banese, skema, elementet dhe funksionet e tyre. - Pajisjet elektroshtëpiake kryesore, ndërtimi dhe funksionet e tyre. - Rrjeti hidraulik i një banese, skema, elementet dhe funksionet e tyre. - Katalogët e orendive dhe pajisjeve të banesave, shenjat konvencionale dhe interpretimi i tyre. - Veglat dhe pajisjet kryesore që përdoren për punime të mirëmbajtjes dhe riparimit në banesa. - Materialet kryesore që përdoren për punime të mirëmbajtjes dhe riparimit në banesa. - Parregullsitë kryesore dhe punimet e mirëmbajtjes dhe riparimit në rrjetin elektrik të banesës. - Parregullsitë kryesore dhe punimet e mirëmbajtjes dhe riparimit në pajisjet elektroshtëpiake të banesës. - Parregullsitë kryesore dhe punimet e mirëmbajtjes dhe riparimit në rrjetin hidraulik të banesës. - Parregullsitë kryesore dhe punimet e mirëmbajtjes dhe riparimit në muret dhe tavanet e banesës. - Parregullsitë kryesore dhe punimet e mirëmbajtjes dhe riparimit në orenditë prej druri të banesës. - Kujdesi për veglat dhe pajisjet e punës. - Rregullat bazë të sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë veprimeve të riparimit dhe të mirëmbajtjes në mjediset, orenditë dhe pajisjet e banesës.
---	--------------------	---

		<p>Instrumentet e vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Pyetje-përgjigje me gojë. - Vëzhgim me listë kontrolli. <p>Kriteret e vlerësimit:</p> <p>Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të përshkruajë mjediset e banesave, elementet përbërëse dhe funksionet e tyre; - të listojë orenditë dhe pajisjet kryesore që përdoren në banesat dhe të përshkruajë llojet, ndërtimin dhe funksionet e tyre; - të përshkruajë rrjetet elektrike dhe hidraulike të një banese, skemat, elementet dhe funksionet e tyre; - të përshkruajë pajisjet elektroshtëpiake kryesore, ndërtimin dhe funksionet e tyre; - të lexojë katalogët e orendive dhe pajisjeve të banesave; - të listojë veglat, pajisjet dhe materialet kryesore që përdoren për punime të mirëmbajtjes dhe riparimit në banesa; - të përshkruajë parregullsitë kryesore dhe punimet e mirëmbajtjes e riparimit në rrjetin elektrik, rrjetin hidraulik, pajisjet elektroshtëpiake, orenditë prej druri dhe muret e tavanet e banesës; - të përshkruajë rregullat e mirëmbajtjes së veglave dhe pajisjeve të punës; - Rregullat bazë të sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë veprimeve të riparimit dhe të mirëmbajtjes në mjediset, orenditë dhe pajisjet e banesës; - të përshkruajë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë veprimeve të riparimit dhe të mirëmbajtjes shtëpiake.
	RM 2	<p>Nxënësi kryen mirëmbajtje dhe riparime të thjeshta elektrike në rrjetin elektrik të banesës.</p> <p>Përmbajtja:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Parregullsitë kryesore në rrjetin elektrik të banesës dhe shkaqet e tyre. - Rregullat e sigurisë dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë punimeve në rrjetin elektrik të banesës.

	<ul style="list-style-type: none"> - Përzgjedhja e veglave dhe pajisjeve të punës për punime në rrjetin elektrik të banesës (multimetër, pinca, kaçavida etj). - Përzgjedhja e materialeve të punës. - Përdorimi i multimetrit për matjet dhe kontrollet elektrike. - Matjet, kontrollet dhe përcaktimi i parregullsive në rrjetin elektrik të banesës. - Procedura e ndërprerjes së furnizimit me rrymë elektrike (shkëputja e siguresave ose automatëve) gjatë punimeve në rrjetin elektrik të banesës. - Procedura e zëvendësimit të llambave të djegura, të ndriçuesve të ndryshëm. - Procedura e zëvendësimit të portollambave të dëmtuara. - Procedura e zëvendësimit të çelësave elektrik të dëmtuar. - Procedura e zëvendësimit të prizave elektrike të dëmtuara. - Prova e funksionimit të pjesëve të zëvendësuara të rrjetit elektrik të banesës. - Kujdesi për veglat, pajisjet dhe mjedisin e punës. <p>Instrumentet e vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Vëzhgim me listë kontrolli. <p>Kriteret e realizimit:</p> <p>Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të bëjë matje dhe kontrolle për përcaktimin e parregullsive kryesore në rrjetin elektrik të banesës; - të përzgjedhë veglat dhe pajisjet e punës për mirëmbajtjen dhe riparimin e rrjetit elektrik të banesës; - të përzgjedhë materialet e duhura të punës; - të kryejë procedurat e duhura për të bërë zëvendësimin e llambave, portollambave, prizave, çelësave dhe pjesëve të tjera të rrjetit elektrik të banesës; - të bëjë provën e funksionimit të pjesëve të zëvendësuara të rrjetit elektrik të banesës;
--	---

		<ul style="list-style-type: none"> - të tregojë kujdesin e duhur për veglat, pajisjet dhe mjedisin e punës; - të zbatojë rregullat e sigurisë dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë punimeve në rrjetin elektrik të banesës.
	<p>RM 3</p>	<p>Nxënësi kryen mirëmbajtje dhe riparime të thjeshta elektrike në pajisjet elektroshtëpiake të banesës.</p> <p><i>Përmbajtja:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - Parregullsitë kryesore në pajisjet elektroshtëpiake të banesës dhe shkaqet e tyre. - Rregullat e sigurisë dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë punimeve në pajisjet elektroshtëpiake të banesës. - Përzgjedhja e veglave dhe pajisjeve të punës për punime në pajisjet elektroshtëpiake të banesës (multimetër, pinca, kaçavida etj). - Përzgjedhja e materialeve të punës. - Matjet, kontrollet dhe përcaktimi i parregullsive të thjeshta në pajisjet elektroshtëpiake të banesës. - Procedura e zëvendësimit të pilave të konsumuara të telekomandave të pajisjeve elektroshtëpiake (të televizorëve, të kondicionerëve etj). - Procedura e zëvendësimit të spinave të dëmtuara të pajisjeve elektroshtëpiake (televizorëve, makinave larëse, hekurave për hekurosje, fshesave me elektricitet, kompjuterëve etj). - Procedura e zëvendësimit të kablllove elektrike të dëmtuara të pajisjeve elektroshtëpiake. - Procedura e zëvendësimit të llambave sinjalizuese të djegura, të pajisjeve elektroshtëpiake. - Procedura e zëvendësimit të fishave dhe kablllove të antenave të televizorëve. - Prova e funksionimit të pjesëve të zëvendësuara të pajisjeve elektroshtëpiake të banesës.

		<ul style="list-style-type: none"> - Kujdesi për veglat, pajisjet dhe mjedisin e punës. <p>Instrumentet e vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Vëzhgim me listë kontrolli. <p>Kriteret e realizimit:</p> <p>Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të bëjë matje dhe kontrole për përcaktimin e parregullsive kryesore në pajisjet elektroshtëpiake të banesës; - të përzgjedhë veglat dhe pajisjet e punës për mirëmbajtjen dhe riparimin e pajisjeve elektroshtëpiake të banesës; - të përzgjedhë materialet e duhura të punës; - të kryejë procedurat e duhura për të bërë zëvendësimin e pilave, spinave, kablllove, llambave sinjalizuese, fishave dhe kablllove të antenave, të pajisjeve elektroshtëpiake të banesës; - të bëjë provën e funksionimit të pjesëve të zëvendësuara të pajisjeve elektroshtëpiake të banesës; - të tregojë kujdesin e duhur për veglat, pajisjet dhe mjedisin e punës; - të zbatojë rregullat e sigurisë dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë punimeve në pajisjet elektroshtëpiake të banesës.
	<p>RM 4</p>	<p>Nxënësi kryen mirëmbajtje dhe riparime të thjeshta në rrjetin hidraulik të banesës.</p> <p>Përmbajtja:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Parregullsitë kryesore në rrjetin hidraulik të banesës dhe shkaqet e tyre. - Rregullat e sigurisë dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë punimeve në rrjetin hidraulik të banesës. - Përzgjedhja e veglave dhe pajisjeve të punës për punime në rrjetin hidraulik të banesës (çelësa, çekiçë, pinca, kaçavida etj). - Përzgjedhja e materialeve të nevojshme për punime hidraulike. - Matjet, kontrollet dhe përcaktimi i parregullsive në rrjetin hidraulik të banesës.

	<ul style="list-style-type: none"> - Procedura e ndërprerjes së furnizimit me ujë gjatë punimeve në rrjetin hidraulik të banesës. - Procedura e pastrimit të piletave të shkarkimit të ujit. - Procedura e zëvendësimit të tubave dhe rakorderive të shkarkimit të lavamanëve dhe lavapjatave. - Procedura e zhbllokimit dhe e pastrimit të tubave të bllokuar të shkarkimeve në rrjetin hidraulik të banesës. - Procedura e pastrimit ose zëvendësimit të filtrave të ujit të dëmtuara. - Procedura e zëvendësimit të rubineteve të dëmtuara. - Procedura e zëvendësimit të tubave fleksibël të dëmtuara. - Procedura e zëvendësimit të sprucatorëve të dusheve të dëmtuara. - Procedura e zëvendësimit të elementeve të dëmtuara të kasetave të shkarkimit të dëmtuara. - Procedura e regjistrimit të notuesit (galexhantit) të kasetës së shkarkimit. - Prova e funksionimit të pjesëve të zëvendësuara të sistemit hidraulik të banesës. - Kujdesi për veglat, pajisjet dhe mjedisin e punës. <p>Instrumentet e vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Vëzhgim me listë kontrolli. <p>Kriteret e realizimit:</p> <p>Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të bëjë kontrolle për përcaktimin e parregullsive kryesore në rrjetin hidraulik të banesës; - të përzgjedhë veglat dhe pajisjet e punës për mirëmbajtjen dhe riparimin e rrjetit hidraulik të banesës; - të përzgjedhë materialet e duhura të punës; - të kryejë procedurat e duhura për të bërë pastrimin e piletave të shkarkimit, pastrimin e filtrave të ujit dhe zhbllokimin e tubave të shkarkimit; - të kryejë procedurat e duhura për të bërë
--	--

		<p>zëvendësimin e tubave dhe rakorderive të shkarkimit, rubineteve, tubave fleksibël, sprucatorëve të dusheve, elementeve të kasetave të shkarkimit dhe pjesëve të tjera të rrjetit hidraulik të banesës;</p> <ul style="list-style-type: none"> - të bëjë provën e funksionimit të pjesëve të zëvendësuara të rrjetit hidraulik të banesës; - të tregojë kujdesin e duhur për veglat, pajisjet dhe mjedisin e punës; - të zbatojë rregullat e sigurisë dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë punimeve në rrjetin hidraulik të banesës.
	<p>RM 5</p>	<p>Nxënësi kryen montime dhe riparime të thjeshta të orendive shtëpiake prej druri.</p> <p><i>Përmbajtja:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - Parregullsitë kryesore në orenditë shtëpiake prej druri dhe shkaqet e tyre. - Rregullat e sigurisë dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë punimeve në orenditë shtëpiake prej druri. - Përzgjedhja e veglave dhe pajisjeve të punës për punime në orenditë shtëpiake prej druri (metër shirit, çekiçë, pinca, kaçavida, darë, dalta, trapano, sharrë dore etj). - Përzgjedhja e materialeve të nevojshme për punime në orenditë shtëpiake prej druri. - Matjet, kontrollet dhe përcaktimi i parregullsive në orenditë shtëpiake prej druri. - Leximi i manualeve të montimit të orendive shtëpiake të parafabrikuara, prej druri. - Matjet dhe shënimet në elementet e orendive shtëpiake të parafabrikuara, prej druri. - Procedura e montimit të elementeve të orendive shtëpiake të parafabrikuara prej druri (etazherëve, tryezave, karrigeve, rafteve etj). - Procedura e riparimeve të ndryshme në orenditë shtëpiake prej druri, nëpërmjet shtrëngimeve të vidave dhe bulonave, sharrimeve, shpimeve etj. - Kontrolli përfundimtar i orendive shtëpiake prej druri të montuara ose të riparuar. - Kujdesi për veglat, pajisjet dhe mjedisin e punës.

		<p>Instrumentet e vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Vëzhgim me listë kontrolli. <p>Kriteret e realizimit:</p> <p>Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të bëjë kontrolle për përcaktimin e parregullsisve kryesore në orenditë prej druri të shtëpisë; - të përzgjedhë veglat dhe pajisjet e punës për mirëmbajtjen dhe riparimin e orendive prej druri të shtëpisë; - të përzgjedhë materialet e duhura të punës; - të bëjë leximin e manualeve të montimit të orendive shtëpiake të parafabrikuara, prej druri; - të kryejë matjet dhe shënimet në elementet e orendive shtëpiake të parafabrikuara, prej druri; - të kryejë montimin e elementeve të orendive shtëpiake të parafabrikuara prej druri; - të kryejë riparime të ndryshme në orenditë shtëpiake prej druri, nëpërmjet shtrëngimeve të vidave dhe bulonave, sharrimeve, shpimeve etj; - të bëjë kontrollin përfundimtar të orendive shtëpiake prej druri të montuara ose të riparuar; - të tregojë kujdesin e duhur për veglat, pajisjet dhe mjedisin e punës; - të zbatojë rregullat e sigurisë dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë punimeve në orenditë shtëpiake prej druri.
	<p>RM 6</p>	<p>Nxënësi kryen riparime të thjeshta të mureve dhe tavaneve të banesave.</p> <p>Përmbajtja:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Parregullsitë kryesore në muret dhe tavanet e banesave dhe shkaqet e tyre. - Rregullat e sigurisë dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë punimeve në muret dhe tavanet e banesave. - Përzgjedhja e veglave dhe pajisjeve të punës për punime në muret dhe tavanet e banesave (çekiçë, pinca, kaçavida, dalta, trapano, mistri, shpatull, letër smerili, shkallë, kova, furça, rula etj). - Përzgjedhja e materialeve të nevojshme për punime në muret dhe tavanet e banesave (rërë,

		<p>çimento, gëlqere, allçi, bojëra, ujë, vida etj).</p> <ul style="list-style-type: none"> - Kontrolli dhe përcaktimi i parregullsive në muret dhe tavanet e banesave. - Procedura e gërryerjes dhe e pastrimit të pjesëve të dëmtuara të mureve dhe tavaneve të banesave. - Procedura e përgatitjes së llaçit. - Procedura e suvatimit me llaç të pjesëve të dëmtuara të mureve dhe tavaneve. - Procedura e përgatitjes së stukos së allçisë. - Procedura e stukimeve me allçi të pjesëve të dëmtuara të mureve dhe tavaneve. - Procedura e lyerjes së mureve dhe tavaneve me furçë. - Procedura e lyerjes së mureve dhe tavaneve me rul. - Procedura e shpimit të vrimave në mure dhe tavaneve. - Procedura e montimit ose varjes së objekteve të ndryshme në mure dhe tavane me anë të vidave. - Kontrolli përfundimtar i punimeve të kryera në muret dhe tavanet e banesave. - Kujdesi për veglat, pajisjet dhe mjedisin e punës. <p>Instrumentet e vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Vëzhgim me listë kontrolli. <p>Kriteret e realizimit:</p> <p>Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të bëjë kontrolle për përcaktimin e parregullsive kryesore në muret dhe tavanet e banesës; - të përzgjedhë veglat dhe pajisjet e punës për punime në tavanet dhe muret e banesës; - të përzgjedhë materialet e duhura të punës; - të përgatisë llaçin dhe stukon e allçisë për riparime në mure e tavane; - të kryejë punime të gërryerjes, pastrimit, suvatimit, stukimit, shpimit të vrimave dhe lyerjes së mureve dhe tavaneve të banesës; - të bëjë kontrollin përfundimtar të punimeve të kryera në muret dhe tavanet e banesave;
--	--	--

	<ul style="list-style-type: none"> - të tregojë kujdesin e duhur për veglat, pajisjet dhe mjedisin e punës; - të zbatojë rregullat e sigurisë dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë punimeve në muret dhe tavanet e banesave.
<p>Udhëzime për zbatimin e modulit</p>	<p>Ky modul duhet të trajtohet në mjedise të shkollës, të përshtatura për punime të thjeshta të riparimit dhe të mirëmbajtjes shtëpiake, ose në mjedise të tjera që simulojnë mjediset e banesave.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Mësuesi duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete të teknikave dhe procedurave të riparimit dhe të mirëmbajtjes së rrjetit dhe pajisjeve elektrike, rrjetit hidraulik, orendive prej druri, si dhe të mureve e tavaneve të banesave. - Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për kryerjen e punimeve të parapërgatitjes dhe të realizimit të punimeve të thjeshta të riparimit dhe të mirëmbajtjes së rrjetit dhe pajisjeve elektrike, rrjetit hidraulik, orendive prej druri, si dhe të mureve e tavaneve të banesave, fillimisht në mënyrë të mbikëqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur. Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me proceset e punës që kryejnë. - Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e punimeve të thjeshta, riparimit dhe të mirëmbajtjes shtëpiake. - Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kritereve të realizimit të specifikuara për çdo rezultat të të mësuarit.
<p>Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit</p>	<p>Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Mjedise të përshtatshme për punime të thjeshta të riparimit dhe të mirëmbajtjes shtëpiake. - Orendi shtëpiake prej druri. - Vegla dhe pajisje pune për përdorim shtëpiak. - Materialet dhe pjesët e nevojshme për të kryer riparime, zëvendësime dhe mirëmbajtje shtëpiake. - Katalogë, manuale, udhëzues, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.

*INSTITUTI I ZHVILLIMIT TË ARSIMIT
PROGRAMET E KURRIKULËS ME ZGJEDHJE TË GJIMNAZIT*

***MODULI: PUNIME TË RIPARIMIT DHE
MIRËMBAJTJES MEKANIKE***

*PROGRAMI I MODULIT ME ZGJEDHJE
PËR TË GJITHA KLASAT*

TIRANË, QERSHOR 2012

PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli	PUNIME TË RIPARIMIT DHE TË MIRËMBAJTJES MEKANIKE
Qëllimi i modulit	Një modul që aftëson nxënësit për të kryer punime të thjeshta të riparimit dhe të mirëmbajtjes mekanike në makina dhe pajisje të ndryshme mekanike, për përdorim shtëpiak.
Kohëzgjatja e modulit	36 orë mësimore
Niveli i parapëlqyer për pranim	Duhet të jenë nxënës të gjimnazit.

<p>Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit</p>	<p>RM 1</p>	<p>Nxënësi përshkruan punimet e thjeshta të riparimit dhe mirëmbajtjes mekanike (6 orë). <i>Përmbajtja:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - Makinat dhe pajisjet mekanike kryesore me përdorim shtëpiak. - Veglat dhe pajisjet kryesore që përdoren për punime të thjeshta mekanike. - Katalogët e makinave dhe pajisjeve mekanike me përdorim shtëpiak. - Parregullsitë dhe punimet e thjeshta mekanike që kryhen te biçikletat. - Parregullsitë dhe punimet e thjeshta mekanike që kryhen te bravat e dyerve. - Parregullsitë dhe punimet e thjeshta mekanike që kryhen te automjetet e lehta. - Parregullsitë dhe punimet e thjeshta mekanike që kryhen te pajisje të tjera mekanike me përdorim shtëpiak (karrocet e fëmijëve, krevatet portative, menteshat e kapakëve të rafteve, tavolinat dhe karriget metalike etj). - Kujdesi për veglat dhe pajisjet e punës. - Rregullat bazë të sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë veprimeve të riparimit dhe të mirëmbajtjes mekanike. <p><i>Instrumentet e vlerësimit:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - Pyetje-përgjigje me gojë. - Vëzhgim me listë kontrolli. <p><i>Kriteret e vlerësimit:</i> Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të listojë makinat dhe pajisjet mekanike kryesore me përdorim shtëpiak; - të identifikojë veglat dhe pajisjet kryesore që përdoren për punime të thjeshta mekanike; - të përdorë katalogët e makinave dhe të pajisjeve mekanike me përdorim shtëpiak; - të tregojë cilat janë parregullsitë kryesore dhe punimet e thjeshta mekanike që kryhen te biçikletat, bravat e dyerve, automjetet e lehta dhe të pajisje të tjera mekanike me përdorim shtëpiak; - të tregojë kujdesin e duhur për veglat dhe pajisjet e punës;
---	--------------------	---

		<ul style="list-style-type: none"> - të përshkruajë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë veprimeve të riparimit dhe të mirëmbajtjes mekanike.
	RM 2	<p>Nxënësi kryen mirëmbajtje dhe riparime të biçikletës (20 orë).</p> <p><i>Përmbajtja:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - Kontrolli dhe përcaktimi i parregullsive mekanike të biçikletës. - Përzgjedhja e veglave dhe pajisjeve të punës për mirëmbajtjen dhe riparimin e biçikletës (çekiç, çelësa, pinca, kaçavida, leva etj). - Procedura e grasatimit të pjesëve të lëvizshme të biçikletës. - <u>Procedura e riparimit të gomës së përparme të shpuar, të biçikletës:</u> <ul style="list-style-type: none"> - çmontimi i rrotës së përparme nga piruni i timonit të biçikletës; - çmontimi i ventilit të kamerdares nga disku i rrotës; - heqja e kopertonit dhe kamerdares nga disku; - kontrolli i gjendjes së kopertonit; - fryrja e kamerdares, përcaktimi dhe shënimi i vendit të shpuar; - shfryrja e kamerdares, pastrimi dhe smerilimi i sipërfaqes së vendit të shpuar të kamerdares; - pastrimi dhe smerilimi i sipërfaqes së pullës prej gome; - lyerja me ngjitës (mastiç) i sipërfaqeve që do të ngjiten; - ngjitja e pullës në vendin e shpuar të kamerdares; - fryrja jo e plotë e kamerdares; - montimi i ventilit të kamerdares në diskun e rrotës; - vendosja në disk e kopertonit dhe kamerdares së riparuar; - fryrja e gomës së përparme dhe kontrolli i rregullsisë së montimit; - montimi i rrotës së përparme në pirunin e timonit të biçikletës.

		<ul style="list-style-type: none"> - <u>Procedura e zëvendësimit të zinxhirit të biçikletës:</u> <ul style="list-style-type: none"> - lirim i bulonave të aksit të rrotës së prapme të biçikletës; - shtyrja e rrotës së përparme, lirim dhe nxjerrja e zinxhirit nga ingranimi me pinjonin; - heqja e rrotës së prapme; - heqja e zinxhirit të konsumuar nga korona; - vendosja dhe ingranimi në koronë i zinxhirit të ri; - vendosja e rrotës së prapme dhe ingranimi i zinxhirit me pinjonin; - regjistrimi i pozicionit të rrotës së prapme dhe shtrëngimi i bulonave të aksit të saj; - prova e funksionimit të zinxhirit të zëvendësuar. - <u>Procedura e zëvendësimit të kabullit të frenit të biçikletës:</u> <ul style="list-style-type: none"> - heqja e pjesës së kabullit të këputur nga doreza e frenit; - lirim i vidës dhe heqja e pjesës së kabullit të këputur nga nofullat e frenave; - futja e kokës së kabullit të ri në folenë e dorezës së frenit; - futja e kabullit të ri në guajnin e frenit; - shtrëngimi i kabullit të ri në vidën e nofullit të frenit; - regjistrimi i shtrëngimit dhe hapësirës së frenimit; - prova e frenimit. - <u>Procedurat e zëvendësimit të pjesëve të ndryshme të biçikletës:</u> (shalës, timonit, fenerit, ziles, mbulesave të rrotave, pedaleve etj.) <ul style="list-style-type: none"> - kujdesi për veglat e punës; - rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë riparimit dhe mirëmbajtjes së biçikletës. <p>Instrumentet e vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Vëzhgim me listë kontrolli. <p>Kriteret e realizimit:</p> <p>Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p>
--	--	--

		<ul style="list-style-type: none"> - të bëjë kontrollin dhe përcaktimin e parregullsive mekanike të biçikletës; - të përzgjedhë veglat dhe pajisjet e punës për mirëmbajtjen dhe riparimin e biçikletës; - të bëjë grasatimin e pjesëve të lëvizshme të biçikletës; - të bëjë riparimin e gomës së përparme të shpuar, të biçikletës; - të bëjë zëvendësimin e zinxhirit të biçikletës; - të bëjë zëvendësimin e kabullit të frenit të biçikletës; - të bëjë zëvendësimin e shalës, timonit, fenerit, ziles, mbulesave të rrotave, pedaleve të biçikletës etj; - të tregojë kujdesin e duhur për veglat e punës; - të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë riparimit dhe mirëmbajtjes së biçikletës.
	<p>RM 3</p>	<p>Nxënësi kryen zëvendësime të pjesëve të bravave të dyerve (20 orë). <i>Përmbajtja:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - Kontrolli dhe përcaktimi i parregullsive të bravës së derës. - Përzgjedhja e veglave të punës për zëvendësimin e bravës së derës. - Përzgjedhja e pjesëve të bravës për zëvendësim. - Procedura e çmontimit të dorezave të bravës së derës. - Procedura e çmontimit të kapakëve të bravës. - Procedura e çmontimit të fishekut të bravës. - Procedura e çmontimit të trupit të bravës. - Procedura e montimit të trupit të bravës së re. - Procedura e montimit të fishekut të ri të bravës. - Procedura e montimit të kapakëve të bravës. - Procedura e montimit të dorezave të bravës së derës. - Prova e funksionimit të bravës së derës me pjesë të zëvendësuara. - Kujdesi për veglat e punës. - Rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë zëvendësimit të pjesëve të bravës së derës.

		<p>Instrumentet e vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Vëzhgim me listë kontrolli. <p>Kriteret e realizimit:</p> <p>Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të bëjë kontrollin dhe përcaktimin e parregullsive të bravës së derës; - të përzgjedhë veglat e duhura të punës për zëvendësimin e bravës së derës; - të përzgjedhë pjesët e duhura të bravës për zëvendësim; - të bëjë çmontimin e bravës së derës dhe të pjesëve të saj; - të bëjë montimin e pjesëve të reja të bravës së derës; - të bëjë montimin e bravës së derës; - të bëjë provën e funksionimit të bravës së derës së riparuar; - të tregojë kujdesin e duhur për veglat e punës; - të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë zëvendësimit të pjesëve të bravës së derës.
	<p>RM 4</p>	<p>Nxënësi kryen mirëmbajtje të thjeshta te automjetet e lehta (20 orë).</p> <p>Përmbajtja:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Parkimi i automjetit në një vend të sigurt dhe sigurimi që të jetë i frenuar; - Analiza e katalogut të automjetit. - Përzgjedhja e veglave, pajisjeve dhe materialeve të nevojshme për të kryer mirëmbajtje të thjeshta të automjetit të lehtë (çekiç, çelësa, pinca, kaçavida, pajisje ngritëse, lecka pastrimi, rrotë rezervë, vaj makinash, ujë, ujë me solucion antifriz etj). - <u>Procedura e plotësimit me vaj të motorit të automjetit:</u> <ul style="list-style-type: none"> - ngritja e mbulesës së motorit dhe sigurimi i qëndrueshmërisë së saj; - nxjerrja e shufrës së nivelit të vajit, pastrimi i saj dhe futja përsëri në folenë e saj; - kontrolli i nivelit të vajit; - heqja e kapakut të vajit;

		<ul style="list-style-type: none"> - hedhja e sasisë së duhur të vajit (nëse është e nevojshme); - rikontrolli i nivelit të vajit dhe rimbushja deri në arritjen e nivelit të duhur; - vendosja në fole e shufrës së nivelit të vajit; - vendosja dhe shtrëngimi i kapakut të vajit; - mbyllja e mbulesës së motorit. - <u>Procedura e plotësimit me ujë të rezervuarit të ujit të sistemit të ftohjes së motorit:</u> <ul style="list-style-type: none"> - ngritja e mbulesës së motorit dhe sigurimi i qëndrueshmërisë së saj; - kontrolli dhe përcaktimi i nivelit të ujit në rezervuarin e sistemit të ftohjes së motorit; - heqja e kapakut të rezervuarit të ujit të sistemit të ftohjes (kur motori është i ftohtë); - hedhja e sasisë së duhur të ujit me antifrizë në rezervuarin e ujit të sistemit të ftohjes (nëse është e nevojshme); - vendosja dhe shtrëngimi i kapakut të rezervuarit të ujit të sistemit të ftohjes; - mbyllja e mbulesës së motorit. - <u>Procedura e zëvendësimit të fshirëseve të xhamave të automjetit të lehtë:</u> <ul style="list-style-type: none"> - kontrolli i funksionimit të fshirëseve të xhamave; - ngritja e krahut të fshirëses së xhamit; - procedura e heqjes së fshirëses së xhamit nga krahu përkatës; - procedura e vendosjes së fshirëses së re të xhamit në krahun përkatës; - ulja e krahut të fshirëses së xhamit; - kontrolli i funksionimit të fshirëses së zëvendësuar të xhamit. - <u>Procedura e zëvendësimit të filtrit të ajrit të motorit të automjetit të lehtë:</u> <ul style="list-style-type: none"> - ngritja e mbulesës së motorit dhe sigurimi i qëndrueshmërisë së saj; - çmontimi dhe largimi i kapakut të folesë së filtrit të ajrit të motorit; - heqja e filtrit të ajrit nga foleja e tij; - pastrimi i folesë nga papastërtitë; - vendosja në fole e filtrit të ajrit të ri;
--	--	---

		<ul style="list-style-type: none"> - vendosja dhe montimi i kapakut të folesë së filtrit të ajrit të motorit; - mbyllja e mbulesës së motorit. - <u>Procedura e vendosjes së rrotës rezervë të automjetit të lehtë:</u> - vendosja e automjetit të lehtë në pozicion të sigurt (të frenuar); - lirimi i pjesshëm i bulonave (dadiçekëve) të rrotës, që do të zëvendësohet me rrotën rezervë; - vendosja e krikut në pozicionin e duhur për ngritjen e automjetit; - ngritja e automjetit në krik; - lirimi i plotë dhe heqja e bulonave (dadiçekëve) të rrotës, që do të zëvendësohet me rrotën rezervë; - heqja nga aksi e rrotës, që do të zëvendësohet me rrotën rezervë; - çmontimi i rrotës rezervë nga foleja e saj; - vendosja e rrotës rezervë në pozicionin e duhur në aksin e automjetit të lehtë; - vendosja dhe shtrëngimi i pjesshëm i bulonave (dadiçekëve) të rrotës; - lirimi i krikut, ulja e automjetit dhe heqja e krikut; - shtrëngimi i plotë i bulonave (dadiçekëve) të rrotës; - kontrolli përfundimtar i vendosjes së rrotës rezervë të automjetit të lehtë; - Kujdesi për veglat dhe pajisjet e punës; - Rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë mirëmbajtjes së thjeshtë të automjeteve të lehta. <p><i>Instrumentet e vlerësimit:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - Vëzhgim me listë kontrolli. <p><i>Kriteret e realizimit:</i></p> <p>Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të parkojë automjetin në një vend të sigurt dhe të sigurohet që të jetë i frenuar; - të analizojë katalogun e automjetit; - të përzgjedhë veglat, pajisjet dhe materialet e nevojshme për të kryer mirëmbajtje të thjeshta
--	--	---

		<p>të automjetit të lehtë;</p> <ul style="list-style-type: none"> - të bëjë plotësimin me vaj të motorit të automjetit; - të bëjë plotësimin me ujë të rezervuarit të ujit të sistemit të ftohjes së motorit; - të bëjë zëvendësimin e fshirëseve të xhamave, filtrit të ajrit dhe rrotës rezervë të automjetit të lehtë; - të tregojë kujdesin e duhur për veglat dhe pajisjet e punës; - të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë mirëmbajtjes së thjeshtë të automjeteve të lehta.
	<p>RM 5</p>	<p>Nxënësi kryen punime të thjeshta të riparimit dhe zëvendësimit të pajisjeve të ndryshme mekanike me përdorim shtëpiak (20 orë). <i>Përmbajtja:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - Kontrolli dhe përcaktimi i parregullsive të karrocave të fëmijëve, krevatet portative metalike, menteshat e kapakëve të rafteve, tavolinat metalike, karriget metalike etj. - Përzgjedhja e veglave të punës për punime të thjeshta mekanike. - Punime të thjeshta të riparimit dhe zëvendësimit të karrocave të fëmijëve. - Punime të thjeshta të riparimit dhe zëvendësimit të krevatet portative metalike. - Punime të thjeshta të riparimit dhe zëvendësimit të menteshat e kapakëve të rafteve. - Punime të thjeshta të riparimit dhe zëvendësimit të tavolinat metalike. - Punime të thjeshta të riparimit dhe zëvendësimit të karriget metalike. - Punime të thjeshta të riparimit dhe zëvendësimit të pajisjeve të tjera metalike me përdorim shtëpiak. - Kujdesi për veglat e punës. - Rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë kryerjes së punimeve të thjeshta të mirëmbajtjes dhe riparimit të pajisjeve

		<p>metalike me përdorim shtëpiak.</p> <p>Instrumentet e vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Vëzhgim me listë kontrolli. <p>Kriteret e realizimit:</p> <p>Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të bëjë kontrollin dhe përcaktimin e parregullive të karrocave të fëmijëve, krevatet portative metalike, menteshat e kapakëve të rafteve, tavolinat metalike, karriget metalike etj; - të përzgjedhë veglat e duhura të punës për punime të thjeshta mekanike; - të kryejë punime të thjeshta të riparimit dhe zëvendësimit të karrocave të fëmijëve, krevatet portative, tavolinat dhe karriget metalike, menteshat e kapakëve të rafteve dhe në pajisje të tjera metalike me përdorim shtëpiak; - të tregojë kujdesin e duhur për veglat e punës; - të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë kryerjes së punimeve të thjeshta të mirëmbajtjes dhe riparimit të pajisjet metalike me përdorim shtëpiak.
<p>Udhëzime për zbatimin e modulit</p>		<p>Ky modul duhet të trajtohet në mjedise të shkollës, të përshtatura për punime të thjeshta të riparimit dhe të mirëmbajtjes mekanike, ose në mjedise të tjera ku kryhen punime të tilla. Rekomandohet që të kryejnë edhe vizita në ndërmarrje, që kryejnë punime të tilla ose të përafërta me to.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Minimumi i orëve të trajtimit të modulit është 36 orë. Për realizimin e modulit nxënësi është i detyruar të kryejë RM 1. Rezultatet e tjera mësimore zgjidhen sipas preferencës së nxënësit, pra nxënësi veç RM1 mund të zgjedhë minimumi një nga rezultatet e tjera mësimore. - Mësuesi duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete të teknikave dhe procedurave të riparimit dhe të mirëmbajtjes mekanike, në makina dhe pajisje mekanike me përdorim shtëpiak. - Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për kryerjen e punimeve të parapërgatitjes dhe të realizimit të punimeve të thjeshta të riparimit dhe të mirëmbajtjes në makina dhe pajisje mekanike me

	<p>përdorim shtëpiak, fillimisht në mënyrë të mbikëqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur. Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me proceset e punës që kryejnë.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e punimeve të thjeshta mekanike në makina dhe pajisje mekanike me përdorim shtëpiak. - Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.
<p>Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit</p>	<p>Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> - mjedise të përshtatshme për punime të thjeshta të riparimit dhe të mirëmbajtjes mekanike; - makina dhe pajisje mekanike me përdorim shtëpiak; - materialet dhe pjesët e nevojshme për të kryer zëvendësime në makina dhe pajisje mekanike me përdorim shtëpiak; - kompleti i veglave, pajisjeve dhe instrumenteve të nevojshme për punime të thjeshta të riparimit dhe të mirëmbajtjes mekanike; - katalogë, manuale, udhëzues, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.

*INSTITUTI I ZHVILLIMIT TË ARSIMIT
PROGRAMET E KURRIKULËS ME ZGJEDHJE TË GJIMNAZIT*

MODULI: KUJDESI PËR KAFSHËT E SHOQËRIMIT

*PROGRAMI I MODULIT ME ZGJEDHJE
PËR TË GJITHA KLASAT*

TIRANË, QERSHOR 2011

PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli	KUJDESI PËR KAFSHËT E SHOQËRIMIT
Qëllimi i modulit	Një modul që njeh nxënësit me rëndësinë që kanë kafshët shtëpiake, rolin e tyre në shoqërinë e sotme, si dhe mundësive të karrierës në drejtime profesionale që lidhen me kujdesin ndaj kafshëve, si dhe i aftëson ata të kujdesen për kafshët e shoqërimin dhe shpendët dekorativ.
Kohëzgjatja e modulit	Minimumi i detyruar 36 orë mësimore.
Niveli i parapëlqyer për pranim	Duhet të jenë nxënës të gjimnazit.

<p>Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit</p>	<p>RM 1</p>	<p>Nxënësi përshkruan rëndësinë dhe rolin e kafshëve të shoqërimit. Përmbajtja:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Historiku i kafshëve të shoqërimit dhe rëndësia e tyre. - Llojet dhe përzgjedhja e qenit. - Përkujdesja ndaj qenit. - Ushqimet dhe dieta e qenve. - Përzgjedhja e maces dhe trajnimi/stërvitja e saj. - Ushqimet dhe dieta e maces. - Riprodhimi i maceve shtëpiake. - Përkujdesja veterinare për macet. - Kujdesi për pëllumbat, trajnimi dhe të ushqyerit e tyre. - Katër hapat e përkujdesjes ndaj kafshëve të shoqërimit. <p>Instrumentet e vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Pyetje-përgjigje me gojë - Test me shkrim. <p>Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të përshkruajë historikun, rëndësinë, rolin dhe vlerat e kafshëve të shoqërimit; - të përshkruajë llojet dhe përzgjedhja e qenit; - të interpretojë përkujdesjet ndaj qenit; - të përshkruajë dhe ushqimet e qenve; - të vlerësojë dietën e qenve gjatë të ushqyerit të tyre; - të përzgjedhë macen; - të përshkruajë teknikat e trajnimit/stërvitjes së maces; - të përshkruajë ushqimet e maces; - të vlerësojë dietën e maces gjatë të ushqyerit të tyre; - të përshkruajë riprodhimin e maceve shtëpiake; - të përshkruajë përkujdesjet veterinare për macet; - të përshkruajë përkujdesjet kryesore për pëllumbat; - të përshkruajë teknikat e trajnimit të pëllumbave; - të përshkruajë mënyrën e të ushqyerit të pëllumbave;
---	--------------------	--

		<ul style="list-style-type: none"> - të theksojë katër hapat kryesorë të kujdesit ndaj kafshëve të shoqërimin.
	<p>RM 2</p>	<p>Nxënësi kujdeset për kafshët e vogla të shoqërimin. Përmbajtja:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Veshja e uniformës për kujdesin ndaj qenve e maceve. - Dhënia e udhëzimeve për kujdesin ndaj qenve e maceve. <p>A. Kujdesi ndaj qenit</p> <ul style="list-style-type: none"> - Përzgjedhja e racës së qenit. - Përcaktimi i moshës së dëshiruar të qenit. - Përcaktimi i vendit të ushqyerjes dhe të fjetjes së qenit. - Të ushqyerit e qenit. - Kontrolli i vazhdueshëm i qenit për parazitë. - Shëtitja me qenin jashtë ambientit të shtëpisë. - Ushtrimi i lojërave të ndryshme me qenin. - Kontrolli i vazhdueshëm veterinar i qenit. - Vaksinimi i rregullt i qenit. - Komunikimi i vazhdueshëm dhe i larmishëm me qenin. - Mjetet dhe aksesoret e tjerë të përkujdesjes për qentë. <p>B. Kujdesi për macet</p> <ul style="list-style-type: none"> - Përzgjedhja e racës së maces. - Përcaktimi i moshës së dëshiruar të maces. - Përcaktimi i vendit të ushqyerjes dhe të fjetjes së maces. - Të ushqyerit e maces. - Kontrolli i vazhdueshëm i maces për parazitë. - Shëtitja me macen jashtë ambientit të shtëpisë. - Ushtrimi i lojërave të ndryshme me macen. - Kontrolli i vazhdueshëm veterinar i maces. - Vaksinimi i rregullt i maces. - Komunikimi i vazhdueshëm dhe i larmishëm me macen. - Mjetet dhe aksesoret e tjerë të përkujdesjes për macet.

		<ul style="list-style-type: none"> - Zbatimi i rregullave të sigurisë, të higjienës personale të kafshës, si dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë përkujdesjeve të tyre. <p>Instrumentet e vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Vëzhgim me listë kontrolli. <p>Kriteret e vlerësimit:</p> <p>Nxënësi duhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të veshë uniformën e duhur për kujdesin ndaj qenve e maceve; - të marrë në konsideratë në vijueshmëri udhëzimet e dhëna për kujdesin ndaj qenve e maceve. <p>A. Kujdesi ndaj qenit</p> <ul style="list-style-type: none"> - Të përzgjedhë racën e qenit që dëshiron sipas kriterëve të duhura. - Të përcaktojë moshën e dëshiruar të qenit. - Të përcaktojë vendin e ushqyerjes dhe të fjetjes së qenit sipas udhëzimeve. - Të ushqejë qenin sipas dietës dhe moshës së tij. - Të kontrollojë vazhdimisht qenin për parazitë. - Të shëtitë qenin jashtë ambientit të shtëpisë. - Të trajnojë apo të ushtrojë lojëra të ndryshme me qenin. - Të kryejë kontrolle veterinare të vazhdueshme qenit. - Të bëjë vaksinimin e rregullt të qenit në klinikën veterinare. - Të komunikojë vazhdimisht dhe në mënyra të ndryshme me qenin. - Të përdorë mjetet dhe aksesoret e tjerë të përkujdesjes për qentë. <p>B. Kujdesi për macet</p> <ul style="list-style-type: none"> - Të përzgjedhë racën e dëshiruar të maces. - Të përcaktojë moshën e dëshiruar të maces. - Të përcaktojë vendin e ushqyerjes dhe të fjetjes së maces. - Të ushqejë macen sipas dietës dhe moshës. - Të kontrollojë vazhdimisht macen për parazitë. - Të shëtitë macen jashtë ambientit të shtëpisë. - Të trajnojë apo ushtrojë lojëra të ndryshme me macen. - Të kontrollojë vazhdimisht macen te mjeku veterinar.
--	--	--

		<ul style="list-style-type: none"> - Të vaksinohë rregullisht macen në klinikën veterinare. - Të komunikohë vazhdimisht dhe me mënyra të ndryshme me macen. - Të përdorë mjetet dhe aksesoret e tjerë të përkujdesjes për macet. - Të zbatohë me rreptësi rregullat e sigurisë, higjienës personale të kafshës, si dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë përkujdesjeve të tyre.
	<p>RM 3</p>	<p>Nxënësi kujdeset për shpendët dekorativ. <i>Përmbajtja</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - Veshja e uniformës së punës. - Përzgjedhja e kafazit për shpendë dekorativ. - Përzgjedhja e mjeteve, pajisjeve dhe materialeve për kujdesin ndaj shpendëve dekorativ. - Vendosja e shufrave prej druri në kafaz. - Vendosja e tubave me ujë të pijshëm. - Ushqyerja e shpendëve dekorativ. - Përlllogaritja e racionit ushqimor me fruta. - Përdorimi i perimeve dhe frutave në racionin ushqimor. - Përzgjedhja ushqimeve të njoma në racionin ushqimor. - Dhënia e vitaminave në formë pluhuri me ushqim. - Përdorimi i lëndëve minerale në ushqim. - Blerja e ushqimeve të gatshme me vlera të larta ushqyese. - Këshillimi me veterinerin për shëndetin e shpendëve dekorativ. - Zbatimi i masave profilaktike dhe mjekuese në tufën e papagajve. - Pastrimi mekanik i kafazit për të hequr papastërtitë e ndryshme. - Përzgjedhja dhe përgatitja e mjeteve që përdoren për pastrimin, larjen e enëve të ushqimit, të ujit dhe të kafazit. - Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik, të

		<p>higjienës dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë përkujdesjes për shpendët dekorativ.</p> <p>Instrumentet e vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Vëzhgim me listë kontrolli. <p>Kriteret e vlerësimit:</p> <p>Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të veshë uniformën e duhur të punës; - të përzgjedhë kafazin sipas llojit të shpendit; - të përzgjedhë mjetet, pajisjet dhe materialet për kujdesin ndaj shpendëve dekorativ; - të vendosë shufrat prej druri në vendin e duhur brenda në kafaz; - të vendosë tubat me ujë të pijshëm brenda në kafaz; - të ushqejë shpendët sipas veçorive; - të përlogarisë racionit ushqimor me fruta për shpendët; - të përdorë perimet dhe frutat në menunë ditore; - të përzgjedhë ushqime të njoma në racionin ushqimor; - të përdorë vitaminat në formë pluhuri në ushqimin e shpendëve; - të përdorë lëndë minerale në ushqimin e shpendëve; - të bëjë ushqime të gatshme me vlera të larta ushqyese; - të këshillohet me veterinerin për shëndetin e shpendëve dekorativ; - të zbatojë me rreptësi masat profilaktike dhe mjekuese në tufën e papagajve; - të pastrojë kafazin për të hequr papastërtitë e ndryshme; - të përzgjedhë e përgatitë mjetet që përdoren për pastrimin dhe larjen e enëve të ushqimit, të ujit dhe të kafazit; - të zbatojë me rreptësi rregullat e sigurimit teknik, të higjienës dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë përkujdesjes për shpendët dekorativ.
--	--	---

<p>Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e nxënësve</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Ky modul duhet të trajtohet në shkollë si dhe në klinika veterinare. - Mësuesi duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur shembuj dhe demonstrime konkrete të kujdesit ndaj kafshëve të shoqërimin. - Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete fillimisht në mënyrë të mbikëqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur. Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me çështje të kafshëve shtëpiake, kafshëve të shoqërimin dhe shpendëve dekorativ. - Rekomandohet metoda e “lojës me role”, ku nxënësit kryejnë jo vetëm funksionin e pronarit të kafshës shoqëruese, por edhe të mjekut veterinar. - Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për kujdesin ndaj kafshëve të shoqërimin dhe shpendëve dekorativ. - Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.
<p>Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit</p>	<p>Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjedise dhe materialet e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Klasë e përshtatshme për zhvillimin e modulit. - Katalogë, manuale, udhëzues, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.

*INSTITUTI I ZHVILLIMIT TË ARSIMIT
PROGRAMET E KURRIKULËS ME ZGJEDHJE TË GJIMNAZIT*

MODULI: VEPRIMTARI NDIHMËSE NË LABORATOR

*PROGRAMI I MODULIT ME ZGJEDHJE
PËR TË GJITHA KLASAT*

TIRANË, QERSHOR 2011

PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli	VEPRIMTARI NDIHMËSE NË LABORATOR
Qëllimi	Një modul që njeh nxënësit me llojet dhe veçoritë e laboratorëve si dhe i aftëson ata për të përgatitur laboratorin për punë dhe për të kryer veprimtari të thjeshta profesionale në laborator si prodhim të aromave bimore apo analizën e produkteve ushqimore.
Kohëzgjatja e modulit	36 orë mësimore Rekomandohet: 40% Teori, 50% Praktikë, 10% Vlerësime

<p>Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>RM 1</p>	<p>Nxënësi përshkruan llojet dhe veçoritë e laboratorëve</p> <p><i>Përmbajtja:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - Rëndësia e laboratorëve dhe profili profesional i laborantit. - Laboratorët kimikë, llojet dhe funksionet e tyre. - Laboratorët farmaceutikë, llojet dhe funksionet e tyre - Laboratorët mikrobiologjikë dhe biokimikë, llojet dhe funksionet e tyre. - Laboratorët ushqimorë, llojet dhe funksionet e tyre. - Laboratorët industrialë, llojet dhe funksionet e tyre. - Laboratorët dentarë, llojet dhe funksionet e tyre. <p><i>Instrumentet e vlerësimit:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - Pyetje përgjigje me gojë. - Test me shkrim. <p><i>Kriteret e vlerësimit:</i></p> <p>Nxënësi duhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të shpjegojë rëndësinë e laboratorëve dhe të profesionit të laborantit; - të dallojë llojet e laboratorëve kimikë, veçoritë dhe funksionet e tyre; - të dallojë llojet e laboratorëve farmaceutikë, veçoritë dhe funksionet e tyre; - të dallojë llojet e laboratorëve mikrobiologjikë dhe biokimikë, veçoritë dhe funksionet e tyre; - të dallojë llojet e laboratorëve ushqimorë, veçoritë dhe funksionet e tyre; - të dallojë llojet e laboratorëve industrialë, veçoritë dhe funksionet e tyre; - të dallojë llojet e laboratorëve dentarë, veçoritë dhe funksionet e tyre; - të përgatisë sipas rregullit mjedisin dhe vendin e punës; - të zbatojë rregullat e sigurimit teknik, higjienës dhe mbrojtjes së mjedisit; - të pastrojë vendin e punës sipas rregullit.
--	--------------------	---

	<p>RM 2</p>	<p>Nxënësi përgatit laboratorin për punë.</p> <p><i>Përmbajtja:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - Studimi paraprak i analizës. - Përgatitja e vendit të punës për kryerjen e analizës. - Përgatitja për punë e pipetave, spatulave, furçave të pastrimit, peshoreve etj. - Përgatitja për punë e llambave të gazit. - Teknikat e larjes së mjeteve të punës. - Përzgjedhja e detergjenteve, tretësve organikë sipas rastit. - Parapërgatitja e furrave tharëse kalçinuese. - Përgatitja për punën e enëve prej qelqi (gotat, enët konike, balonat, hinkat, kondensatorët). - Kontrolli teknik dhe kalibrimi i pajisjeve (termometri, balancat, manometrat etj). - Vënia në punë e ujit. - Vënia në punë e gazit. - Vënia në punë e energjisë elektrike. - Organizimi i reagjentëve. - Sistemimi i mjeteve dhe pajisjeve. - Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit. - Pastrimi i vendit të punës. <p><i>Instrumentet e vlerësimit:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - Pyetje përgjigje me gojë. - Vëzhgim me listë kontrolli. <p><i>Kriteret e vlerësimit:</i></p> <p>Nxënësi duhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të studiojë paraprakisht analizën sipas rregullave; - të përgatisë vendin e punës për kryerjen e analizës; - të përgatisë për punë pipetat, spatulat, furçat e pastrimit, peshoret etj; - të përgatisë për punë pipetat, spatulat, furçat e pastrimit, peshoret etj; - të përgatisë për punë llambat e gazit; - të zbatojë teknikat e larjes së mjeteve të punës; - të përzgjedhë detergjentët, tretësit organikë sipas rastit;
--	--------------------	--

	<p>RM 3</p>	<ul style="list-style-type: none"> - të përgatisë furra tharëse kalçinuese; - të përgatisë për punë enë prej qelqi (gotat, enët konike, balonat, hinkat, kondensatorët); - të kryejë kontrollin teknik dhe kalibrimin e pajisjeve (termometri, balancat, manometrat etj); - të vendosë ujin në punë; - të vendosë gazin në punë; - të vendosë energjinë elektrike në punë; - të organizojë reagjentët; - të sistemojë mjetet dhe pajisjet në laborator; - të zbatojë rregullat e sigurimit teknik, higjienës dhe mbrojtjes së mjedisit; - të pastrojë sipas rregullit vendin e punës. <p>Nxënësi prodhon aroma bimore (vaj esencial).</p> <p><i>Përmbajtja:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - Përgatitja e vendit të punës. - Përgatitja e pajisjeve dhe mjeteve për punë. - Studimi i procedurës së prodhimit të aromës bimore. - Montimi i aparaturës së distilimit të bimës aromatike. - Përzgjedhja e bimës aromatike (sherbele, lëkurë portokalli, karafil, lëkurë banane, timus etj). - Pastrimi i bimës aromatike. - Prerja e bimës aromatike. - Sitja e bimës aromatike. - Futja e bimës aromatike në aparaturë. - Hedhja e ujit në balonën e distilimit. - Kryerja e distilimit. - Ndarja e vajit esencial nga uji. - Sistemimi i mjeteve dhe pajisjeve. - Pastrimi i vendit të punës. - Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit. <p><i>Instrumentet e vlerësimit:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - Pyetje përgjigje me gojë. - Vëzhgim me listë kontrolli. <p><i>Kriteret e vlerësimit:</i></p> <p>Nxënësi duhet:</p>
--	--------------------	--

		<ul style="list-style-type: none"> - të përgatisë vendin e punës për prodhimin e aromave bimore (vaj esencial); - të përgatisë pajisjet dhe mjetet e punës për prodhimin e aromave bimore (vaj esencial); - të studiojë procedurën e prodhimit të aromës bimore; - të montojë aparaturën e distilimit të bimës aromatike; - të përzgjedhë bimën aromatike sipas rregullave (sherbele, lëkurë portokalli, karafil, lëkurë banane, timus etj); - të pastrojë bimën aromatike; - të presë bimën aromatike; - të sitë bimën aromatike; - të vendosë bimën aromatike në aparaturë; - të vendosë ujë në balonën e distilimit; - të kryejë distilimin me aparaturë; - të kryejë ndarjen e vajit esencial nga uji; - të sistemojë mjetet dhe pajisjet në laborator; - të zbatojë rregullat e sigurimit teknik, higjienës dhe mbrojtjes së mjedisit; - të pastrojë vendin e punës sipas rregullit.
	<p>RM 4</p>	<p>Nxënësi vlerëson cilësinë e produktit ushqimor (ujit, qumështit, bukës, verës, mishit, nënprodukteve etj) në laborator.</p> <p><i>Përmbajtja:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - Përgatitja e vendit të punës. - Përgatitja e pajisjeve dhe mjeteve për analizën. - Përzgjedhja e produktit ushqimor. - Përcaktimi i analizës që do të kryhet sipas produktit. - Përcaktimi i procedurës së analizës. - Analizat organoleptike të produktit ushqimor. <ul style="list-style-type: none"> - Vlerësimi i aromës, shijes. - Vlerësimi i pamjes, ngjyrës, konsistencës etj. - Vlerësimi i etiketës dhe ambalazhit. - Analizat kimike të produktit ushqimor. - Analizat fizike të produktit ushqimor. - Përpilimi i raportit të analizave të produktit ushqimor. - Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe

	<p>mbrojtjes së mjedisit.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Pastrimi i vendit të punës. <p>Instrumentet e vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Pyetje përgjigje me gojë. - Vëzhgim me listë kontrolli. <p>Kriteret e vlerësimit:</p> <p>Nxënësi duhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të përgatisë vendin e punës për vlerësimin e cilësisë së produkteve ushqimore sipas llojit të produktit dhe analizës; - të përgatisë pajisjet dhe mjetet e punës për vlerësimin e cilësisë së produkteve ushqimore sipas llojit të produktit dhe analizës; - të përzgjedhë produktin ushqimor për analizë; - të përcaktojë analizën që do të kryhet sipas produktit; - të përcaktojë procedurën e analizës; - të kryejë analizat organoshqisore të produktit ushqimor; - të vlerësojë treguesit e aromës, shijes; - të vlerësojë treguesit e pamjes, ngjyrës, konsistencës etj; - të vlerësojë treguesit e etiketës dhe ambalazhit; - të kryejë analiza të thjeshta kimike të produktit ushqimor të përzgjedhur; - të kryejë analiza të thjeshta fizike të produktit ushqimor të përzgjedhur; - të përpilojë raportin e analizave të produktit ushqimor; - të zbatojë rregullat e sigurimit teknik, higjienës dhe mbrojtjes së mjedisit; - të pastrojë sipas rregullit vendin e punës.
<p>Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e kursantëve</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Ky modul duhet të trajtohet në klasë, për pjesën teorike, dhe në laboratore të ndryshme për aftësimin praktik për kryerjen e analizave laboratorike. - Nxënësit i duhet shpjeguar nga mësuesi apo eksperti i laboratorit (laboranti), veçoritë dhe karakteristikat e laboratorëve të ndryshëm. - Mësuesi apo eksperti i laboratorit duhet të demonstrojë procedurat për vënien e laboratorit në punë, për distilimin

	<p>e vajrave aromatikë apo për analizat e produkteve ushqimore, si dhe të mbikëqyr nxënësin gjatë praktikimit.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për rezultatet e parashikuara në modul. - Mësuesi apo eksperti i laboratorit duhet të mbikëqyrë respektimin e rregullave të sigurimit teknik, të higjienës, të mbrojtjes së mjedisit dhe mirëmbajtjes së mjeteve dhe pajisjeve. - Gjatë vlerësimit të nxënësit, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e veprimeve të parashikuara në modul.
<p>Baza materiale e domosdoshme</p>	<p>Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Laborator i kimisë apo edhe teknologjisë ushqimore për analizat dhe matjet. - Mjete pune për proceset parapërgatitore të përpunimit të pemëve. - Lëndë të para dhe ndihmëse për analizat e parashikuara në modul. - Media didaktike (CD, filma etj) për konkretizimin e njohurive dhe aftësive të parashikuara në modul.

Aneks 2

Qendrat publike të formimit profesional

Gjithsej janë 8 qendra publike të formimit profesional të shpërndara në rajone të ndryshme të vendit. Këto qendra ofrojnë kurse profesionale afatshkurtra me kurrikula modulare. Shkollat mund të përzgjedhin module që janë me interes për ta apo të bashkëpunojnë me këto qendra për realizimin e moduleve.

Shkollat mund të lidhin kontrata me këto qendra për realizimin e moduleve profesionale.

Qendra e Formimit Profesional Nr. 1 Tiranë ofron trajnim në këto specialitete:

Nr.	Emërtimi i kursit	Kohëzgjatja
1.	Sekretari	2 muaj
2.	Rrobaqepësi	16 javë
3.	Autoservis	12 javë
4.	Riparim kondicionerësh	12 javë
5.	Kozmetike	16 javë

Për informacion të mëtejshëm kontakto në:

Adresa: Rruga Mine Peza; Tel: 04 225839

Qendra e Formimit Profesional Nr. 4 Tiranë ofron trajnim në këto specialitete:

Nr.	Emërtimi i kursit	Kohëzgjatja
1.	Hidraulike	15 javë
2.	Duralumin	8 javë
3.	Instalime elektrike në ndërtesat civile	16 javë
4.	Riparime elektro-shtëpiake	10 javë
5.	Rrobaqepësi	16 javë

6.	Saldator	10 javë
7.	Kompjuter	8 javë
8.	Kompjuter (Xpert)	
9.	Qepje faqe këpucësh	
10.	Riparim radio, kasetofon, magnetofon	10 javë
11.	Riparim TV	10 javë
12.	Këpucari	
13.	Riparim makinash qepëse	4 javë

Për informacion të mëtejshëm kontakto në numrin e Tel: 04 259978

Qendra e Formimit Profesional Durrës ofron trajnim në këto specialitete:

Nr.	Emërtimi i kursit	Kohëzgjatja
1.	Anglisht fillestar	12 javë
2.	Anglisht mesatar	12 javë
3.	Anglisht avancuar	12 javë
4.	Sekretari	10 javë
5.	Rrobaqepësi	16 javë
6.	Instalime elektrike në ndërtesat civile	16 javë
7.	Kompjuter	8 javë
8.	Kompjuter (Xpert)	18 javë
9.	Riparim makinash qepëse	4 javë
10.	Riparime elektro-shtëpiake	10 javë
11.	Italisht	10 javë
12.	Kozmetike	16 javë
13.	Riparim panelesh diellore	10 javë
14.	Mobilieri	15 javë

Qendra e Formimit Profesional Kavajë ofron trajnim në këto specialitete:

Nr.	Emërtimi i kursit	Kohëzgjatja
1.	Anglisht fillestar	12 javë
2.	Anglisht mesatar	12 javë
3.	Anglisht avancuar	12 javë
4.	Rrobaqepësi	16 jave
5.	Kompjuter	6 javë
6.	Kompjuter (Xpert)	18 javë
7.	Gjermanisht	10 javë
8.	Italisht	10 javë

Për informacion të mëtejshëm kontakto në numrin e Tel: 0522 9857

Qendra e Formimit Profesional Elbasan ofron trajnim në këto specialitete:

Nr.	Emërtimi i kursit	Kohëzgjatja
1.	Anglisht fillestar	12 javë
2.	Anglisht mesatar	12 javë
3.	Anglisht avancuar	12 javë
4.	Sekretari	10 javë
5.	Rrobaqepësi	16 javë
6.	Kompjuter	6 javë
7.	Kompjuter (Xpert)	18 javë
8.	Hidraulik	17 javë

Për informacion të mëtejshëm kontakto në numrin e Tel: 0545 8628

Qendra e Formimit Profesional Shkodër ofron trajnim në këto specialitete:

Nr.	Emërtimi i kursit	Kohëzgjatja
1.	Anglisht fillestar	12 javë
2.	Anglisht mesatar	12 javë
3.	Anglisht avancuar	12 javë
4.	Sekretari	10 javë
5.	Rrobaqepësi	16 javë
6.	Instalime elektrike në ndërtesat civile	16 javë
7.	Kompjuter	6 javë
8.	Kompjuter (Xpert)	18 javë
9.	Riparim makinash qepëse	4 javë
10.	Riparime elektro-shtëpiake	16 javë
11.	Italisht	10 javë
12.	Punime duralumini	8 javë

Për informacion të mëtejshëm kontakto në numrin e Tel: 0224 3108

Qendra e Formimit Profesional Korçë ofron trajnim në këto specialitete:

Nr.	Emërtimi i kursit	Kohëzgjatja
1.	Anglisht fillestar	12 javë
2.	Anglisht mesatar	12 javë
3.	Anglisht avancuar	12 javë
4.	Sekretari	10 javë
5.	Rrobaqepësi	16 javë
6.	Kozmetike	16 javë
7.	Kompjuter	6 javë
8.	Kompjuter (Xpert)	18 javë

Për informacion të mëtejshëm kontakto në numrin e Tel:0824 2729

Qendra e Formimit Profesional Tepelenë ofron trajnim në këto specialitete:

Nr.	Emërtimi i kursit	Kohëzgjatja
1.	Anglisht fillestar	12 javë
2.	Anglisht mesatar	12 javë
3.	Anglisht avancuar	12 javë
4.	Përpunim bulmeti	1 javë
5.	Kompjuter	6 javë
6.	Kompjuter (Xpert)	18 javë

Për informacion të mëtejshëm kontakto në numrin e Tel: 0722 2346

Qendra e Formimit Profesional Vlorë ofron trajnim në këto specialitete:

Nr.	Emërtimi i kursit	Kohëzgjatja
1.	Anglisht fillestar	12 javë
2.	Anglisht mesatar	12 javë
3.	Anglisht avancuar	12 javë
4.	Sekretari	10 javë
5.	Rrobaqepësi	16 javë
6.	Instalime elektrike në ndërtesat civile	16 javë
7.	Kompjuter	6 javë
8.	Kompjuter (Xpert)	18 javë
9.	Riparim makinash qepëse	4 javë
10.	Riparime elektro-shtëpiake	10 javë
11.	Italisht	10 javë
12.	Hidraulik	16 javë

Për informacion të mëtejshëm kontakto në numrin e Tel: 0332 6759

Aneks 3.

Module të tjera të sugjeruara marrë nga kurrikulat e Arsimit profesional

1. MODULI “PËRGATITJA E AKSESORËVE”

Drejtimi: Konfeksione

Niveli: I

Klasa: 11

<i>PËRSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	PËRGATITJA E AKSESORËVE	M-10-325-09
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që aftëson nxënësit për të përgatitur, aksesorë të thjeshtë shoqërues, me mënyra të ndryshme, me dorë dhe me makina qepëse.	
Kohëzgjatja e modulit	51 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar.	

Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	RM 1	Nxënësi qep shalle dhe shaje <i>Përmbajtja:</i> <ul style="list-style-type: none">- Përgatitja e vendit dhe mjeteve të punës për qepjen e shalleve dhe shajeve.- Përzgjedhja e materialeve të punës- Skicimi i modelit.- Vizatimi në pëlhurë.- Prerja e shallit/shalleve- Qepja e shallit.- Qepja e shalleve.- Finalizimi i shallit dhe shajeve.- Dekorimi i shallit dhe shajeve.- Pastrimi i vendit të punës.- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit. <i>Instrumentet e vlerësimit:</i> <ul style="list-style-type: none">- Vëzhgim me listë kontrolli.
--	-------------	---

		<p>Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të përgatisë vendin dhe mjetet e punës për qepjen e shalleve dhe shajeve; - të përzgjedhë materialet e punës sipas modelit dhe llojit të tekstilit; - të skicojë modelin; - të vizatojë në pëlhurë sipas skicës shallin/shaje; - të presë shallin/shaje sipas rregullit; - të qepë sipas rregullit shallin/shaje; - të finalizojë shallin/shaje sipas rregullit; - të pastrojë vendin e punës duke respektuar rregullat e higjienës; - të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.
	<p>RM 2</p>	<p>Nxënësi përgatit portofol dhe çantë pëlhure Përmbajtja:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Përgatitja e vendit dhe mjeteve të punës për qepjen e portofolave prej pëlhure. - Përzgjedhja e materialit kryesor dhe materialeve ndihmëse. - Skicimi i portofolit/ çantës në letër. - Vizatimi i portofolit/ çantës në pëlhurë. - Prerja e materialit me dorë/makinë sipas modelit. - Qepja e çantës/ portofolit me dorë/makinë sipas modelit. - Finalizimi i procesit të qepjes. - Dekorimi i portofolit/ çantës. - Pastrimi i vendit të punës. - Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit. <p>Instrumentet e vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Vëzhgim me listë kontrolli. <p>Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të përgatisë vendin dhe mjetet e punës për qepjen e portofolave prej pëlhure; - të përzgjedhë materialin kryesor dhe materialet ndihmëse; - të skicojë portofolin/ çantën në letër sipas rregullit;

		<ul style="list-style-type: none"> - të vizatojë portofolin/ çantën në material sipas rregullit; - të presë materialin me dorë/makinë sipas modelit; - të qepë çantën/portofolin me dorë/makinë sipas modelit; - të finalizojë procesin e qepjes sipas rregullit; - të dekorojë çantën/portofolin sipas rregullit; - të pastrojë vendin e punës duke respektuar rregullat e higjienës; - të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit.
	<p>RM 3</p>	<p>Nxënësi përgatit rruaza të thjeshta. Përmbajtja:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Përgatitja e vendit dhe mjeteve të punës për përgatitjen e rruazave. - Përzgjedhja e materialit kryesor (rruazave) dhe ndihmës për përgatitjen e rruazave. - Vizatimi i modelit. - Realizimi i rruazave. - Finalizimi i përgatitjes. - Pastrimi i vendit të punës. - Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit. <p>Instrumentet e vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Vëzhgim me listë kontrolli. <p>Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të përgatisë vendin dhe mjetet e punës për përgatitjen e rruazave; - të përzgjedhë materialin kryesor (rruazat) dhe ndihmës për përgatitjen e rruazave; - të vizatojë modelin; - të vendosë pëlhurën në gjergjef; - të realizojë rruazat sipas modelit; - të finalizojë rruazat; - të pastrojë vendin e punës duke respektuar rregullat e higjienës; - të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit.

<p>Udhëzime për zbatimin e modulit</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Ky modul duhet të trajtohet kryesisht në reparte të qepjes së veshjeve. - Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrime konkrete të proceseve të qepjes së aksesorëve të veshjeve. - Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për realizimin e aksesorëve të ndryshme me dorë dhe me makina qepëse. - Instruktori i praktikës duhet të mbikëqyrë respektimin e rregullave të sigurimit teknik, të mbrojtjes së mjedisit dhe mirëmbajtjes së makinerive dhe pajisjeve - Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e aksesorëve të ndryshme në veshje.
<p>Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit</p>	<p>Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Repart me makina të ndryshme qepëse. - Mjete pune për qëndisjen me dorë dhe me makina të ndryshme qepëse. - Lëndë të para dhe ndihmëse për qëndisjen dhe dekorimin e veshjeve. - Katalogë me modele të ndryshme qëndisjeje dhe dekoracioni.

2. MODULI “QËNDISJET DHE PUNIMET ME GREP/SOVAJKË”

Drejtimi: Konfeksione

Niveli: I

Klasa: 10

<i>PËRSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	QENDISJET DHE PUNIMET ME GREP/SOVAJKE	M-10-326-09
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që aftëson nxënësit për të kryer qëndisje dhe punë dore të ndryshme.	
Kohëzgjatja e modulit	72 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar.	

Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	RM 1	<p>Nxënësi kryen qëndisje të thjeshta Përmbajtja:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Përgatitja e vendit dhe mjeteve të punës për qëndisje të thjeshta. - Përzgjedhja e materialeve të punës. - Skicimi i modelit. - Vendosija e tekstilit në gjergjef. - Qëndisja shkop. - Qëndisja me kryqe. - Qëndisja fiston. - Qëndisja e vrimave të kopsave. - Finalizimi i qëndisjes. - Pastrimi i vendit të punës. - Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit. <p>Instrumentet e vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Vëzhgim me listë kontrolli. <p>Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të përgatisë vendin dhe mjetet e punës për
--	-------------	--

		<p>qëndisje të thjeshta;</p> <ul style="list-style-type: none"> - të përzgjedhë materialet e punës sipas modelit dhe llojit të tekstit; - të skicojë modelin; - të vendosë saktë tekstin në gjergjef; - të qëndisë shkop, me kryqe dhe fiston sipas modelit; - të qëndisë vrimat e kopsave sipas modelit; - të finalizojë qëndisjen; - të pastrojë vendin e punës duke respektuar rregullat e higjienës; - të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.
	<p>RM 2</p>	<p>Nxënësi kryen aplikacione me copë dhe pikturë <i>Përmbajtja:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - Përgatitja e vendit dhe mjeteve të punës për aplikacione të tekstit. - Vizatimi i modelit në pëlhurë. - Vendosja e tekstit në gjergjef. - Fiksimi i materialit në tekstil. - Aplikacioni me pëlhurë. - Aplikacioni me pikturë. - Finalizimi i procesit të aplikacionit. - Pastrimi i vendit të punës. - Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit. <p><i>Instrumentet e vlerësimit:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - Vëzhgim me listë kontrolli <p><i>Kriteret e vlerësimit:</i></p> <p>Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të përgatisë vendin dhe mjetet e punës për aplikacione të tekstit; - të vizatojë modelin në pëlhurë; - të vendosë tekstin në gjergjef; - të fiksojë materialin në tekstil; - të kryejë aplikacione me pëlhurë në tekstil; - të kryejë aplikacione me pikturë në tekstil; - të finalizojë procesin e aplikacionit; - të pastrojë vendin e punës duke respektuar rregullat e higjienës; - të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit.

	<p>RM 3</p>	<p>Nxënësi kryen punë të thjeshta me grep dhe sovajkë.</p> <p><i>Përmbajtja:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - Përgatitja e vendit dhe mjeteve të punës për punimet me grep dhe sovajkë. - Përzgjedhja e fillit për punë me grep. - Përzgjedhja e fillit për punë me sovajkë. - Skicimi i modelit. - Kryerja e punëve të thjeshta me grep sipas modelit. - Kryerja e punëve të thjeshta me sovajkë sipas modelit. - Finalizimi i punëve me grep dhe sovajkë. - Pastrimi i vendit të punës. - Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit. <p><i>Instrumentet e vlerësimit:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - Vëzhgim me listë kontrolli. <p><i>Kriteret e vlerësimit:</i></p> <p>Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të përgatisë vendin dhe mjetet e punës për punimet me grep dhe sovajkë; - të përzgjedhë fillin për punë me grep; - të përzgjedhë fillin për punë me sovajkë; - të skicojë modelin; - të vendosë pëlhurën në gjergjef; - të kryejë punë me grep sipas modelit; - të kryejë punë me sovajkë sipas modelit; - të finalizojë punët me grep dhe sovajkë sipas rregullit; - të pastrojë vendin e punës duke respektuar rregullat e higjienës; - të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit.
--	--------------------	--

<p>Udhëzime për zbatimin e modulit</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Ky modul duhet të trajtohet kryesisht në reparte të qepjes së veshjeve. - Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrime konkrete të proceseve të qëndisjes dhe punimeve me grep dhe sovajkë. - Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për realizimin e qëndisjeve të ndryshme me dorë dhe me makina qepëse. - Instruktori i praktikës duhet të mbikëqyrë respektimin e rregullave të sigurimit teknik, të mbrojtjes së mjedisit dhe mirëmbajtjes së makinerive dhe pajisjeve. - Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e qëndisjeve dhe punimeve me grep dhe sovajkë.
<p>Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit</p>	<p>Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Repart me makina të ndryshme qepëse. - Mjete pune për qëndisjen me dorë dhe me makina të ndryshme qepëse dhe punimet me grep e sovajkë. - Lëndë të para dhe ndihmëse për qëndisjen dhe punimet me grep dhe sovajkë. - Katalogë me modele të ndryshme qëndisjeje dhe për punimet me grep e sovajkë.

3. MODULI “SHËRBIMI I PUSHIMEVE TË KAFESË”

PËRSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe kodi	SHËRBIMI I PUSHIMEVE TË KAFESË	M-13-125-09
Qëllimi i modulit	Një modul që aftëson nxënësit për të përgatitur bufenë dhe për të shërbyer në pushimet e kafesë.	
Kohëzgjatja e modulit	36 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	të jenë nxënës që kanë përfunduar arsimin e detyruar.	

Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	RM 1	<p>Nxënësi parapërgatit bufenë për shërbimin e pushimit të kafesë Përmbajtja:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Parapërgatitjet për pushimin e kafesë. - Parapërgatitjet në kuzhinë. - Vendosja e pajisjeve në karrocën e shërbimit. - Vendosja e tavolinave të bufesë. - Vendosja e mbulesave me pala. - Vendosja e mbulesave të sipërme. - Vendosja e tavolinave për klientët. - Vendosja e filxhanëve në bufë. - Vendosja e gotave në bufë. - Vendosja e lugëve në bufë. - Vendosja e pecetave. - Vendosja e mbajtëseve të sheqerit. - Vendosja e paketave të çajit. - Vendosja e tavllave. - Vendosja e filtrit të kafesë. - Vendosja e filtrit të ujit të nxehtë. - Vendosja e filtrit të qumështit. - Vendosja e pijeve të ftohta në bufë. - Vendosja e ushqimeve të ftohta në bufë. - Vendosja e ushqimeve të ngrohta në bufë.
--	-------------	---

		<ul style="list-style-type: none"> - Zbukurimi i bufesë për pushimin e kafesë. - Kontrolli përpara fillimit të shërbimit. - Rregullat e higjienës, të mbrojtjes në punë dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë përgatitjes për shërbimin e pushimit të kafesë. <p>Instrumentet e vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Vëzhgim me listë kontrolli. <p>Kriteret e vlerësimit:</p> <p>Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të kryejë parapërgatitjet për pushimin e kafesë; - të kryejë parapërgatitjet në kuzhinë; - të vendosë pajisjet në karrocën e shërbimit sipas rregullave; - të vendosë tavolinat e bufesë sipas rregullave; - të vendosë e mbulesat me pala në tavolina sipas rregullit; - të vendosë mbulesat e sipërme në tavolina sipas rregullit; - të vendosë tavolinat për klientët sipas rregullit; - të vendosë filxhanët në bufe sipas rregullit; - të vendosë gotat në bufe sipas rregullit; - të vendosë lugët në bufe sipas rregullit; - të vendosë pecetat në bufe sipas rregullit; - të vendosë mbajtëset e sheqerit në bufe sipas rregullit; - të vendosë paketat e çajit në bufe sipas rregullit; - të vendosë tavllat në bufe sipas rregullit; - të vendosë filtrin e kafesë në bufe sipas rregullit; - të vendosë filtrin e ujit të nxehtë sipas rregullit; - të vendosë filtrin e qumështit në bufe sipas rregullit; - të vendosë pijet e ftohta në bufe sipas rregullit; - të vendosë ushqime të ftohta në bufe sipas rregullit; - të vendosë ushqime të ngrohta në bufe sipas rregullit; - të zbukurojë bufenë për pushimin e kafesë sipas rregullit; - të kryejë kontrollin para fillimit të shërbimit sipas rregullit;
--	--	---

		<ul style="list-style-type: none"> - të zbatojë rregullat e higjienës, të mbrojtjes në punë dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë përgatitjes për shërbimin e pushimit të kafesë.
	<p>RM 2</p>	<p>Nxënësi shërben në pushimet e kafesë. Përmbajtja:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Pritja e klientëve për shërbimin e pushimit të kafesë. - Shërbimi i kafesë nga filtri. - Shërbimi i kafesë me qumësht. - Shërbimi i çajit. - Shërbimi i pijeve të ftohta në bufe. - Shërbimi i ushqimeve në bufe. - Mbledhja e pajisjeve të përdorura me tabaka. - Vendosja në karrocën e shërbimit e pajisjeve të përdorura. - Ndërrimi i tavllave gjatë pushimit të kafesë. - Asistenca për klientët gjatë pushimit të kafesë. - Rregullat e higjienës, të mbrojtjes në punë dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë shërbimit të pushimit të kafesë. <p>Instrumentet e vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Vëzhgim me listë kontrolli. <p>Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të presë klientët sipas rregullit për shërbimin e pushimit të kafesë; - të shërbejë kafënë nga filtri sipas rregullit; - të shërbejë kafënë me qumësht sipas rregullit; - të shërbejë çajin sipas rregullit; - të shërbejë pijet e ftohta në bufe sipas rregullit; - të shërbejë ushqimet në bufe sipas rregullit; - të mbledhë pajisjet e përdorura me tabaka sipas rregullit; - të vendosë pajisjet e përdorura në karrocën e shërbimit sipas rregullit; - të ndërrojë tavllat gjatë pushimit të kafesë sipas rregullit; - të asistojë sipas rregullit klientët gjatë pushimit të kafesë; - të zbatojë rregullat e higjienës, të mbrojtjes në punë dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë shërbimit të pushimit të kafesë.

	<p>RM 3</p>	<p>Nxënësi sistemon mjedisin dhe pajisjet pas pushimit të kafesë.</p> <p><i>Përmbajtja:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - Mbledhja e pajisjeve në karrocën e shërbimit. - Transporti i pajisjeve në vendet përkatëse. - Ndërrimi i mbulesave të sipërme të tavolinave. - Vendosja e zbukurimeve. - Kontrolli pas përfundimit të pushimit të kafesë. - Pastrimi i filtrave. - Larja e pajisjeve. - Tharja e pajisjeve. - Vendosja në tavolinën e shërbimit. - Rregullat e higjienës, të mbrojtjes në punë dhe të ruajtjes së mjedisit pas pushimit të kafesë. <p>Instrumentet e vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Vëzhgim me listë kontrolli. <p>Kriteret e vlerësimit:</p> <p>Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të mbledhë pajisjet në karrocën e shërbimit sipas rregullit; - të transportojë pajisjet në vendet përkatëse sipas rregullit; - të ndërrojë mbulesat e sipërme të tavolinave sipas rregullit; - të vendosë zbukurimet në tavolina sipas rregullit; - të kontrollojë ambientin pas pushimit të kafesë sipas rregullit; - të pastrojë filtrat sipas rregullit; - të lajë pajisjet sipas rregullit; - të thajë pajisjet sipas rregullit; - të vendosë pajisjet në tavolinën e shërbimit sipas rregullit; - të zbatojë rregullat e higjienës, të mbrojtjes në punë dhe të ruajtjes së mjedisit pas pushimit të kafesë.
--	--------------------	---

<p>Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e nxënësve</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Ky modul duhet të trajtohet në mjedise reale pune të restorantit, por rekomandohen dhe vizita në biznese që ofrojnë këtë shërbim. - Mësuesi duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete të teknikave të përdorimit të mjeteve dhe pajisjeve përkatëse. - Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune, fillimisht në mënyrë të mbikëqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur. Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me veprimtaritë që kryejnë. - Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e detyrave të dhëna. - Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kritereve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.
<p>Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit</p>	<p>Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Restorant real ose restorant i shkollës. - Komplet i mjeteve dhe pajisjeve të restorantit dhe kuzhinës. - Manuale, udhëzues dhe materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.

4. MODULI “PRANIMI I KËRKESAVE DHE ZGJIDHJA E ANKESAVE TË KLIENTIT NË RECEPSION”

Drejtimi: Hoteleri - Turizëm

Niveli: I

Klasa: 10

<i>PËRSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	PRANIMI I KËRKESAVE DHE ZGJIDHJA E ANKESAVE TË KLIENTIT NË RECEPSION	M-13-126-09
Qëllimi i modulit	Një modul që aftëson nxënësit për të komunikuar mirë me klientin në reception dhe për të zgjidhur ankesat e tyre.	
Kohëzgjatja e modulit	36 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	të jenë nxënës që kanë përfunduar arsimin e detyruar.	

Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	RM 1	<p>Nxënësi pranon kërkesat e klientit në reception. Përmbajtja:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Prezantimi me klientin në reception. - Pranimi i kërkesave të klientit. - Diskutimi me klientin për kërkesat e tij. - Krijimi i klimës pozitive gjatë diskutimit me klientin. - Zgjidhja e kërkesave dhe dëshirave të klientit. - Prezantimi i ofertave për klientin. - Formulimi i ofertave për klientin. - Prezantimi edhe në mënyrë të figurshme i ofertave për klientin. - Bindja e klientit. <p>Instrumentet e vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Vëzhgim me listë kontrolli. <p>Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p>
--	-------------	---

		<ul style="list-style-type: none"> - të prezantohet sipas rregullit me klientin në recepsion; - të pranojë sipas rregullit kërkesa nga klienti; - të diskutojë sipas rregullit me klientin për kërkesat e tij; - të krijojë klimë pozitive në bisedë me klientin; - të përdorë gjuhën e trupit gjatë komunikimit me klientin; - të përdorë drejt pyetjet në komunikim me klientin; - të dëgjojë me vëmendje klientin. - të zgjidhë kërkesat dhe të plotësojë dëshirat e klientit; - të formulojë saktë dhe kuptueshëm ofertat; - të prezantojë ofertat edhe në mënyrë figurative; - të shprehë qartë dobitë dhe avantazhet e ofertave për klientin; - të bindë klientin për avantazhet e ofertave.
	<p>RM 2</p>	<p>Nxënësi zgjidh ankesat e klientit në recepsion. <i>Përmbajtja:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - Prezantimi me klientin në recepsion. - Sjellja me klientin në raste ankesash. - Përkujdesja për klientin. - Sjellja me klientin e inatosur. - Zgjidhja e ankesave. <p><i>Instrumentet e vlerësimit:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - Vëzhgim me listë kontrolli. <p><i>Kriteret e vlerësimit:</i> Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të prezantohet në recepsion sipas rregullit me klientin; - të dëgjojë me vëmendje klientin gjatë paraqitjes së ankesave; - të pranojë sipas rregullit ankesa nga klienti; - të zbatojë rregullat e sjelljes me klientin në rast ankesash; - të përkujdeset për klientin sipas rregullit në rast ankesash; - të përkujdeset për klientin e inatosur sipas rregullit; - të zgjidhë ankesat e klientit në favor të klientit.

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e nxënësve	<ul style="list-style-type: none">- Ky modul duhet të trajtohet në mjedise reale pune, në recepsionin e shkollës, por rekomandohen dhe vizita në hotele që ofrojnë shërbimin e recepsionit.- Mësuesi duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete të teknikave të komunikimit.- Nxënësit duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me veprimtaritë që kryejnë.- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e detyrave të dhëna.- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kritereve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.
Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit	<p>Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none">- Recepsioni i shkollës, ose i hotelit.- Pajisje të recepsionit (kompjuter, faks, telefon, fotokopje, printer).- Manuale, udhëzues dhe materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.

5. MODULI “PËRGATITJA E USHQIMEVE FAST FOOD”

Drejtimi: Hoteleri - Turizëm

Niveli: I

Klasa: 10

<i>PËRSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	PËRGATITJA E USHQIMEVE FAST FOOD	M-13-124-09
Qëllimi i modulit	Një modul që aftëson nxënësit për të kryer veprimet paraprake, si dhe për të përgatitur ushqimet fast food.	
Kohëzgjatja e modulit	36 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	të jenë nxënës që kanë përfunduar arsimin e detyruar.	

Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	RM 1	<p>Nxënësi kryen proceset përgatitore për përgatitjen e ushqimeve fast food. <i>Përmbajtja:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - Leximi i menysë. - Përzgjedhja e mjeteve të punës. - Kontrolli i funksionimit të pajisjeve. - Kujdesi për pajisjet. - Vendosja e pajisjeve në punë. - Përzgjedhja e lëndëve të para sipas menysë. - Peshimi i lëndëve të para. - Larja dhe pastrimi i lëndëve të para. - Prerja e lëndëve të para. - Vendosja e lëndëve të para në banakun ftohës sipas rregullave në ndarje. - Vendosja e mjeteve të shërbimit sipas rregullave. - Mbushja e mbajtëseve të salcave. - Kujdesi për menazhet. - Rregullat e sigurisë, të higjienës dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë parapërgatitjes në fast food.
--	-------------	--

		<p>Instrumentet e vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Vëzhgim me listë kontrolli. <p>Kriteret e vlerësimit:</p> <p>Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të lexojë menynë; - të përzgjedhë sipas rregullit mjetet e punës; - të kontrollojë sipas procedurës funksionimin e pajisjeve; - të vendosë pajisjet në punë sipas procedurës; - të kujdeset për pajisjet sipas rregullit; - të bëjë përzgjedhjen e lëndëve të para sipas menysë; - të bëjë peshimin e lëndëve të para sipas menysë; - të bëjë larjen dhe pastrimin e lëndëve të para sipas rregullit; - të presë sipas procedurës lëndët e para; - të vendosë lëndët e para në banakun ftohës sipas rregullave në ndarje; - të mbushë sipas procedurës mbajtëset e salcave; - të kujdeset sipas rregullit për menazhet. - të zbatojë rregullat e sigurisë, të higjienës dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë parapërgatitjes në fast food.
	<p>RM 2</p>	<p>Nxënësi përgatit ushqime fast food.</p> <p>Përmbajtja:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Përgatitja e sanduiçeve në fast food. - Vendosja e përbërësve në sanduiçe. - Ambalazhimi i sanduiçeve. - Përgatitja e hamburgerit në fast food. - Vendosja e përbërësve në hamburger. - Ambalazhimi i hamburgerit. - Përgatitja e tostit në fast food. - Vendosja e përbërësve në toste. - Ambalazhimi i tosteve. - Përgatitja e hot dog në fast food. - Vendosja e përbërësve në hot dog. - Ambalazhimi i hot dog. - Përgatitja e sufllaqeve në fast food. - Vendosja e përbërësve në sufllaqe.

		<ul style="list-style-type: none"> - Ambalazhimi i suflaqeve. - Përgatitja e donerit në fast food. - Vendosja e përbërësve në doner. - Ambalazhimi i donerit. - Përgatitja e patateve të skuqura në fast food. - Ambalazhimi i patateve të skuqura. - Përgatitja e sallatave në fast food. - Ambalazhimi i sallatave në fast food. - Kujdesi për mjetet e punës. - Pastrimi i vendit të punës. - Rregullat e higjienës, të mbrojtjes në punë dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë përgatitjes së ushqimeve në fast food. <p>Instrumentet e vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Vëzhgim me listë kontrolli. <p>Kriteret e vlerësimit:</p> <p>Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të përgatisë sanduiçet sipas procedurës; - të vendosë sipas procedurës përbërësit në sanduiçe; - të ambalazhojë sipas rregullit sanduiçet; - të përgatisë sipas procedurës hamburger; - të vendosë sipas procedurës përbërësit në hamburger; - të ambalazhojë hamburgerin sipas rregullit; - të përgatisë toste sipas procedurës; - të vendosë sipas procedurës përbërësit në toste; - të ambalazhojë tostet sipas rregullit; - të përgatisë sipas procedurës hot dog; - të vendosë sipas procedurës përbërësit në hot dog; - të ambalazhojë sipas rregullit hot dog; - të përgatisë sipas procedurës suflaqe; - të vendosë sipas procedurës përbërësit në suflaqe; - të ambalazhojë sipas rregullit suflaqet; - të përgatisë doner sipas procedurës; - të vendosë sipas procedurës përbërësit në doner; - të ambalazhojë sipas rregullit donerin. - të përgatisë sipas procedurës patate të skuqura; - të ambalazhojë sipas rregullit patatet e skuqura;
--	--	--

		<ul style="list-style-type: none"> - të përgatisë sipas procedurës sallatat në fast food; - të ambalazhojë sipas rregullit sallatat në fast food; - të tregojë kujdesin e duhur për mjetet e punës; - të bëjë pastrimin e vendit të punës; - të zbatojë rregullat e higjienës, të mbrojtjes në punë dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë përgatitjes së ushqimeve në fast food.
	<p>RM 3</p>	<p>Nxënësi përgatit ushqime fast food në pjatë.</p> <p><i>Përmbajtja:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - Përgatitja e ushqimeve fast food në pjatë. - Vendosja në pjata e ushqimeve. - Dekorimi dhe servirja e ushqimeve. - Kujdesi për mjetet e punës. - Pastrimi i vendit të punës. - Rregullat e higjienës, të mbrojtjes në punë dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë përgatitjes së ushqimit në pjatë në fast food. <p><i>Instrumentet e vlerësimit:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - Vëzhgim me listë kontrolli. <p><i>Kriteret e vlerësimit:</i></p> <p>Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të përgatisë sipas procedurës ushqimet në pjatë në fast food; - të vendosë ushqimet në pjatë sipas rregullave; - të dekorojë dhe servirojë ushqimet në fast food sipas rregullave; - të kujdeset për mjetet e punës. - të pastrojë vendin e punës sipas rregullit; - të zbatojë rregullat e higjienës, të mbrojtjes në punë dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë përgatitjes së ushqimeve me pjatë në fast food.

<p>Udhëzime për zbatimin e modulit dhe vlerësimin e nxënësve</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Ky modul duhet të trajtohet në mjedise reale pune të kuzhinës, por rekomandohen dhe vizita në biznese që ofrojnë shërbimin e fast food. - Mësuesi duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete të teknikave të përgatitjes së ushqimeve fast food, me përdorimin e mjeteve dhe pajisjeve përkatëse. - Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për veprimet parapërgatitore, si dhe për përgatitjen e ushqimeve fast food, fillimisht në mënyrë të mbikëqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur. Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me veprimtaritë që kryejnë. - Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e detyrave të dhëna. - Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kritereve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.
<p>Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit</p>	<p>Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Fast food real ose kuzhinë e shkollës. - Kompleti i mjeteve, veglave dhe pajisjeve të kuzhinës për përgatitjen e ushqimeve fast food. - Lëndët e para dhe ndihmëse të nevojshme për gatimin e ushqimeve fast food. - Manuale, udhëzues dhe materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.

6. MODULI “PROCESE NDIHMËSE NË TREGTIMIN E KARBURANTEVE”

PËRSHKRUESI I MODULIT	
Titulli dhe kodi	PROCESE NDIHMËSE NË TREGTIMIN E KARBURANTEVE PËR AUTOMJETE
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që aftëson nxënësit për të kryer procese ndihmëse në stacionet e karburanteve.
Kohëzgjatja e modulit	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë kryer arsimin e detyruar.

Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	RM 1	<p>Nxënësi kryen parapërgatitjen e vendit të punës dhe të mjeteve ndihmëse në stacionet e shitjes së karburanteve.</p> <p>Përmbajtja:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Veshja e uniformës së punës. - Leximi i dokumentacionit përkatës. - Përgatitja e vendit të punës. - Përgatitja e mjeteve të punës. - Mbikëqyrja e impiantit të stacionit të karburantit. - Mbikëqyrja e mjeteve të nevojshme për mbrojtjen nga zjarri. - Mbikëqyrja e gatishmërisë së fikseve dhe sistemit të hidrantëve zjarrfikës. - Mbikëqyrja dhe respektimi anës figurative të stacionit të karburantit (tabelat paralajmëruese). - Mbikëqyrja e rezervuarëve, linjave të furnizimit dhe linjave të shkarkimit. - Mbikëqyrja e vendit të shkarkimit të autobotit për mbushjen e rezervuarëve.
--	-------------	---

		<ul style="list-style-type: none"> - Mbikëqyrja e procesit të depozitimit të karburantit. - Respektimi i sasisë maksimale të lejuar të depozitimit të karburantit në stacion. - Respektimi i sasisë maksimale të lejuar për çdo rezervuar, referuar llojit të karburantit. - Mbikëqyrja e sistemit të sinjalizimit për nivelin e përqendrimit të avujve hidrokarburë në mjedisin e stacionit. - Ndërprerja e procesit të depozitimit të karburantit dhe mbyllja e linjës hyrëse. - Marrja e mostrës së karburantit. - Evidentimi i parametrave të procesit (volumi, dendësia dhe temperatura e karburantit). - Respektimi i rregullave të sigurimit teknik, të parandalimit e të mbrojtjes nga zjarri, si dhe mbrojtjes së mjedisit përpara dhe gjatë furnizimit të stacionit të karburantit. <p><i>Instrumentet e vlerësimit:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - Vëzhgim me listë kontrolli. <p><i>Kriteret e vlerësimit:</i></p> <p>Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të veshë uniformën e punës sipas rregullit; - të interpretojë drejt dokumentacionin e punës; - të përgatisë vendin e punës sipas standardit; - të përgatisë mjetet e punës sipas rregullit; - të mbikëqyrë impiantin e stacionit të karburantit; - të mbikëqyrë procesin e depozitimit të karburantit në stacion sipas rregullit; - të mbikëqyrë mjetet e nevojshme për mbrojtjen nga zjarri; - të mbikëqyrë e mjetet e nevojshme për mbrojtjen nga zjarri; - të mbikëqyrë gatishmërinë e fikseve dhe sistemit të hidrantëve zjarrfikës; - të mbikëqyrë dhe të respektojë anën figurative të stacionit të karburantit (tabelat paralajmëruese); - të mbikëqyrë rezervuarët, linjat e furnizimit dhe linjat e shkarkimit; - të mbikëqyrë vendin e shkarkimit të autobotit për mbushjen e rezervuarëve;
--	--	---

		<ul style="list-style-type: none"> - të mbikëqyrë procesin e depozitimit të karburantit; - të respektojë sasinë maksimale të lejuar të depozitimit të karburantit në stacion; - të respektojë sasinë maksimale të lejuar për çdo rezervuar, referuar llojit të karburantit; - të mbikëqyrë sistemin e sinjalizimit për nivelin e përqendrimit të avujve hidrokarburë në mjedisin e stacionit; - të mbikëqyrë procesin e depozitimit të karburantit dhe mbylljen e linjës hyrëse; - të mbikëqyrë marrjen e mostrës së karburantit; - të evidentojë parametrat e procesit (volum, dendësi dhe temperaturë të karburantit); - të zbatojë rregullat e sigurimit teknik, të parandalimit e të mbrojtjes nga zjarri, si dhe mbrojtjes së mjedisit përpara dhe gjatë furnizimit të stacionit të karburantit.
	RM 2	<p>Nxënësi kryen procese ndihmëse në furnizimin e automjeteve me karburant.</p> <p><i>Përmbajtja:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - Veshja e uniformës së punës. - Leximi i dokumentacionit të punës. - Përgatitja e vendit të punës. - Përgatitja e mjeteve të punës. - Mbikëqyrja e impiantit të stacionit të karburantit. - Mbikëqyrja e funksionimit të stacionit të karburantit sipas rregullit. - Mbikëqyrja e ndriçimit të stacionit të karburantit. - Mbikëqyrja e linjës së shkarkimit të stacionit të karburantit. - Mbikëqyrja e evidentimit të të dhënave në tabelën e reklamës (orari, lloji i produktit, çmimi, shërbimet e tjera që kryen në stacionin e karburantit (servis, lavazh, vajosje etj). - Mbikëqyrja e hermetizimit të pajisjeve dhënëse (pompat, tubo gommat, pistoletat etj). - Përdorimi i pompave të miratuara nga organet përkatëse të metrologjisë dhe kalibrimit.

	<ul style="list-style-type: none"> - Mbikëqyrja e fshirjes së leximit të mëparshëm nga aparati furnizimit me karburant. - Mbikëqyrja e funksionimit të valvolave të pistoletës. - Mbikëqyrja e ndriçimit të pompës për të parë në çdo kohë treguesin e sasisë. - Mbikëqyrja e sasisë së dhënies sipas tregimit të regjistruar në pompën e taruar, në mënyrë që gabimi i matjes të jetë brenda kufijve të lejuar. - Përdorimi në furnizimin e automjeteve me karburant të njësisë matëse të miratuar. - Mbikëqyrja e treguesve të kalibrimit të aparatit të furnizimit të karburantit (i cili duhet të jetë plotë para dhe pas dhënies). - Mbikëqyrja e valvolave të moskthimit në thithje të linjës së pompës gjatë furnizimit të automjeteve. - Marrja e mostrës së karburantit në mënyrë periodike. - Respektimi i treguesve të cilësisë të karburanteve gjatë ruajtjes dhe furnizimit të automjeteve. - Leximi në mënyrë periodike i parametrave të procesit. - Evidentimi i parametrave të procesit. - Respektimi i rregullave të sigurimit teknik, mbrojtjes nga zjarri dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë procesit të furnizimit të automjeteve në stacionet e karburantit. <p>Instrumentet e vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Vëzhgim me listë kontrolli. <p>Kriteret e vlerësimit:</p> <p>Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të veshë uniformën e punës; - të lexojë dokumentacionin përkatës; - të përgatisë vendin e punës; - të përgatisë mjetet e punës; - të mbikëqyrë impiantin e stacionit të karburantit; - të mbikëqyrë funksionimin e stacionit të karburantit sipas rregullit;
--	---

		<ul style="list-style-type: none"> - të mbikëqyrë ndriçimin e stacionit të karburantit; - të mbikëqyrë linjën e shkarkimit të stacionit të karburantit; - të mbikëqyrë evidentimin e të dhënave në tabelën e reklamës (orari, lloji i produktit, çmimi, shërbimet e tjera që kryen në stacionin e karburantit (servis, lavazh, vajosje etj); - të mbikëqyrë hermetizimin e pajisjeve dhënëse (pompat, tubo gomat, pistoletat etj); - të përdor pompa të miratuara nga organet përkatëse të metrologjisë dhe kalibrimit; - të mbikëqyrë fshirjen e leximit të mëparshëm nga aparati furnizimit me karburant; - të mbikëqyrë funksionimin e valvolave të pistoletës; - të mbikëqyrë ndriçimin e pompës për të parë në çdo kohë treguesin e sasisë; - të mbikëqyrë sasinë e dhënies së karburantit sipas tregimit të regjistruar në pompën e taruar, në mënyrë që gabimi i matjes të jetë brenda kufijve të lejuar; - të bëjë furnizimin e automjeteve me karburant sipas njësisë matëse të miratuar; - të mbikëqyrë treguesin e kalibrimit të aparatit të furnizimit të karburantit (i cili duhet të jetë plotë para dhe pas dhënies); - të mbikëqyrë valvolat e moskthimit në thithje të linjës së pompës gjatë furnizimit të automjeteve; - të marrë mostër karburanti në mënyrë periodike; - të respektojë treguesit cilësorë të karburanteve gjatë ruajtjes dhe furnizimit të automjeteve; - të lexojë në mënyrë periodike parametrat e procesit; - të evidentojë parametrat e procesit; - të zbatojë rregullat e sigurimit teknik, mbrojtjes nga zjarri dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë procesit të furnizimit të automjeteve në stacionet e karburantit.
--	--	---

Shtypi u realizua në shtypshkronjën
“KRISTALINA - KH”
Rr. “Lord Bajron”
Tel.: 00355 4 2447100
Cel.: 068 20 38 373, Cel.: 069 20 38 373
E mail: kristalina kh@hotmail.co.uk
Tiranë/Albania